



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 438 Akti

Nr. 529 Vendimi  
Tiranë, më 9.5.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datat 17.3.2022, ora 10.00 dhe 5.5.2022, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Emror Kasaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Steven Kessler, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij, vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Emror Kasaj, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar me shortin e datës 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” dhe do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët, Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine dhe Olsi Komici në cilësinë e relatorit të çështjes.

3. Me vendimin nr. 1, datë 23.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Emror Kasaj, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

5. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 14.2.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj, vetëm për kriterin e pasurisë, si dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurës Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 15.2.2022, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 1.3.2022, ka depozituar dorazi në Komision prapësimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni vetëm për kriterin e pasurisë, si dhe ka kërkuar riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera: kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesional.

9. Komisioni, me vendimin e datës 23.3.2022, ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë me qëllim qartësimin e disa situatave financiare, si dhe për dy kriteret e tjera të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesional, si dhe njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore të caktuar në datën 17.3.2022, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në orën 10:00 në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e tij përpara Komisionit.

12. Komisioni, pas vendimit për riçeljen e hetimit, kreu disa hetime shtesë duke i njoftuar subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit shtesë me anë të postës elektronike në datën 21.4.2022.

13. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit shtesë për të tria kriteret, depozitoi dorazi pranë Komisionit në datën 28.4.2022 shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës të kaluar nga Komisioni.

14. Subjekti u ftua nga Komisioni në datën 29.4.2022 nëpërmjet postës elektronike për seancën dëgjimore, e cila u mbajt më 5.5.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në seancë subjekti u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e tij përpara Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj, kërkoji konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Z. Emror Kasaj ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17. Për subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

18. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

##### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

###### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

19. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.7.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi \*\*\* në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

20. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 dhe 2004, kur ishte me detyrë oficer i policisë gjyqësore në prokurori dhe në vitin 2015, kur u emërua prokuror në vitin 2016. Referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 26.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

###### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

21. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar

neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaramë dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

22. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

23. Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ Pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting*

#### ❖ Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

**1. Pemëtore, me sip. 115 m<sup>2</sup>, nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; trualli i banesës me sip. 300 m<sup>2</sup>, nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; arë, me sip. 116 m<sup>2</sup>, nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; arë, me sip. 3.212 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në fshatin \*\*\*, Përmet**

Burimi i krijimit: fituar me ligjin nr. 7501 “Për tokën”. Pjesa takuese: 20%.

#### Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2015, ka deklaruar: “Pemëtore me sip. 115m<sup>2</sup>, nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; truall, me sip. 300 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; arë me sip.116m<sup>2</sup>, nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; arë, me sip. 3.212 m<sup>2</sup> nr. pasurie. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*. Pjesa takuese: 20%. Përfitur nga ligji nr. 7501. Ndodhur në Përmet”.

1.2 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. \*\*\*(AMTP në vijim), lëshuar në emër të shtetasit H.K. (babai i subjektit), si dhe një listë,

---

<sup>1</sup>Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

ku me nr. \*\*\* është kryefamiljari H.K., i cili disponon 115 m<sup>2</sup> pemëtore, 300 m<sup>2</sup> truall, 116 m<sup>2</sup> arë dhe 3212 m<sup>2</sup> arë.

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), Zyra Vendore Përmet<sup>2</sup> konfirmon regjistrimin në bashkëpronësi të shtetasve Emror, A. dhe M. K., të pasurisë<sup>3</sup> truall me sip. 300 m<sup>2</sup> dhe 102 m<sup>2</sup> ndërtesë, ndodhur në fshatin \*\*\*, Përmet, me 1/3 pjesë secili.

1.4 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka deklaruar pasurinë ndërtesë me sip. 102 m<sup>2</sup>, në DIPP-të për vitet 2015, 2016 dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) nuk ka deklaruar vlerën e ndërtesës me sip. 102 m<sup>2</sup>, si dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

1.5 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimet e Komisionit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se shtëpia është pasuri e krijuar nga prindërit gjatë martesës në një kohë kur ishte i mitur. Kjo pasuri nuk u përket të gjithë anëtarëve të familjes ashtu siç u përket toka bujqësore e ndarë me ligjin nr. 7501, por u përket prindërve. Ekzistenca e kësaj banese është deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, kur ka qenë me detyrë oficer i policisë gjyqësore. Nuk është deklaruar si pasuri në deklaratën e vitit 2015 të parafillimit të detyrës, pasi kjo pasuri ka qenë në pronësi të babait dhe nuk ka qenë në pronësinë e tij dhe vetëm pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë në vitin 2017 dhe regjistrimit të saj në ASHK në vitin 2018, në pronësi me 1/3, u deklaruar në DIPP-në e vitit 2018

1.5.1 Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti deklaron se shtëpia e banimit është ndërtuar në vitin 1980 me kursimet dhe kontributin, ndërsa për vlerën e banesës, deklaron se nuk e ka ditur dhe nuk e ka vlerësuar ndonjëherë këtë pasuri.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e ndërtesës, me sip. 102 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin \*\*\*, Përmet, në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, si dhe vlerës së saj, duke argumentuar se kemi të bëjmë me një pasuri në pronësi bashkëshortore dhe jo në pronësi të familjes bujqësore të përfutur me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.**

### **2. Pasuria tokë arë, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë<sup>4</sup>, në bashkëpronësi me shtetasin M.L.**

Blerë me kontratën e datës 25.3.2013<sup>5</sup>, me çmim total 5,000,000 lekë. Mbi këtë sipërfaqe ndodhet një objekt në proces legalizimi, për të cilin është lëshuar deklarata noteriale e datës 25.3.2013<sup>6</sup>. Vlera: 2,500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Burimi: kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes ndër vite.

<sup>2</sup>ASHK-ja Zyra Vendore Përmet me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020.

<sup>3</sup>Në z. k. \*\*\*, nr. Pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*

<sup>4</sup>Nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

<sup>5</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 25.3.2013.

<sup>6</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.3.2013.

## Hetimi i kryer nga Komisioni

2.1 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2015.

2.2 Sipas kontratës së shitblerjes, datë 25.3.2010<sup>7</sup>, shitësit H. dhe Z. A. i shesin blerësve Emror Kasaj dhe M.L., pasurinë tokë arë me sip.1000 m<sup>2</sup>, për çmimin 5,000,000 lekë, shumë e cila i dorëzohet shitësit në prani të noteres. Blerësit bëhen bashkëpronarë në ½ pjesë.

2.2.1 Subjekti ka depozituar, gjithashtu, edhe deklaratën noteriale, datë 25.3.2010<sup>8</sup>, me deklarues H. dhe Z.A., Emror Kasaj dhe M.L., të cilët deklarojnë se: *“Kemi lidhur kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 25.3.2010, për shitjen e pronës 1000 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë. Mbi këtë pasuri ndodhet e ndërtuar një godinë trekatëshe pa leje ndërtimi, e cila ndodhet në proces legalizimi. Deklarojmë se godina trekatëshe, e cila funksionon si shkolla “\*\*\*” është likuiduar (shitur) në momentin e shitjes së pasurisë së cituar më sipër dhe të gjitha të drejtat mbi këtë godinë i kalojnë shtetasve Emror Kasaj dhe M.L.. Këtyre të fundit ju kalojmë të drejtën për të ndjekur procedurat e legalizimit për objektin në fjalë”*. Shtetasit Emror Kasaj dhe M.L. deklarojnë se lejojnë z. H.A. ta përdorë godinën e mësipërme pa qira deri në fund të vitit shkollor 2009 -2010.

2.3 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2<sup>9</sup> konfirmon regjistrimin në emër të shtetasve Emror Kasaj dhe M.L., me ½ pjesë secili të pasurisë “arë” me sip. 1000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k.\*\*\*, me nr. Pasurie \*\*\*, në \*\*\*, Tiranë, për të cilën është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie në datën 26.3.2010

2.4 Në dosjen *Vetting*, në ILDKPKI është depozituar dokumenti “sqarim ankese”, datë 6.9.2010, i shtetasit Emror Kasaj drejtuar ministrit të Drejtësisë të kohës, ku në pikën 5 të këtij dokumenti, ka deklaruar: *“Shitësit e mësipërm në prani të vëllait të tij L. janë likuiduar totalisht për shumën 50 milion lekë të vjetra për tokën dhe 250,000 euro për objektin, megjithëse qëllimi është për ta prishur këtë objekt dhe për të ndërtuar mbi këtë sipërfaqe toke”*.

2.5 Gjykata e Lartë<sup>10</sup> ka përcjellë në Komision dosjen gjyqësore me nr. Çështje \*\*\*, të vitit 2014, me objekt “konstatimin e pavlefshëm të kontratës së shitjes së tokës bujqësore, lidhur midis H. dhe Z.A. si shitës, Emror Kasaj dhe M.L.”, me palë shtetasit e lartpërmendur. Rezulton se kjo çështje i referohet, pikërisht, pasurisë “arë”, me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 990 m<sup>2</sup>, që është në bashkëpronësi të Emror Kasaj dhe M.L., blerë shtetasve H. dhe Z.A..

2.5.1 Në vendimin nr. \*\*\*, datë 27.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në faqen 11 të tij, është pasqyruar: *“[...] Në lidhje me çmimin e përcaktuar në shitjen e pasurisë vetë pala paditëse e kundërpaditur me pohimin e saj (i pasqyruar në procesverbalin gjyqësor të mbajtur nga gjykata me gjyqtar A. B., datës 13.4.2011 dhe gjyqtare E. B., datë 31.5.2012) shprehet se në fakt është paguar shuma prej 104,000 euro dhënë vetëm prej të paditurit kundërpaditës M.L.”*.

Në dispozitivin e vendimit, gjykata, ndër të tjera, ka vendosur: *“Detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur H. dhe Z.A. t’i kthejnë palës së paditur kundërpaditëse Emror dhe M.L. vlerën e*

<sup>7</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 25.3.2010.

<sup>8</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.3.2010.

<sup>9</sup>ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2020.

<sup>10</sup>Shkresat me nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2021, të Gjykatës së Lartë.

*çmimit të paguar prej 104,000 euro për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik të shitjes së pasurisë të përbërë nga tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe godinë 3-katëshe ndërtuar mbi të”.*

2.5.2 Gjithashtu, në ankimin e nënshkruar prej tij, datë 4.6.2013, i padituri/kundërpaditës Emror Kasaj ka parashtruar se: *“Gjykata ka gabuar edhe në lidhje me shumën e paguar nga pala e paditur në drejtim të palës paditëse, duke konsideruar si shumë totale vetëm shumën 104.000 euro e pranuar me pohim gjyqësor nga paditësi. Gjykata ka konsideruar të mirëqenë këtë shumë duke harruar të shtojë në të, veç të tjerash, edhe shumën prej 5,000,000 lekë, si dhe shumën 35,000 euro të paguar nga të paditurit paraprakisht për shlyerjen e detyrimeve financiare që rëndonin mbi paditësin me qëllim heqjen e pasurisë tokë arë nga barra hipotekore vënë si garanci prej paditësit për shkak të kredive të marra prej tij dhe të pashlyera”.*

2.5.3 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2013, ka vendosur: (a) ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur: (i) rrëzimin e padisë së paditësve H.A. etj.; (ii) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të kundërpadisë së të paditurve Emror Kasaj dhe M.L.

2.6 Në dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja rezulton e depozituar prokura e posaçme, datë 5.9.2016<sup>11</sup>, me deklaruese shtetasen M.E. (K.), e motra e subjektit, banuese në SHBA, e cila emëron përfaqësues të posaçëm vëllain Emror Kasaj, që në emër të saj, ndër të tjera, e autorizon: *“Përfaqësuesi im ka të drejtë të paraqitet pranë zyrës noteriale të noteres D. K. me qëllim të tërheqë shumën prej 7,000,000 lekësh që unë kam depozituar në ‘Raiffeisen Bank’, në llogarinë bankare të noteres për blerjen e një pasurie, tokë arë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në ZVRPP-në Tiranë, pasi kjo kontratë nuk u realizua dhe për shumën e mësipërme ai mund të disponojë sipas dëshirës pa patur asnjë lloj kufizimi nga ana ime”.*

Komisioni vëren se prokura e posaçme autorizon subjektin për kryerjen e veprimeve, pikërisht, për pasurinë në bashkëpronësi të shtetasve Emror Kasaj dhe M.L.

2.6.1 Komisioni ka administruar, gjithashtu, përgjigjen e noteres D. K.,<sup>12</sup> e cila ka depozituar, ndër të tjera, dokumentacionin vijues:

i) Draft kontratë noteriale për shitjen e të drejtave, datë 2014, me palë shtetasit M.L., L. (pa mbiemër) dhe M. E., lindur në Përmet dhe banuese në \*\*\*, SHBA, dhe shtetasit Nj. Xh., lindur në Tepelenë dhe banues në Londër dhe të dy përfaqësohen me prokurë nga z. Emror Kasaj, në kontratën për shitjen nga z. M.L. të pjesës së tij takuese në godinën 3-katëshe në proces legalizimi, ndodhur mbi pasurinë e llojit “arë”, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në \*\*\*, Tiranë. Shtetasi M.L. ka 3/6 pjesë të godinës 3-katëshe në proces legalizimi dhe të drejtat i kalojnë blerësve Nj. Xh. dhe M. E. , nga ana e të cilëve u bë likuidimi i vlerës prej 115,000 euro, shumë që paguhet në dorë në zyrën noteriale. Pjesët e bashkëpronësisë ndryshojnë: 3/6 Emror Kasaj të cilat i ka pasur në bashkëpronësi përpara realizimit të kësaj kontrate, 2/6 pjesë M.E., 1/6 pjesë Nj. Xh..

ii) Gjithashtu është dhe draft kontratë shitje toke bujqësore, viti 2014, me të njëjtat palë si më sipër, ku përsëri blerësit M.E. dhe Nj. Xh. janë të përfaqësuar me prokurë nga Emror Kasaj në kontratën me objekt, shitja e ½ pjesë në pronësi të M.L. të pasurisë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup>.

<sup>11</sup>Prokurë nr. \*\*\*, datë 5.9.2016.

<sup>12</sup>Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021.



Palët bien dakord që çmimi i shitjes në total të jetë 3,000 euro, e derdhur kjo në llogarinë e noteres, për blerjen e 500 m<sup>2</sup> të kësaj pasurie. Përfundimisht, raportet e bashkëpronësisë ndërmjet bashkëpronarëve do jetë: 3/6 Emror Kasaj të cilat i ka pasur në bashkëpronësi përpara realizimit të kësaj kontrate, 2/6 pjesë M.E., 1/6 pjesë Nj. Xh..

2.7 Me pyetësin nr. 2, subjekti ka depozituar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>13</sup>, datë 15.2.2021, ku shtetasi M.L. është gjykuar për veprën penale “mashttrim”, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga subjekti. Në faqen 5 të këtij vendimi është pasqyruar se subjekti ka deklaruar se shtetasi M.L. për pjesën e tij ka paguar shumën prej 150,000 euro<sup>14</sup>.

2.8 Po me pyetësin nr. 2, subjekti ka depozituar edhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 29.10.2016<sup>15</sup>, në lidhje me procesin penal, ku shtetasi A.SH. ka kallëzuar shtetasin H.A. për veprën penale “mashttrim”, ku nga kallëzuesi A.SH. konfirmohet se vëllezërit A. kanë deklaruar se nuk kanë lekë për të kthyer, duke pretenduar se nuk kanë marrë lekët nga shitja e tokës nga shtetasi Emror Kasaj dhe L. Sh. (M. L.), por është vërtetuar se pretendimet e tyre nuk qëndrojnë, pasi është verifikuar se Emror Kasaj dhe L.Sh. kanë likuiduar shumën 300,000 euro<sup>16</sup>.

2.9 Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti shpjegime në lidhje me deklaratimet e tij për vlerën e pasurisë tokë arë, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, bashkë me godinën 3-katëshe dhe konkretisht:

- në deklaratën *Vetting* dhe kontratën e shitjes, datë 25.3.2013, deklaron ½ pjesë të shumës 5,000,000 lekë, pra, 2,500,000 lekë;
- në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 27.5.2010, është pranuar me pohim gjyqësor vlera e paguar 104,000 euro;
- në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 26.11.2013, janë cituar shkaqet e ankimit të subjektit Emror Kasaj, i cili deklaron se përveç shumës 104,000 euro gjykata duhej të kishte përfshirë edhe vlerën 5,000,000 lekë dhe vlerën 35,000 euro;
- në dokumentin “sqarim ankese”, datë 6.9.2010, drejtuar ministrit të Drejtësisë, z. B.N., subjekti deklaron se shitësit i janë likuiduar 50 milionë lekë të vjetra për tokën dhe 250,000 euro për objektin;
- të specifikojë shumën e saktë që subjekti ka paguar për blerjen e tokës me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe godinës së ndërtuar mbi të duke përcaktuar pjesën takuese;
- të shpjegojë mënyrën e kryerjes së pagesës (me bankë/cash etj.);
- të shpjegojë cili është burimi i krijimit të shumës që subjekti ka paguar duke e shoqëruar me dokument ligjor burimin e këtyre të ardhurave.

2.9.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pretendimet e palëve gjatë gjykimit janë bërë nga avokati i tij i gjendur në situatën kur pala kundërshtarë nuk ka pranuar të deklarojë kushtet e vërteta të kontratës, duke pretenduar deri në fund se vlera e gjithë kontratës ishte vetëm 5,000,000 lekë dhe jo 300,000 euro.

<sup>13</sup>Vendimi nr. \*\*\* akti, datë 15.2.2021, i Gjykatës së Rrethit Tiranë.

<sup>14</sup>“Do i shiste pjesën që kishte blerë vetë duke kërkuar përveç shumës 50,000 euro që i kishte marrë edhe një shumë prej 100,000 euro të tjera që të plotësohej çmimi prej 150,000 euro që kishte blerë pronën”

<sup>15</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 29.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>16</sup>“...H.A. priste të merrte shumën e shitjes në fund të muajt dhjetor 2010. Por shtetasi A. Sh. pretendon se është takuar me L. Sh. dhe ka verifikuar se është e vërtetë akt-marrëveshja e shitjes dhe blerjes së tokës dhe objektit, por ato me cilësinë e blerësit i kishin kaluar një shumë të caktuar dhe mbeteshin për ti kthyer edhe një sasi të vogël. Shuma ishte 300,000 euro”.

Për shkresën “sqarim ankese” drejtuar ministrit të Drejtësisë të kohës, subjekti shpjegon se edhe ky sqarim është bërë nga avokati i tij dhe këtu subjekti i ka qëndruar kontratës, sipas së cilës ishte shkruar prej tij dhe avokatit “likuiduar totalisht”.

2.9.2 Ndër të tjera, në shpjegimet e dhëna në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar: ”[...] *Kështu duke qenë se unë nuk kam pasur asnjë mundësi financiare, unë kam takuar H. dhe i kam ofruar një marrëveshje pasi në të kundërt dhe blerësi i ri nuk do ta blinte të gjithë pronën. Marrëveshja me H. ishte që për pjesën time 50% në të konsideronim të paguar me pjesën prej 5% të çmimit të shitjes që më ishte premtuar për të mu dhënë në dorë si shpërblim për ndërmjetësimin shumë muaj më parë, i barabartë me 15,000 euro<sup>17</sup>, i konvertuar me kursin e këmbimit të kohës në 15,000 euro x 140 lekë/euro=2,100,000 lekë, kurse pjesën tjetër që do të takonte pagesës së shpenzimeve që ai kishte bërë për objektin e paligjshëm që do të prishej për nevoja të ndërtimit, do ta paguaja kur të dilte leja e ndërtimit”.*

2.9.3 Në ILDKPKI (në dosjen *Vetting*) rezulton i depozituar denoncimi në programin televiziv \*\*\*, ku shtetasi M.L. në një pohim të bërë gazetarit (paragrafi 12 i materialit të transkriptuar) pohon se trualli dhe godina është blerë në vlerën 300,000 euro, përkatësisht 150,000 ky shtetas dhe 150,000 euro, Emror Kasaj.

2.9.4 Në ankimin e datës 4.6.2013 të bërë nga shtetasi Emror Kasaj, kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 27.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku të paditurit Emror Kasaj dhe M.L. pretendojnë të kenë paguar shumën 300,000 euro, pasqyrohet se: “... *kjo pasi ky fakt nuk pranohet nga të paditurit të cilët pretendojnë se kanë paguar realisht 300,00 euro*”.

2.10 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit M.L. (quajtur ndryshe dhe L.Sh.) dhe Nj. Xh. dhe nga hetimi<sup>18/19/20</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

2.11 Komisioni analizoi burimin të krijimit të shumës 150,000 euro (pjesa takuese ½ e 300,000 euro), për blerjen e pasurisë tokë-arë, me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 3-katëshe.

2.11.1 Në deklarin për herë të parë të pasurisë në vitin 2015, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë “arë” me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesën 3-katëshe ndodhur mbi të kursimet e tij dhe të bashkëshortes ndër vite.

2.11.2 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se ka marrë hua pa dokument noterial nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me të cilën kishte rënë në marrëveshje që të ndërtonte për llogari të tij dhe ortakut, shumën prej 140,000 euro, për të paguar pjesën që i përkiste subjektit për shpenzimet e kryera nga shitësi H.A. për objektin e paligjshëm.

Shuma 140,000 euro, e pretenduar si burim për pasurinë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe godinë 3-katëshe, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm në pyetësor dhe jo në deklaratën *Vetting*, të cilën Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë në analizën financiare, është trajtuar gjerësisht në pikën 8 të vendimit.

2.12 Komisioni, në lidhje me pasurinë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesën 3-katëshe mbi të, ngriti dyshime në lidhje me vlerën reale të saj, sepse pavarësisht kontratës së shitjes dhe

<sup>17</sup>Nga përlllogaritja çmimi i shitjes rezulton të jetë 300,000 euro sepse 5% x 300,000 euro = 15,000 euro.

<sup>18</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021.

<sup>19</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2021.

<sup>20</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2022 dhe Prokuroria e Rrethit Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

deklaratës noteriale të datës 25.3.2010, ku pasqyrohet vlera 5,000,000 lekë, referuar sa më poshtë, duket se vlera e kësaj pasurie është 300,000 euro, nga të cilat subjekti zotëron ½ pjesë takuese ose 50% të saj, si vijon:

- i. deklaramet e subjektit në përgjigjet e pyetësorëve, ku deklarohet se vlera nuk është 5,000,000 lekë, sa është përcaktuar në kontratë, por 300,000 euro;
- ii. denoncimi në emisionin \*\*\*, ku shtetasi M.L. pranon shumën 300,000 euro;
- iii. ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti pranon shumën 300,000 euro;
- iv. në dokumentin “sqarim ankese”, datë 6.9.2010, drejtuar ministrit të Drejtësisë të kohës, ku subjekti deklarohet se shitësit i janë likuiduar 50 milionë lekë të vjetra për tokën dhe 250,000 euro për objektin;
- v. draft kontratat për shitjen e pjesës së M.L., të përpiluara nga noterja D. K., vlera për tokën dhe ndërtesën, ku çmimi i pasqyruar është 115,000 euro + 35,000 euro = 150,000 euro;
- vi. vendimi nr. \*\*\* akti, datë 15.2.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që pasqyron deklarimin e subjektit se M.L. për pjesën e tij ka paguar shumën prej 150,000 euro;
- vii. vendimi nr.\*\*\*, datë 29.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që pasqyron pohimin e kallëzuesit A.Sh. se për tokën dhe objektin është paguar shuma 300,000 euro.

2.12.1 Referuar dokumentacionit të disponuar nga Komisioni dhe deklarametve të subjektit në deklaratën *Vetting*, u krye analiza financiare për periudhën 1.2.2000 – 31.12.2010, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010 (përpara fillimit të deklarimit/detyrës), si dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, konkretisht:

<b>Përshkrimi</b>	<b>1.2.2000 – 31.12.2010</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>6,003,089</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	5,738,954
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	240,000
Të ardhura nga interesat “Tirana Bank”	24,135
Të hyra si dhurim nga vjehri 200.000 lekë	0
<b>Detyrime</b>	<b>-7,037,383</b>
Kredi në vlerën 500,000 lekë, më 2.10.2008, në “Raiffeisen Bank”, për blerje automjeti	500,000
Hua marrë tezes 2,000 USD, për mobilim shtëpie/viti 2003	0
Hua dhënë M.L. vlera 50,000 euro, datë 4.12.2010	-6,940,500
Huadhënie në vlerën 4,300 euro, A.Sh., në tetor/2010	-596,883
<b>Shpenzime</b>	<b>5,232,060</b>
Shpenzime jetike	3,825,872
Shpenzime mobilimi	217,380
Shpenzime udhëtimi	291,845
Shpenzime legalizimi	60,094

Shpenzime këst kredie	336,870
Kthim i huas tezes në vlerën 2,000 USD, pas vitit 2004	0
Shpenzim i kredisë në vlerën 500,000 lekë	500,000
<b>Pasuri</b>	<b>23,067,003</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	295,503
Pemëtore sip. 115 m <sup>2</sup> , nr. pas. ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Truall i banesës 300 m <sup>2</sup> , nr. pas. ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Arë sip. 116 m <sup>2</sup> , nr. pas. ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Arë sip. 3212 m <sup>2</sup> , nr. pas. ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Arë sip. 1000 m <sup>2</sup> , nr. pas. ***, vol. ***, f. ***, ***, Tiranë, 50%	0
Objekti mbi sip. arë 1000 m <sup>2</sup> në proces legalizimi (vlera 300.000 euro në total për tokën dhe objektin, pranuar nga subjekti në shpjegimet e dhëna) 50%	20,821,500
Banesë 2 kate, me sip 185.8 m <sup>2</sup> , për kat, me sip. tualli 500 m <sup>2</sup> , nr. pas. ***, z. k. ***, ***, Tiranë, 50%	1,250,000
Autoveturë tip “****” (mungon dokumentacioni, por subjekti deklaron burim kredinë në “Raiffeisen Bank”)	500,000
Auotoveturë tip “****”, zotëruar në vitin 2003	200,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-29,333,357</b>

2.13 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se, duket se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me vlerën e tokës arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesës 3-katëshe mbi të (në proces legalizimi), pasi në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën 5,000,000 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e siguruara gjatë hetimit administrativ ka rezultuar që çmimi është në vlerën 300,000 euro.

b) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesën 3-katëshe, pasi:

- në deklaratën *Vetting* deklaron si burim kursimet e tij dhe të bashkëshortes ndër vite;
- në pyetësorin nr. 2 deklaron se do të konsiderohej e paguar me pjesën prej 5% të çmimit të shitjes që i ishte premtuar si ndërmjetës, si dhe 140,000 euro do paguheshin (huaja e pretenduar e marrë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.) në momentin e nxjerrjes së lejes së ndërtimit.

c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e tokës arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesës 3-katëshe të ndodhur mbi të, për pjesën e tij takuese, si dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.14 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se:

2.14.1 Vlera e pasurisë tokë arë me sip.1000 m<sup>2</sup> plus shpenzimet e vlerësuar nga palët blerësit për ndërtimin e objektit 3-katësh në proces legalizimi, ndërtuar mbi këtë sipërfaqe toke nuk janë 5,000,000 lekë, sa është pretenduar nga H.A., etj. në procesin civil, por 300,000 euro.

2.14.2 Për emisionin \*\*\* është pasqyruar fakti i pranuar prej subjektit se çmimi në total është vlerësuar në 300,000 euro dhe se nuk ka paguar asnjë lekë, por konsideron të paguar vlerën 15,000 euro që i takonte si shpërblim i caktuar nga shitësi për të gjetur ndërtesës.

2.14.3 Subjekti, në ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ka pretenduar se ka paguar çmimin 300,000 euro. Subjekti ka pranuar dhe pranon se çmimi total ishte 300,000 euro, por se pagesat e kryera kanë qenë: “... në shumën 104,000 euro e pranuar me pohim gjyqësor nga paditësi, si edhe shumat prej 5,000,000 lekësh dhe 35,000 euro të paguara nga të paditurit, paraprakisht, për shlyerjen e detyrimeve financiare që rëndonin mbi paditësin...”. Shumat e mësipërme janë pjesa e pagesës së z. M.L. dhe pjesa prej 15,000 euro e konsideruar paguar prej subjektit.

2.14.4 Në dokumentin “s qarim ankese” drejtuar ish-ministrit të Drejtësisë të kohës, subjekti shpjegon se është e vërtetë që ka sqaruar këtë të fundit se veç shumës 5,000,000 lekë paguar për tokën, janë paguar edhe rreth 250,000 euro për objektin, por ky sqarim i nënshkruar prej tij ka pasur arsye të forta dhe të përligjura që është bërë nga subjekti dhe avokati i tij, pavarësisht se nuk pasqyrohet të vërtetën.

2.14.5 Në dy draft kontratat e vëna në dispozicion nga noteria D. K. pasqyrohet fakti se vlera e gjysmës së pronës që supozohej se do të shitej nga z. M.L. është 150,000 euro, por kjo nuk do të thotë që në vitin 2010, kur është blerë prona, subjekti kishte paguar pjesën e tij prej 150,000 euro.

2.14.6 Subjekti deklaron se në vendimin e gjykatës të datës 15.2.2021 nuk rezulton që të ketë paguar pjesën e tij të plotë prej 150,000 euro.

2.14.7 Për pohimin në gjykatë të kallëzuesit A.Sh., se për objektin dhe tokën janë paguar 300,000 euro, subjekti deklaron se pohimi i një kallëzuesi në një proces, ku subjekti nuk ka qenë palë, nuk ka asnjë vlerë provuese.

2.14.8 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim të formës së prerë, kanë konkluduar se është provuar se janë paguar 102,000 euro dhe jo gjithë shuma totale.

2.14.9 Subjekti i ka bashkëlidhur provat përkatëse pretendimeve të tij<sup>21</sup>.

---

<sup>21</sup>Kontratë shitje nr.\*\*\*, datë 5.8.1998, e pasurisë me sip. 2300m<sup>2</sup>, nga K.Sh. tek H. A. në shumën 2,100,000 lekë dhe kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 28.8.1998, e pasurisë me sip. 1300 m<sup>2</sup> nga H. A. tek A. Sh. në shumën 2,000,000 lekë; tabulate telefonike të numrit të tij \*\*\* nga data 24.10.2009, kur është prezantuar me H. deri datën e realizimit të kontratës në datën 25.3.2010; kopje e dosjes nr. \*\*\*, datë 2.2.2010, e zyrës së përmbarimit gjyqësor shtetëror për procedurat e shitjes në ankand të pronës për shkak të kredive të pashlyera të H. në “\*\*\*\*”; urdhër sekuestrimi nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2010, e Drejtorisë Rajonale Tatimeve Tiranë, subjekti me këtë provon detyrimet e shumta që kushte H. A. ndaj personave privatë etj.; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 24.3.2010 (një ditë përpara shitjes), që vërteton se H. A. ka paguar kredinë e marrë nga ish- \*\*\* Bank dhe vërtetim, datë 19.3.2010, të “\*\*\*\*”, sipas të cilit në datën 19.3.2010 ka shlyer detyrimet e mbetura; certifikata e pronësisë e pasurisë me sip. 1000 m<sup>2</sup>, datë 26.3.2010, provon faktin se objekti në proces legalizimi nuk është objekt i ligjshëm; material audio i transkriptuar i bisedës së datës 9.12.2010, i bërë ndërmjet subjektit dhe M.L.; kërkesë padi e shtetasve H. dhe Z.A. datë 27.12.2010; kundërpadi e Emror Kasaj dhe M.L., datë 23.7.2012; kërkesë ankimore e vëllezërve A., datë 19.2.2013, drejtuar prokurorit të Prokurorisë Tiranës A.K.; kundër-ankim i H.A. etj., datë 24.6.2013, ku paditësit A. konfirmojnë si gjithmonë se subjekti nuk ka paguar asnjë lekë; ankim i Emror Kasaj, datë 4.6.2013, ndaj vendimit nr.\*\*\*, datë 27.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të shpjeguar më lart; vendim nr. \*\*\*, datë 26.11.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë; kallëzim penal, datë 2.9.2010, i shtetasve H. A. etj., ndaj Emror Kasaj dhe M.L.; kallëzim penal datë 9.12.2010 i Emror Kasaj kundër D. A. etj; vendim mosfillimi procedimi penal nr. \*\*\*, datë 20.11.2010, të kallëzimit të bërë prej subjektit dhe vëllezërve A.; prokurë nr. \*\*\*, datë 23.2.2014,

2.14.10 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se konstatimi i Komisionit për mungesë të ardhurash të ligjshme për blerjen e tokës arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesës 3-katëshe të ndodhur mbi të, për pjesën e tij takuese, si dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, nuk qëndron duke argumentuar si vijon:

- të ardhurat e llogaritura për bashkëshorten në shumën 240,000 lekë sepse nga verifikimi i statement bankar në “Raiffeisen Bank” rezulton shuma 986,378 lekë dhe nga punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, në periudhën 2005 – 2006, ka realizuar të ardhura në shumën 267,000 lekë, pra, të ardhurat nga pagat janë në shumën totale 1,254,178 lekë;
- përfshirjen në analizën financiare të shumës 50,000 euro dhënë hua M.L. në vitin 2010, pasi nuk është pasqyruar as marrja e huas për këtë vlerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të shumës 2,000 USD, hua nga tezja në vitin 2003 dhe, më pas, të përdorur për mobilimin e shtëpisë;
- përfshirjen në analizë financiare për vitin 2008 të shumën 500,000 lekë si shpenzim të kredisë sepse kjo shumë është përdorur për blerjen e mjetit;
- mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të shumës 200,000 lekë të hyra si dhurim nga vjehri për blerjen e makinës;
- përfshirjen në analizë financiare të shumës 150,000 euro për pasurinë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 3-katëshe mbi të sepse nuk janë pasqyruar as të marrat apo të hyrat e kësaj vlere.

Në prapësimet e dërguara nga subjekti pas riçeljes së hetimit, subjekti ka pretenduar se:

- shpenzimet në lidhje me ½ e vlerës së ndërtimit të banesës 2-katëshe me sip. 185.8 m<sup>2</sup> e ndodhur në \*\*\*, në vlerën 1,250,000 lekë, të llogaritura nga Komisioni dhe nga ekspertja, duhet të hiqen nga analiza sepse janë përballuar nga puna e babait;
- shpenzimet për legalizimin e banesës duhet të llogariten në shumën 30,047 lekë sipas ½ sipas takuese që subjekti zotëron;
- shpenzimet për udhëtimin në SHBA në maj të vitin 2009, në vlerën 291,845 lekë, duhet të hiqen, pasi janë përballuar nga \*\*\*.

Në përfundim, subjekti, pas kryerjes së analizës financiare, fillimisht nga eksperti kontabël dhe më pas prej tij, ka rezultuar me një balancë pozitive prej 1,717,477 lekësh.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

2.15 Komisioni vëren se për pasurinë tokë arë, me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesën mbi të subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime kontradiktore referuar vlerës së saj. Rezulton se në DIPP-në e para fillimit të detyrës të vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar shumën 2,500,000 lekë si ½ pjesë e totalit prej 5,000,000 lekësh, ndërkohë që në prapësime pranon se vlera reale totale e këtyre pasurive është 300,000 euro, ku pjesa takuese e tij është 150,000 euro.

---

lëshuar nga Nj. Xh., në të cilin autorizon subjektin për llogari të tij të nënshkruajë kontratën për blerjen e 1/3 pjesë të ½ të pronës (pra, 1/6 e të gjithës) në bashkëpronësinë e tij dhe M.L.; prokurë nr. \*\*\*, datë 24.2.2014, lëshuar nga M.E. motra e subjektit, e cila autorizonte këtë të fundit për llogari të saj të nënshkruante kontratën për blerjen e 2/3 pjesë të pjesës prej ½ të pronës në bashkëpronësinë të subjektit me M.L.; prokurë nr. \*\*\*, datë 5.9.2016, lëshuar nga M.E., ku autorizon subjektin për të tërhequr shumën 7,000,000 lekë të mbetura në llogarinë e noteres për shkak të mosrealizimit të kontratës.

2.15.1 Subjekti pranon se çmimi total i pasurive (tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 3-katëshe mbi të) është në vlerën 300,000 euro dhe deklaron se nuk e ka paguar pjesën e tij prej 150,000 euro edhe pse rezulton pronar i këtyre pasurive me ½ pjesë.

Ky pohim i subjektit është jo vetëm deklarativ, por edhe i pabesueshëm sepse edhe nëse Komisioni do të pranonte tezën e subjektit mbetet i pashpjeguar bindshëm dhe pa logjikë ekonomike fakti i të qenurit pronar me ½ pjesë i një pasurie me vlerë të pranuar prej 300,000 euro, për të cilën pretendohet se nuk është paguar asnjë vlerë monetare prej tij.

2.15.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse për dokumentin “sqarim ankesë”, pasi në këtë dokument pranon se bashkë me ortakun u ka paguar shitësve 5,000,000 lekë dhe 250,000 euro, ndërsa në prapësime deklaron se Komisioni nuk duhet ta konsiderojë si provë atë dokument sepse është i pavërtetë, pasi nuk i ka paguar ato para. Ndodhur në këto rrethana, pavarësisht se subjekti nuk ka qenë në detyrën e prokurorit, kjo sjellje konsiderohet si jo e përshtatshme dhe jo etike për publikun.

2.15.3 Gjatë hetimit administrativ u administruan draft kontratat për shitjen e pasurive godinë 3-katëshe dhe tokë arë me shitës M.L. dhe blerës M.E. dhe Nj.Xh. që të dy të përfaqësuar nga shtetasi Emror Kasaj me prokurë, të cilët do të blenin godinën 3-katëshe me çmimin 115,000 euro dhe tokën arë me 35,000 euro, me pjesët përkatëse M.E. 2/6 pjesë dhe Nj. Xh. 1/6 pjesë dhe duke mbetur Emror Kasaj me 3/6 pjesë.

2.15.4 Subjekti nuk ka shpjeguar se ku është disponuar shuma e konsiderueshme prej 7,000,000 lekësh nga motra e tij, si është sjellë kjo shumë në Shqipëri, për çfarë do të investohet në Shqipëri në një kohë që e motra M.E. jeton dhe punon në SHBA, si dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj.

2.15.5 Subjekti në pyetësin nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se së bashku me ortakun M.L. në cilësinë e blerësve ua dorëzuan edhe pjesën tjetër të çmimit shitësve, pasi ua dorëzoi paratë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.,<sup>22</sup> deklarim ky kontradiktor me shpjegimet e dhëna, po nga subjekti në prapësimet e tij, ku thekson se nuk e ka paguar pjesën e tij të çmimit prej 150,000 euro dhe deklaron ndërkohë se shumën prej 140,000 euro të dhënë hua nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e ka përdorur për huan prej 50,000 euro dhënë M.L. dhe shumën 90,000 euro ia ktheu brenda vitit shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

2.15.6 Në lidhje me analizën financiare të burimit të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni konstaton se për të ardhurat nga pagat e bashkëshortes në shumën 986,378 lekë provohet përfitimi nëpërmjet llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, por këto të ardhura në shumën 746,378 lekë (986,378-240,000) nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, sepse nuk është provuar të jenë paguar detyrime tatimore për to. Sipas përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>23</sup> rezulton se nuk është paguar tatim në burim për shumën 746,378 lekë, ku 54,000 lekë janë dieta. Gjithashtu, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues ligjor pagesën e tatimit në burim për shumën e pretenduar prej ti si e ardhur e ligjshme.

<sup>22</sup>“Pra, pala tjetër, duke përfituar nga mirëbesimi na kishte vënë në vështirësi për të vërtetuar kushtet e kontratës, faktin që ne si blerës ua dorëzuan edhe pjesën tjetër të çmimit, pasi na i dorëzoi paratë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.”.

<sup>23</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., (v. ç.) datë 26.11.2021.

Në lidhje me të ardhurat nga marrëdhënia e punësimit të bashkëshortes së subjektit në shoqërinë ‘\*\*\*’, në shumën 267,800 lekë, subjekti ka depozituar në prapësime vërtetim nga DRSSh-ja Gjirokastër, për pagat mbi të cilat janë derdhur kontributet për periudhën prill 2005 – nëntor 2006. Komisioni kreu përlllogaritjen e pagës *neto* të përfituar nga bashkëshortja e subjektit sipas legjislacionit të kohës, nga ku rezultuan të ardhura totale në shumën 236,606 lekë, të cilat Komisioni i mori në konsideratë në analizën financiare të rishikuar si të ardhura të ligjshme.

2.15.7 me Në lidhje pretendimin e subjektit për mospërfshirjen në analizën financiare të shumës 50,000 euro dhënë hua shtetasit M.L., Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën për herë të parë të pasurisë në vitin 2015, si dhe në deklaratën *Vetting*, huan në shumën 140,000 euro marrë nga shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. të pretenduar prej tij si burim për huan në shumën 50,000 euro dhënë M.L..

2.15.7.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provon ekzistencën formale të kësaj marrëdhënieje, si dhe as burimin e krijimit të këtyre të ardhurave. Në këto kushte, Komisioni nuk ka pasqyruar në analizë financiare shumën 140,000 euro të shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., por ka paraqitur si pasuri të subjektit vetëm huan në shumën 50,000 euro dhënë M.L. në dhjetor të vitit 2010.

2.15.8 Në lidhje me shumën 2,000 USD, marrë hua nga tezja e tij, në interpretim të rrethanave dhe deklarimeve, Komisioni vlerëson se edhe për këtë hua subjekti nuk ka provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje dhe as burimin e ligjshëm të kësaj shume. Në këto kushte, Komisioni nuk e ka pasqyruar atë në analizë financiare, por e ka paraqitur si shpenzim për punime në banesë shumën 2,000 USD.

2.15.9 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për heqjen nga analiza të shumës 500,000 lekë si shpenzim, Komisioni i gjeti bindëse shpjegimet e dhëna se kjo shumë është llogaritur një herë në analizë si vlerë e mjetit të blerë me kredinë në ‘Raiffeisen Bank’ dhe e pasqyroi këtë ndryshim në analizën financiare të rishikuar.

2.15.10 Në lidhje me përfshirjen në analizën financiare të shumës 200,000 lekë, Komisioni vlerëson se referuar deklaramit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, si dhe në tërësi nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti, në lidhje me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, provohet burimi i ligjshëm i shumës 200,000 lekë dhuruar nga vjehri për blerjen e mjetit.

2.15.11 Në lidhje me pretendimin për të mospërfshirë në analizë financiare shumën 150,000 euro për pasurinë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 3-katëshe mbi të, Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit në prapësime dhe seancë dëgjimore, vlerësoi se pretendimi i subjektit se për këtë pasuri nuk ka paguar vlerë monetare nuk qëndron dhe bie në kundërshtim me deklaramin e bërë në deklaratën *Vetting*, ku subjekti deklaroi vlerën 2,500,000 lekë, duke specifikuar si burim të kësaj shume kursimet familjare. Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve, çmon se bazuar në kontratën e shitjes dhe në certifikatën e pronësisë vlera e llogaritur në analizë është 2,500,000 lekë.

2.15.12 Në lidhje me shumën 1,250,000 lekë, ½ e vlerës së ndërtimit të banesës 2-katëshe, me sip. 185.8 m<sup>2</sup>, e ndodhur në \*\*\*, subjekti ka pretenduar se burim krijimi i kësaj pasurie janë të ardhurat nga puna në emigracionin babait të tij, por subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për të ardhurat e përfituara në shtetin grek nga babai i tij,



si dhe nuk ka provuar se është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në prapësimet e tij, ka depozituar dhe aktin e ekspertimit vlerësues të datës 28.2.2022, i cili pasqyron vlerën 3,211,827 lekë, më e lartë se vlera 2,500,000 lekë e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Për këtë arsye, Komisioni mori në konsideratë në analizën financiare të rishikuar ½ e vlerës së aktit të ekspertimit prej 1,605,914 lekësh.

Pasuria në fjalë është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe, për këtë arsye, subjekti ka detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të saj.

2.15.13 Në lidhje me shpenzimet për legalizimin e banesës, Komisioni mori në konsideratë shpjegimin e subjektit, duke e pasqyruar atë në analizën financiare të rishikuar në shumën 30,047 lekë, sipas ½ pjesë takuese që zotëron.

2.15.14 Për sa i përket pretendimit se shpenzimet për udhëtimin në SHBA në maj të vitit 2009 në vlerën 291,845 lekë duhet të hiqen nga analiza financiare, pasi janë përballuar nga \*\*\*, subjekti në seancën dëgjimore të datës 5.3.2022 ka depozituar dokumentacion provues dhe, për këtë arsye, Komisioni bëri ndryshimet përkatëse në analizën e rishikuar.

2.15.15 Lidhur me situatën negative financiare të rezultuar gjatë hetimit administrativ për krijimin e kësaj pasurie në vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë pyetësorëve, Komisioni, pas prapësimeve dhe seancës dëgjimore, ka marrë në konsideratë se sipas konkludimeve të mësipërme dhe në vijim të rishikimit të analizës rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare me burime të ligjshme, për të ndërtuar këtë pasuri në vlerën 10,257,089 lekë.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie nuk kënaqin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të mospagimit të këtyre detyrimeve tatimore.

**Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se:**

- i) Problematikat e konstatuara, në lidhje me vlerën e pasurisë tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 3-katëshe mbi të, si dhe ndryshimi i deklarimit të subjektit gjatë hetimit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë, në lidhje me vlerën reale të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, duke e vendosur në kushtet e germës “ç”, pika 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**
- ii) Tërësia e veprimeve dhe e deklarimeve të subjektit në lidhje me këtë pasuri, si dhe vlerësimi i provave të siguruara, pavarësisht se kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar përpara se subjekti të bëhej prokuror, por të deklaruar në deklaratën *Vetting*, krijojnë bindjen e Komisionit se nga ana e subjektit janë konsumuar sjellje jo të përshtatshme dhe jo etike që kanë cenuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

### **3. Banesë dykatëshe, me sip. 185.8 m<sup>2</sup> në çdo kat, me sip. trualli 500 m<sup>2</sup>**

3.1 Subjekti i rivlerësimit, mbi pasurinë nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, në \*\*\*, Tiranë, është shprehur se: “Ndërtuar nga babai im në periudhën 1998-1999. Legalizuar me leje legalizimi nr. \*\*\*,

*datë 22.11.2010. Sipërfaqja e tokës prej 500 m<sup>2</sup> është blerë nga babai me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.3.1999. Gjysma e kësaj sipërfaqe, 250 m<sup>2</sup>, i është dhuruar gjatë procedurave të legalizimit nga babai me kontratën e dhurimit nr. \*\*\*, datë 6.5.2010”.*

Burimi i krijimit: gjithë investimi është bërë nga babai i subjektit me të ardhurat e krijuara nga puna shumëvjeçare në emigracion në shtetin grek (periudhë gjatë të cilës subjekti ka qenë duke ndjekur studimet universitare). Vlera: nuk është e vlerësuar. Pjesa takuese: 50%.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

3.1.1 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 (kur subjekti ka qenë OPGJ), subjekti ka deklaruar: *“... një banesë private së bashku me truallin e pa legalizuar ende (trualli është i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të babait tim H.K.. Mua më takon gjysma e tij, blerë që në vitin 1998). Vlera: 2.5 milion lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: truallin e ka blerë im atë në vitin 1990 dhe shtëpinë e kemi ndërtuar në vitin 1999 me të ardhurat e fituara nga im atë i cili ka punuar në ndërtim për rreth 7-8 vjet si emigrant me dokumente të rregullta në Greqi”.*

3.1.2 Po kjo pasuri, në DIPP-në para fillimit të detyrës të vitit 2015, është deklaruar nga subjekti: *“Banesë dykatëshe me sip. 185.8 m<sup>2</sup> në çdo kat, me sipërfaqe trualli 500 m<sup>2</sup>, nr. Pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Tiranë. Zotëroj: 50% të objektit dhe truallit. Ndërtuar nga babai im në periudhën 1998-1999. Legalizuar me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 22.11.2010. Pjesa takuese: 50%. Trualli është blerë nga babai, si dhe kosto e ndërtimit është me të ardhurat e tij nga emigracioni (periudhë kur unë kam qenë student)”. Nuk është deklaruar vlera e kësaj pasurie.*

3.2 Nga ASHK-ja<sup>24</sup> konfirmohet e regjistruar në emër të shtetasit Emror Kasaj pasuria truall me sip. 500 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip.185.8 m<sup>2</sup>, me nr. pas \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi me shtetasin A. K. <sup>25</sup>, në \*\*\*, Tiranë.

3.2.1 ASHK-ja<sup>26</sup> ka depozituar praktikën e legalizimit për ndërtesën me sip. 185.8 m<sup>2</sup> për të cilën është lëshuar leja e legalizimit në emër të shtetasve Emror dhe H. Kasaj.

3.2.2 Rezulton se formulari i vetëdeklarimit për legalizim me deklarues H. dhe Emror Kasaj mban datën 20.3.2005 dhe deklarohet sipërfaqja e zënë 500 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e ndërtimit 180 m<sup>2</sup>, ndërtimi i banesës maj të vitit 2000. Është lëshuar vërtetimi i pronësisë, datë 21.5.2010, nga ish-ZVRPP-ja Tiranë, për pasurinë e llojit “arë”, me sip. 500 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë, në emër të shtetasve H. dhe Emror Kasaj.

3.3 Komisioni, bazuar në udhëzimin e EKB-së për vitin 2000<sup>27</sup>, për koston mesatare të ndërtimit për këtë vit, bëri një llogaritje të koston së ndërtimit të ndërtesës me sip. 180 m<sup>2</sup> (360 m<sup>2</sup>, dy kate) me çmimin/sipërfaqe ndërtimi për qytetin e Tiranës dhe konkretisht: 360 m<sup>2</sup> (dy kate) x 24,780 lekë/m<sup>2</sup> = 8,920,800 lekë.

<sup>24</sup>ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2020.

<sup>25</sup>Nga dokumentacioni i ASHK-së rezulton se me vdekjen e H. Kasaj, datë 1.9.2015, është lëshuar dëshmia trashëgimore nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, ku përcaktohen trashëgimtarë të rrodhes së parë shtetasit Emror Kasaj, A. K. dhe M. K. (e ëma Xh. K.ka vdekur më parë), të cilët trashëgojnë me nga 1/3 pjesë. Me kontratën e dhurimit nr. \*\*\*, datë 26.5.2017, Emror dhe M.K., i dhurojnë A.K. 1/6 pjesë të pasurisë 500 m<sup>2</sup> truall dhe 185.80 m<sup>2</sup> ndërtesë ndodhur në \*\*\*, Tiranë. Emror dhe A. K. bëhen bashkëpronarë me 3/6 pjesë secili i këtyre pasurive.

<sup>26</sup>ASHK-ja, Njësia e Hartografisë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020.

<sup>27</sup>Vendim nr.\*\*\*, datë 14.7.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ‘k’”.

3.4 Komisioni, me pyetësonin nr. 2, për shtëpinë dykatëshe me sipërfaqe trualli 500 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 185.5 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, ka kërkuar nga subjekti: të specifikojë vlerën e kësaj ndërtese; të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e saj; të shpjegojë mospërputhjen për deklarimin në deklaratën *Vetting*, që i është dhuruar gjysma e ndërtesës nga babai i tij në vitin 2010, ndërkohë që në formularin e vetëdeklarimit të procesit të legalizimit të vitit 2005, subjekti rezulton bashkëdeklarues me babanë e tij.

3.4.1 Subjekti ka shpjeguar se vlera e banesës ka qenë vetëm materialet e ndërtimit, pasi çdo lloj punimi fizik, instalime elektrike dhe hidraulike në atë banesë janë bërë nga babai, vëllai dhe nga vetë subjekti. Për blerjen e materialeve nuk disponon dokumentacion, pasi në vitin 1999 pikat e shitjes me pakicë nuk lëshonin faturë.

3.4.2 Për burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e shtëpisë subjekti deklaron se të ardhurat janë siguruar nga babai si emigrant në Greqi, për të cilin ka vetëm lejen e qëndrimit, ndërsa paratë e fituara nuk janë kaluar me bankë, por janë dhënë dorazi.

3.4.3 Subjekti, për dhurimin e gjysmës së ndërtesës nga babai i tij, deklaron se që nga viti i ndërtimit të saj ka jetuar në këtë banesë. Bashkëpronar në momentin e legalizimit të objektit ka qenë babai dhe subjekti, pasi nëna kishte ndërruar jetë në vitin 2015 dhe pjesa në emër të babait kaloi me trashëgimi nga 1/3 pjesë secilit: subjekti, vëllait A.K. dhe motrës M.K.. Më pas, me kontratë dhurimi subjekti dhe motra e tij ia dhuruan pjesën e prindërve vëllait A. dhe, përfundimisht, subjekti vazhdon të jetë me ½ në bashkëpronësi me vëllain A.K..

3.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2015 vlerën e investimit të ndërtimit të shtëpisë me sip. 185 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar vlerën 2,500,000 lekë.

b) Ka diferencë të theksuar të vlerës së ndërtesës deklaruar 2,500,000 lekë nga subjekti në vitin 2003 me vlerën 8,920,800 lekë të llogaritur sipas EKB-së.

c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të ardhurat e krijuara në emigracion nga babai.

d) Ka mospërputhje deklarimi në lidhje me kohën e ndërtimit të banesës sepse në deklaratën para fillimit të detyrës 2015 deklaron periudhën 1998-1999, ndërsa në formularin e vetëdeklarimit për legalizim deklaron maj të vitit 2000.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

3.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës, si dhe gjatë seancës dëgjimore, përveç sqarimeve dhe provave të dhëna gjatë hetimit, si më lart<sup>28</sup>, ka shpjeguar, ndër të tjera, se:

---

<sup>28</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 27.1.1999, ndërmjet L. S. dhe blerës H.K. për blerjen e tokës me sip. 500 m<sup>2</sup>; foto të babait të subjektit H.K. në vitin 1999-2000, duke ndërtuar katin e dytë të banesës, pasi ishte ndërtuar kati i parë; kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 6.5.2010, me të cilën prindërit e tij i dhurojnë gjysmën e sipërfaqes së tokës mbi të cilën është ndërtuar banesa; formular i legalizimit të banesës; leje legalizimi; certifikata e pronësisë së banesës në bashkëpronësi; kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 26.5.2017; certifikata e pronësisë, datë 29.5.2017, sipas të cilës banesa kaloi në bashkëpronësi të ½ subjektit dhe ½ vëllait të tij A.K..

3.6.1 Për deklarinimin e vlerës 2,500,000 lekë në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 është deklaruar vlera financiare e llogaritur për materialet e ndërtimit të kohës kur është bërë ndërtimi, pasi çdo lloj punimi tjetër është bërë nga babai dhe vetë subjekti.

3.6.2 Për vlerën e llogaritur nga Komisioni, sipas EKB-së në shumën 8,920,800 lekë, subjekti shpjegon se kjo është vlerë e caktuar nga shteti për të llogaritur taksat mbi pronën dhe nuk tregon në fakt vlerën me të cilën subjekti vlerëson pronën.

3.6.2.1 Subjekti ka depozituar si provë aktekspertimi vlerësues në fushën e ndërtimit, datë 28.2.2022, me anë të cilit llogaritet vlera e materialeve të ndërtimit në periudhën 1999-2000, duke nxjerrë si vlerë totale investimi për shtëpinë dykatëshe, në \*\*\*, vlerën 3,211,827 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

3.7 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, në lidhje me mos deklarinimin e vlerës së investimit të kësaj pasurie, në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*

3.7.1 Për mospërputhjen e vitit të ndërtimit deklaruar 1998-1999 në DIPP-në para detyrës në vitin 2015 dhe vitin 2000 në formularin e ALUIZNI-t, subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme.

3.7.2 Në lidhje me vlerën e investimit, subjekti ka depozituar një aktekspertim të përgatitur nga një eksperte ndërtimi, e cila ka nxjerrë si vlerë totale investimi për shtëpinë dykatëshe, në \*\*\*, vlerën 3,211,827 lekë. Në këtë aktekspertim, ekspertja nuk ka llogaritur vlerën e punëtorisë (haku i punës) dhe transportin, që sipas pohimit të subjektit këto dy zëra nuk janë realizuar me pagesë.

3.7.3 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna në emigracion e të ndjerit, babait të tij, por nuk i ka provuar me dokumentacion ligjor, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk ka provuar se është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion, sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

3.8 Komisioni, marrë shkas nga deklarimi i subjektit se: ndërtimi i banesës ka filluar në vitin 1999 kur ka mbaruar kati i parë dhe kati i dytë ka përfunduar deri në maj të vitit 2000; ka filluar punë në janar të vitit 2000; në formularin e vetëdeklarimit të procesit të legalizimit të vitit 2005 rezulton bashkëdeklarues me babanë e tij, për ndërtimin e realizuar në periudhën 1999-2000, e ka konsideruar subjektin bashkëpronar në këtë ndërtim që në origjinë të tij dhe, për rrjedhojë, ½ e vlerës së investimit prej 3,211,827 lekësh të rezultuar nga akti i ekspertimit i depozituar nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, e ka përfshirë atë në analizën financiare si pasuri të tij.

**Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarinim të saktë të vlerës së kësaj pasurie në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

**Subjekti i rivlerësimi nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait nga emigracioni të deklaruara si burim për ndërtimin e banesës**

dykatëshe me sip. 185.8 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë, në kuptim të pikës 3, nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

#### 4. Huadhënie në shumën 4,300 euro, shtetasit A. Sh., sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 26.2.2014

Kjo huadhënie nuk është likuiduar ende Vlera: 4,300 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet e subjektit dhe shitja e automjetit me targa \*\*\*.

#### Hetimi i kryer nga Komisioni

4.1 Sipas deklaratës noteriale, datë 26.2.2014<sup>29</sup>, shtetasi A. Sh. deklaroi se: *“I detyrohet Emror Kasaj shumën 4,300 euro e cila është marrë në tetor të vitit 2010 dhe se këtë shumë do ia kthejë në datën 31.12.201”*.

4.1.1 Në lidhje me marrëdhënien me shtetasin A.Sh. dhe huan e dhënë këtij shtetasi, subjekti ka shpjeguar se këtë shtetas e njeh më parë sepse të dy janë banorë të së njëjtës lagje dhe ky e ndërmjetësoi me H.A. për çështjen e pronës. Shumën në fjalë ia ka dhënë hua, pasi i duheshin për të paguar studimet e djalit dhe se akoma nuk i është kthyer.

4.2 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasin A. Sh. dhe nga hetimi<sup>30</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

4.3 Analizë burimit të krijimit të shumës 4,300 euro, dhënë hua nga subjekti

4.3.1 Kursimet e subjektit të rivlerësimit

Komisioni, referuar deklaratimit të subjektit, në lidhje me përdorimin e kursimeve si burim, si dhe mbështetur në dokumentacionin në dispozicion, analizoi mundësinë financiare të subjektit, për dhënien e huas në shumën 4,300 euro, në tetor të vitit 2010, krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, për periudhën kohore 1.2.2000 - 31.10.2010, konkretisht:

Përshkrimi	1.2.2000-31.10.2010
<b>Të ardhurat</b>	<b>5,959,680</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	5,695,545
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	240,000
Të ardhura nga interesat “Tirana Bank”	24,135
Të hyra si dhurim nga vjehri shuma 200,000 lekë	0
<b>Detyrime</b>	<b>-96,883</b>
Kredi, në shumën 500,000, më 2.10.2008, në “Raiffeisen Bank”, për blerje automjeti	500,000
Hua marrë tezes shumën 2,000 USD, për mobilim shtëpie/viti 2003	0
Huadhënie në shumën 4,300 euro, z. A.Sh., në tetor/2010	-596,883
<b>Shpenzime</b>	<b>4,828,788</b>
Shpenzime jetike	3,734,792
Shpenzime mobilimi	217,380

<sup>29</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26.2.2014.

<sup>30</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021.

Shpenzime udhëtimi	291,845
Shpenzime legalizimi	60,094
Shpenzime këst kredie	318,018
Kthim i huas tezes në shumën 2,000 USD, pas vitit 2004	206,660
<b>Pasuri</b>	<b>23,093,526</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	322,026
Pemëtoare sip. 115 m <sup>2</sup> , nr. Pasurie ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Truall i banesës me sip. 300 m <sup>2</sup> , nr. Pasurie ***, vol. ***, f. ***, ****, Përmet	0
Arë, me sip. 116 m <sup>2</sup> , nr. Pasurie ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Arë, me sip. 3212 m <sup>2</sup> , nr. Pasurie ***, vol. ***, f. ***, ***, Përmet	0
Arë, me sip. 1000 m <sup>2</sup> , nr. Pasurie ***, vol. ***, f. ***, ***, Tiranë, 50%	0
Objekti mbi sip. arë 1000 m <sup>2</sup> në proces legalizimi (vlera 300,000 euro në total për tokën dhe objektin, pranuar nga subjekti në shpjegimet e dhëna) 50%	20,821,500
Banesë 2 kate, me sip. 185.8 m <sup>2</sup> /kat, me sip. tuall 500 m <sup>2</sup> , nr. Pasurie ***, z. k. ***, ***, Tiranë, 50%	1,250,000
Autoveturë me targa *** (mungon dokumentacioni, por subjekti deklaroi burim kredinë në “Raiffeisen Bank”)	500,000
Autoveturë tip “****”, zotëruar në vitin 2003	200,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-22,059,517</b>

#### 4.3.2 Të ardhurat nga shitja e automjetit, me targa \*\*\*

Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e shitblerjes, datë 4.9.2013<sup>31</sup>, ku shtetasi Emror Kasaj i shet mjetin tip “\*\*\*\*”, i vitit 2003, me targa \*\*\*, blerësit N.T., kundrejt çmimit 250,000 lekë.

4.3.2.1 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar se ky mjet është blerë me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”. Marrë shkas nga kjo përgjigje e subjektit, Komisioni konsideroi si çmim blerje të mjetit me targa \*\*\* kredinë e marrë nga subjekti në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 500,000 lekë, në vitin 2008

4.3.2.2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë deklaratimet kontradiktore në *Vetting*, në lidhje me destinacionin e të ardhurave të krijuara nga shitja e mjetit, sepse subjekti deklaroi se kanë shërbyer si burim për blerjen e motoçikletës me targa \*\*\* në vitin 2014 dhe, ndërkohë, po në *Vetting* deklaroi se kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në shumën 4300 euro, në vitin 2010.

4.3.2.3 Për deklaratimet kontradiktore, lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit me targa \*\*\*, subjekti ka shpjeguar se nuk mban mend të ketë deklaruar se është nga shitja e këtij mjeti, por nëse ka deklaruar kështu është lapsus, pasi nuk ishte automjeti tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\*, i cili ishte marrë me kredi në “Raiffeisen Bank”, por një mjet tip “\*\*\*\*”, me targa italiane i blerë dhe i shitur pa kontratë, pasi shitësi nuk kishte bërë çregjistrimin në Itali. Pra, subjekti

<sup>31</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 4.9.2013.

deklaron se të ardhurat nga shitja e mjetit me targa \*\*\* kanë shërbyer për blerjen e motoçikletës me targa \*\*\*.

4.4 Komisioni, gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se, duket se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të kontradiktor në lidhje me burimin e krijimit të shumës 4300 euro dhënë hua A.Sh. sepse në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar vetë si burim dhe, për më tepër, ka depozituar dokument për të, ndërsa në pyetësorë deklaron si burim një mjet tjetër (tip “\*\*\*\*”), për të cilin nuk provon as shitjen dhe as blerjen e tij.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 4,300 euro, në tetor të vitit 2010, si dhe blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, pasi rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

4.4.1 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se ka qenë lapsus, pasi automjeti nuk është \*\*\*, nga shitja e të cilit ai ka blerë motorin \*\*\*, por është shitja e automjetit “\*\*\*\*”. Nga fotot e disponuara nga subjekti rezulton se targa e mjetit ka qenë \*\*\*. Automjeti me targa \*\*\* është përdorur si burim për blerjen e motorit me targa \*\*\*.

4.4.2 Për mungesën e burimeve të ligjshme për huadhënien e sipërcituar, subjekti shpjegon se ky konstatim rezulton për shkak të konkluzionit të gabuar se subjekti ka paguar shumën prej 150,000 euro për pjesën e tij të blerë nga shtetasi H.A..

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

4.4.3 Në lidhje me shumën prej 4,300 euro dhënë hua shtetasit A.Sh., Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar burimin e krijimit të kësaj shume, duke saktësuar se burim është shitja e mjetit “\*\*\*\*”, për të cilën subjekti nuk arriti të provojë as blerjen dhe as shitjen e tij. Në këto kushte huaja në shumën 4,300 euro ka mbetur pa burim me të ardhura të ligjshme.

4.4.4 Në lidhje me kursimet familjare të deklaruara si burim krijimi, subjekti, edhe pas prapësimeve dhe seancës dëgjimore, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës së dërguar nga Komisioni. Edhe pas analizës financiare të rishikuar, pas marrjes në konsideratë të elementëve sipas pikave 2.15.6-2.15.14 të vendimit, subjekti rezulton me balancë negative në shumën 3,276,589 lekë, për intervalin kohor 1.2.2000-31.10.2010.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për burimin e huas në shumën 4,300 euro, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

**Subjekti i rivlerësimi ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën 3,276,589 lekë, për të mbuluar shpenzimet dhe për të justifikuar pasuritë në kuptim të në kuptim të germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

#### **5. Motoçikletë, me targa \*\*\*, prodhim i vitit 2004**

Motoçikleta është blerë nga shtetasi E.K. me kontratën nr. \*\*\*, datë 23.4.2014<sup>32</sup>. Burimi: nga shitja e automjetit tip “\*\*\*”, me targa \*\*\*, e shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 4.9. 2013<sup>33</sup>. Ky automjet ishte blerë me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, në datën 2.8.2010.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

5.1 Nga ana e subjektit kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në para fillimit të detyrës në vitin 2015, me burim nga shitja e automjetit “\*\*\*”, me targa \*\*\*. Vlera: 300,000 lekë.

5.2 Nga përgjigja e administruar nga DPSHTRr-ja<sup>34</sup> konfirmohet i regjistruar, në emër të shtetasit Emror Kasaj, mjetin motor me targa \*\*\*, përfituar nga kontrata e shitjes, datë 23.4.2014, me shitës E.K., për çmimin 300,000 lekë.

5.3 Komisioni vëren se të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit \*\*\*, në shumën prej 250,000 lekësh, nuk janë të mjaftueshme blerjen e motoçikletës për çmimin prej 300,000 lekësh, duke rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 50,000 lekë.

5.4 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasin E.K. dhe nga hetimi<sup>35</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

5.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se ky konstatim i Komisionit është përfundim i gabuar, për shkak të faktit të konsideruar të gabuar se nga subjekti është paguar shuma 150,000 euro dhe, për pasojë, bilanci i të ardhurave të tij është negativ.

5.5.1 Subjekti ka shpjeguar se automjeti \*\*\* është blerë me kredi në shumën 500,000 lekë. Pjesën shtesë prej 50,000 lekësh për blerjen e motoçikletës, subjekti e ka paguar nga kursimet e tij. Subjekti ka depozituar dhe provat përkatëse<sup>36</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

5.6 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit si burim për blerjen e motoçikletës në shumën 300,000 lekë, si në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit \*\*\*, në shumën 250,000 lekë. Subjekti në prapësime ka ndryshuar burim, ku përveç të ardhurave nga shitja e automjetit \*\*\* ka shtuar dhe shumën 50,000 lekë, si shumë e krijuar nga kursimet e tij, burim ky i padeklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të burimit të krijimit në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

**Subjekti i rivlerësimi ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën 50,000 lekë, për të mbuluar shpenzimet dhe për të justifikuar pasuritë, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

<sup>32</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 23.4.2014.

<sup>33</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 4.9. 2013.

<sup>34</sup>DPSHTRr-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020.

<sup>35</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021.

<sup>36</sup>Kontratë kredi bankare, datë 2.10.2008, marrë në “Raiffeisen Bank”; foto e automjetit me targa \*\*\*, kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 4.9.2013; kontratë blerje motoçiklete; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 17.12.2018.



## 6. Automjet tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\*, prodhim i vitit 2002

Për këtë automjet është paguar vetëm zhdoganimi në shumën 90,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: blerë nga bashkëpronari (mik i familjes në Angli).

6.1 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në para fillimit të detyrës në vitin 2015: *“Autoveturë tip ‘\*\*\*\*’, viti 2002, me targa \*\*\*. E ka blerë bashkëpronari, mik i familjes në Angli, ku figuron rezident. Blerë: 1,500 euro. Unë kam paguar vetëm tarifën e zhdoganimit në shumën 90,000 lekë. Pjesa takuese: 50%”*.

6.2 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRr-ja<sup>37</sup>, rezulton se automjeti tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\*, ka ardhur nga Anglia dhe certifikata angleze e regjistrimit të tij rezulton me emrin e shtetasve J. Xh. dhe Emror Kasaj, me datë 17.9.2014.

6.2.1 Në datën 17.9.2014, për këtë automjet është paguar taksa doganore në shumën 58,365 lekë nga shtetasi Emror Kasaj. Në dosje nuk ka dokument që të provojë çmimin e blerjes së këtij automjeti në Angli dhe mbetet e pashpjeguar se si është bërë regjistrimi në dokumentet anglez i Emror Kasaj. Në dokumentin doganor të datës 17.9.2014, te vlera e automjetit është pasqyruar shuma 250,000 lekë, në bazë të së cilës është paguar taksa doganore në shumën 58,365 lekë<sup>38</sup>. Me kontratën e datës 31.12.2018, shtetasit Emror Kasaj dhe J.Xh. i shesin automjetin blerësit T.Xh., me çmimin 4,000 euro.

6.3 Komisioni, me pyetësonin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë: se si është bërë regjistrimi i këtij mjeti në emrin e tij, kur subjekti nuk ishte rezident në shtetin anglez; lidhjen me shtetasin J. Xh., rrethanat e njohjes dhe nëse vijon ende shoqëria me të; të provojë me dokument ligjor vlerën e blerjes së mjetit në shtetin anglez; qëllimin e blerjes së mjetit nga miku J.Xh. dhe dhënien e këtij mjeti në formë “dhurimi”.

6.3.1 Subjekti ka shpjeguar se për regjistrimin e emrit të subjektit në lejen e qarkullimit angleze, kjo është bërë nga vetë shtetasi J. Xh., në Angli, pa qenë ai prezent, me qëllim përdorimi kur mjeti të vinte në Shqipëri. Për lidhjen me shtetasin J. Xh., subjekti ka shpjeguar se ishte nga fisi i bashkëshortit të tezes dhe ka njohur atë rastësisht, kur ka qenë me pushime në Vlorë, ku kishte ardhur nga Anglia për pushime. Gjatë bisedës me të u vu në dijeni që subjekti nuk kishte makinë dhe kur të vinte herës tjetër do sillte një të tillë që ta përdorte subjekti, por edhe ai gjatë qëndrimit në Shqipëri. Subjekti i ka propozuar që këtë mjet ta shisnin meqë ishte në krah të kundërt dhe të blinin një tjetër, ndërkohë që J. Xh. i ka thënë të bënte çfarë të donte vetëm ta njoftonte ku të shkonte të firmoste. Subjekti ka shpjeguar se pasi këtë mjet ia shiti një shoku të tij, që në atë moment nuk ka pasur kontakte me këtë person.

6.4 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasin J. Xh. dhe nga hetimi<sup>39</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

6.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

<sup>37</sup> DPSHTRr-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020.

<sup>38</sup> Derdhje në llogarinë e Agjencisë Doganore Tiranë, në “Raiffeisen Bank” të shumës 29,333 lekë, si gjobë për zhdoganim të mjetit, pasi kishin kaluar afatet ligjore; derdhje në llogarinë e Agjencisë Doganore Tiranë, në “Raiffeisen Bank”, të shumës 58,481 lekë, si taksë doganore e automjetit.

<sup>39</sup> Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2022 dhe Prokuroria e Rrethit Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

a) Është e paqartë lidhja e subjektit të rivlerësimit me shtetasin J. Xh., ku pas njohjes rastësore ai i sjell një automjet nga Anglia pa paguar asnjë vlerë për blerjen e tij përveç doganës dhe përfitimit të të gjithë shumës prej 4,000 euro nga shitja e automjetit;

b) Nga subjekti ka deklarime të dyshimta, lidhur me përfitimin e automjetit tip “\*\*\*”, për arsye se:

- dhurimi i automjetit tip “\*\*\*”, nga shtetasi J. Xh. bëhet pas njohjes rastësore;
- përdorimi i vazhdueshëm i automjetit nga subjekti i rivlerësimit;
- përfitimi i të ardhurave nga shitja e këtij automjeti në shumën 4,000 euro nga subjekti, ndërkohë që nuk ka ndonjë dokument që z. J. Xh. t’i dhurojë subjektit pjesën e tij takuese të përfituar nga shitja e automjetit;
- nuk ka kontakte me këtë person që nga shitja e automjetit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

6.6 Subjekti i rivlerësimit, përveç shpjegimeve të tij gjatë hetimit, në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar, ndër të tjera, se pjesën e çmimit që do t’i takonte nga shitja, z. J. Xh. nuk ia ka kërkuar, pasi është larguar. Edhe sot subjekti nuk është i qartë nëse ai nuk e do pjesën e tij të çmimit apo kur ta takojë do ta kërkojë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

6.7 Komisioni i konsideron jo bindëse shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit mbi blerjen e mjetit në Angli me dy emra, por pa u vërtetuar çmimi i blerjes, mospagimi nga ana e subjektit të asnjë pjese të çmimit të blerjes së mjetit dhe, më pas, sjellja e subjektit si pronar deri edhe në përfitimin e çmimit të shitjes prej 4,000 euro, në një kohë kur bashkëpronar ishte edhe vetë shtetasi J. Xh., i cili, më pas, humbet çdo kontakt me subjektin, pas shitjes së makinës.

6.7.1 Subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në vlerën 4,000 euro. Në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se shtetasi J. Xh. i ka thënë që të bënte çfarë të donte me këtë mjet (duke i lënë të kuptonte subjektit se dhe po ta shiste mjetin ai mund të përfitonte të ardhurat prej tij), ndërkohë që në prapësime deklaroi se edhe sot nuk është i qartë nëse J. Xh. e kërkon pjesën e tij nga shuma 4,000 euro apo jo.

Duke marrë shkas nga fakti që ky automjet është blerë me dy emra në shtetin anglez dhe është regjistruar me dy emra në Shqipëri, është përdorur gjithmonë nga subjekti i rivlerësimit (subjekti nuk ka provuar përdorimin e këtij mjeti nga shtetasi J. Xh.), pavarësisht se shitja e mjetit është bërë nga të dy bashkëpronarët dhe J. Xh. nuk ka tërhequr pjesën e tij nga çmimi i shitjes, humbja e kontaktit me këtë person pas shitjes së mjetit gjë që vë në dyshim serioz marrëdhënien shoqërore ndërmjet këtyre dy personave, **Komisioni arrin në përfundimin se nga subjekti i rivlerësimit janë kryer veprime që kanë pasur për qëllim fshehjen e pronësisë reale të këtij mjeti, veprime që bien ndesh me figurën e prokurorit duke cenuar besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

**Për rrjedhojë, vlera e automjetit e përcaktuar nga autoritetet doganore prej 250,000 lekësh është pasqyruar si pasuri e subjektit të rivlerësimit në analizën financiare.**

### **7. Detyrim ndaj nënës së bashkëshortes L. P., në shumën 50,000 euro**

Subjekti deklaroi se shumën 50,000 euro ia ka marrë hua M.L. (i cili ka pasur dhe emrin L.Sh.). Kjo shumë është kaluar nga llogaria e vjehrrës në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në

llogarinë e bashkëshortes së subjektit E.K., në BKT. Kjo shumë është tërhequr në datën 23.4.2014, nga BKT-ja. Shuma e detyrimit financiar: 50,000 euro.

## Hetimi i kryer nga Komisioni

7.1 Në DIPP-në para fillimit të detyrës 2015, subjekti ka deklaruar: *“Në vitin 2014 i kam dhënë shtetasit M.L. shumën 50,000 euro në formë huaje pa interes, pa dokumentacion. Kjo shumë është marrë nga vjehrra ime (transferuar nga llogaria e saj personale në bono thesari te Banka e Shqipërisë, në llogarinë e bashkëshortes time në BKT). Kjo shumë është tërhequr nga bashkëshortja ime dhe unë ia kam dhënë shtetasit të lartpërmendur cash. Kjo shumë i është dhënë për një javë afat dhe akoma nuk është kthyer dhe huamarrësi banues në Angli i shmanget nënshkrimit të kontratës së huamarrjes më shkrim para noterit (jam në konflikt)”*.

7.2 Komisioni ka hetuar llogarinë bankare të shtetasës L.P., nga e cila janë kaluar fondet për investimin në bono thesari. “Raiffeisen Bank”<sup>40</sup> konfirmon llogarinë rrjedhëse në monedhën euro në emër të L.P.. Në këtë llogari në datën 5.4.2011, znj. L.P. ka depozituar shumën 73,000 euro me përshkrimin “të ardhura kursime familjare”, shumë e cila kalohet po atë ditë në depozitë me afat. Të gjitha veprimet e kryera, më pas, në këtë llogari deri në mbylljen përfundimtare të saj janë kryer nga bashkëshortja e subjektit E.K., e cila është autorizuar nga znj. L.P. për të kryer veprime në llogari që nga data e hapjes së saj<sup>41</sup>.

Personi i autorizuar, bashkëshortja e subjektit, ka tërhequr *cash* interesat e akumuluar dhe në datën 23.10.2012 ka mbyllur llogarinë duke tërhequr *cash* shumën 70,000 euro.

7.2.1 Në datën 24.10.2012, bashkëshortja E.K. ka depozituar *cash* në llogarinë e saj pranë kësaj banke shumën 9,720,000 lekë, me përshkrimin “derdhur nga konvertimi euro/lekë tërhequr nga depozita në euro”, duke investuar në të njëjtën ditë shumën 9,700,000 lekë, në bono thesari, me afat 1-vjeçar, me datë emetimi më 1.11.2012.

7.2.2 Referuar kartelës së klientit në Bankën e Shqipërisë për znj. E.K.<sup>42</sup>, konfirmohet se me maturimin e bonove të thesarit në datën 31.10.2013, pas pagesës së tatimit mbi fitimin për interesat, shuma prej 1,139,946 lekësh (500,000 lekë tërhequr *cash* dhe 700,000 lekë transferuar në datën 21.11.2013, për blerje bono thesari) është kaluar në llogarinë rrjedhëse të znj. E.K., në “Raiffeisen Bank”, ndërsa pjesa tjetër prej 8,500,000 lekësh është bllokuar për pjesëmarrje në ankandin e radhës dhe në datën 14.11.2013, janë riinvestuar në bono thesari më afat 1-vjeçar.

7.2.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, konfirmohet se midis E.K. dhe BKT-së, në datën 17.4.2014 është lidhur një marrëveshje për shitblerje bono thesari<sup>43</sup> dhe nga shitja e bonove i është kredituar në llogarinë rrjedhëse në datën 18.4.2014, shuma 8,291,109 lekë, nga ku shuma prej 7,000,000 lekësh është tërhequr në datën 23.4.2014 dhe pjesa e mbetur është tërhequr gradualisht kryesisht në vitin 2014.

7.3 Komisioni ka administruar përgjigjen e noteres D. K., datë 1.12.2021<sup>44</sup>, e cila deklaroi se znj. M.E. ( K.), në datën 24.4.2014 ka kaluar në llogarinë e saj si notere shumën 7,000,000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, pa asnjë akt notarial, vetëm me deklaram në bankë për blerje pasurie të

<sup>40</sup>“Raiffeisen Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020.

<sup>41</sup>“Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2021, konfirmon autorizimin me datë 5.4.2011.

<sup>42</sup>Banka e Shqipërisë”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, i ka konfirmuar Komisionit të njëjtin informacion.

<sup>43</sup>E. K., sipas vërtetimit mbi shpalljen fituese në ankand, ka zotëruar në Bankën e Shqipërisë nga data 14.11.2013 bono thesari me vlerë nominale 8,500,000 lekë.

<sup>44</sup> Protokolluar në Komision me nr.\*\*\* prot., datë 1.12.2021.

paluajtshme. Noterja ka hartuar draftin e kontratës së shitjes, e cila nuk u realizua. Më 20.8.2021 noterja ka kthyer shumën prej 7,000,000 lekësh.

Noterja D. K., ka depozituar bashkë me shkresën dokumentacionin: (i) nxjerrje llogarie, datë 26.11.2021, nga “Raiffeisen Bank”, në emër personi fizik D. K., ku pasqyrohet veprimi i datës 24.4.2014, depozitimi nga znj. M.E. (blerje pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f.\*\*\*, z. k.\*\*\*) i shumës 7,000,000 lekë; (ii) dokument nga “Raiffeisen Bank”, datë 20.8.2021, me urdhërues personi fizik D. K., kthim fondesh në shumën 7,000,000 lekë (për mosrealizim kontrate shitblerje e bazuar në deklaratën e noteres M.E.), me përfitues M.K. me llogari në BKT.

7.4 Në dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja rezulton prokura e posaçme, datë 5.9.2016<sup>45</sup>, me deklaruese M.E. (K.) banuese në SHBA, si e përfaqësuar, e cila emëron përfaqësues të posaçëm vëllain Emror Kasaj, që në emër të saj, ndër të tjera, e autorizon: *“Përfaqësuesi im ka të drejtë të paraqitet pranë zyrës noteriale të noteres D. K., me qëllim të tërheqë shumën prej 7,000,000 lekësh që unë kam depozituar pranë ‘Raiffeisen Bank’, në llogarinë bankare të noteres për blerjen e një pasurie, tokë arë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*<sup>46</sup>, f. \*\*\*, ZVRPP-ja Tiranë, pasi kjo kontratë nuk u realizua dhe për shumën e mësipërme ai mund të disponojë sipas dëshirës pa pasur asnjë lloj kufizimi nga ana ime”.*

7.5 Komisioni ka administruar përgjigjen e “Raiffeisen Bank”<sup>47</sup>, e cila konfirmon se nga znj. M.E. në datën 24.4.2014 është depozituar *cash* shuma 7,000,000 lekë në llogaritë të personit fizik D. K. me përshkrim “M.E., blerje pasuri \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*”.

7.6 Komisioni ka administruar përgjigjen<sup>48</sup> e BKT-së, e cila konfirmon se në datën 16.8.2021 nga znj. M.K. (E.) është hapur llogaria dyemërore në monedhën lekë, M.K. ose A.K. Në këtë llogari në datën 20.8.2021, nga personi fizik D. K., është transferuar shuma 7,000,000 lekë.

7.7 Subjekti në pyetësorin nr. 2 ka deklaruar se shumën prej 50,000 euro ia ka dhënë hua shtetasit M.L. në dhjetor të vitit 2010. Këto para janë pjesë e shumës prej 140,000 euro që i ishin dhënë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Ndërsa nga vjehrra L.P. ka marrë hua në vitin 2014 shumën prej 50,000 euro për të likuiduar diferencën e mbetur për t’iu paguar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

7.8 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka deklarime kontradiktore/të rreme të subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e shumës së dhënë hua shtetasit M.L., për arsye se në DIPP-në para fillimit të detyrës 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, deklarohet si burim huaja marrë në vitin 2014 vjehrrës prej 50,000 euro, ndërsa përgjatë hetimit deklarohet si burim një pjesë e shumës prej 140,000 euro marrë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2010.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

7.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se në DIPP-në para fillimit të detyrës 2015 ka deklaruar se këto para ia ka marrë vjehrrës dhe ia ka dhënë shtetasit M.L.. Në këtë deklaratë të vitit 2015, subjekti ka

<sup>45</sup>Prokura nr.\*\*\*, datë 5.9.2016.

<sup>46</sup>Komisioni vëren se pasuria tokë “arë” me të dhënat nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\* (duhet të jetë lapsus tek prokura), f. \*\*\*, ZVRPP-ja Tiranë është e njëjta pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, tokë arë 1000 m<sup>2</sup>, që tashmë ishte i blerë nga shtetasit Emror Kasaj dhe M.L..

<sup>47</sup>“Raiffeisen Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2021.

<sup>48</sup>BKT-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2021.

deklaruar kreditorin e fundit (vjehtëren) dhe debitorin e fundit (M.L.), pasi në datën e deklarimit shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., nuk ka qenë as debitori dhe as kreditori i tij.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

7.10 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me deklaratimet kontradiktore nga ana e tij. Subjekti i rivlerësimit vetëm pas kalimit të barrës së provës, në prapësimet e tij, ka bërë ndryshim të burimit të shumës së dhënë hua duke e konsideruar si pamundësi deklarimi, për shkak të mënyrës së ndërtimit të formularëve të deklaratave të pasurisë.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të burimit të huas dhënë shtetasit M.L., në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

**8. Hua marrë shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në shumën 140,000 euro pa dokument noterial (deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ si burim për huan prej 50,000 euro dhënë M.L., në vitin 2010)**

8.1 Subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard ka deklaruar se ka marrë hua një shumë prej 140,000 euro, pa dokument noterial nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. (e cila ka vepruar në kushte mirëbesimi, për shkak të njohjes dhe respektit reciprok), me të cilën kishte rënë në marrëveshje që të ndërtonte për llogari të tij dhe ortakut, për të paguar pjesën që i përkiste subjektit për shpenzimet e kryera nga shitësi H.A., për objektin e paligjshëm, i cili do të prishej për efekt të ndërtimit të ri.

8.1.1 Në pyetësorin 2, subjekti, ndër të tjera<sup>49</sup>, ka shpjeguar se shitësit i kishin vënë në vështirësi për të vërtetuar kushtet e kontratës, fakt për të cilin ata si blerës ua dorëzuan edhe pjesën tjetër të çmimit me paratë e dhëna nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. Në vijim të shpjegimeve, subjekti deklaroi se kjo shumë që ishte marrë nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., nuk u përdor, pasi nuk u lidh marrëveshja me shitësit. Nga shtetasi M.L. subjektit i është kërkuar hua shuma 50,000 euro për një afat 1-javor dhe ka dhënë dorazi pa një dokument të shkruar. Ky shtetas nuk ia ka kthyer shumën e kërkuar deri më tani.

Subjekti ka deklaruar se i ka kthyer shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., vetëm pjesën e mbetur prej 90,000 euro nga shuma që i kishte dhënë, ndërsa shumën tjetër prej 50,000 euro ia ka kthyer dorazi vetëm pas 4 vjetësh, pasi ia ka marrë hua vjehtëren L.P., e cila i kishte depozituar disa vite më parë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë.

8.1.2 Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën e pasurisë ka deklaruar debitorin e M.L. dhe kreditorin e fundit vjehtëren e tij, duke qenë se shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., nuk ishte më as debitor dhe as kreditor (subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të huas dhënë shtetasit M.L., llogarinë bankare të vjehtëren).

8.1.3 Subjekti, me pyetësorin nr. 2, ka depozituar një deklaratë noteriale të datës 26.11.2021<sup>50</sup> me deklarues shtetasin Sh.F., i cili deklaroi se në fillim të vitit 2010 ka hyrë në marrëveshje paraprake me gojë për bashkëpunim për ndërtim. Për të ndihmuar me procedurat ai i ka dhënë në mirëbesim Emror Kasaj *cash* shumën 140,000 euro, shumë e krijuar nga biznesi që ka pasur

<sup>49</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, për detaje në dosje.

<sup>50</sup>Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 26.11.2021.

dhe vazhdon ta ketë. Meqenëse Emror Kasaj kishte konflikte për pronën dhe prona nuk po dorëzohej, z. Sh. F. i kërkoi atij kthimin e shumës shumën 90,000 euro, të cilën Emror Kasaj e kthen pas një viti dhe e merr, po *cash*. Ndërsa pjesa e mbetur prej 50,000 euro i është kthyer z. Sh. F., në vitin 2014, po *cash*. Z. Sh.F. deklaron se Emror Kasaj nuk ka më asnjë detyrim financiar.

8.1.4 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe administratorin/ortakun Sh. F. dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>51</sup>.

8.1.5 Nga dokumentacioni në fashikull ka rezultuar se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe administratori/ortaku Sh. F. kanë pasur disa kallëzime/procedime penale (kallëzues apo dhe i kallëzuar)<sup>52</sup>, por nuk ka rezultuar që subjekti Emror Kasaj të ketë qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes.

8.2 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka ngritur dyshime në lidhje me huan e marrë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në lidhje me ekzistencën reale të këtij veprimi, pasi rezulton se subjekti:

a) Nuk ka deklaruar huan e dhënë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në DIPP-në para fillimit të detyrës të vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, si burim për shumën 50,000 euro dhënë hua M.L. në vitin 2010, por e deklaron atë vetëm në pyetësorë.

b) Nuk ka provuar me dokumentacion ligjor marrjen e saj në vitin 2010 dhe as kthimin e saj në shumën 90,000 euro, në vitin 2011 dhe shumën 50,000 euro, në vitin 2014.

c) Nuk ka paguar interesa për shumën e huas edhe pse nuk u realizua ndërtimi dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ishte më palë e interesuar në këtë investim dhe subjekti nuk deklaron të ketë njohje shoqërore me administratorin/ortakun e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

d) Ka deklarime kontradiktore në lidhje me shumën 140,000 euro, pasi në pyetësor fillimisht deklaron se kjo shumë iu dorëzua shitësve për plotësimin e çmimit të objektit, ndërkohë, më pas, po në pyetësor, deklaron se kjo shumë nuk u përdor për blerjen e objektit dhe iu kthye shoqërisë në shumat 90,000 euro, në vitin 2011 dhe 50,000 euro në vitin 2014.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

8.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se huaja e marrë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. është reale dhe jo fiktive.

8.3.1 Subjekti bashkë me prapësimet ka depozituar një kontratë huaje (jo noteriale) e lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas së cilës kjo shoqëri do të ndërtonte mbi tokën me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe i jepte subjektit me qëllim likuidimin e çmimit të blerjes shumën 140,000 euro. Kjo kontratë ka shënimin e bërë prej subjektit “e papërdorshme, ka gabim në muaj”.

8.3.2 Sipas subjektit kontrata është përpiluar nga një person që merrej me hartime aktesh të ndryshme me zyrë pranë gjykatës civile. Ky person i panjohur për subjektin duke pasur në dispozicion kontratën e shitjes ka menduar se shuma 140,000 euro ishte dhënë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përpara kësaj date, ka vënë datën 22.3.2010, por data e dhënies së kësaj shume

<sup>51</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2021.

<sup>52</sup>Kallëzimi nr. \*\*\* prot.; kallëzimi penal nr. \*\*\*; procedimi penal nr. \*\*\* prot.; procedimi penal nr. \*\*\* prot.; procedimi penal nr. \*\*\* prot.; kallëzimi penal nr. \*\*\* prot.; kallëzimi penal nr. \*\*\* prot.; procedimi penal nr. \*\*\* prot.; procedimi penal nr. \*\*\* prot.; procedimi penal nr. \*\*\* prot.

nuk është kjo në kontratë, por ka qenë muaji shtator ose maksimumi tetor i vitit 2010, data nuk kujtohet. Ky dokument nuk është përdorur kurrë nga subjekti sepse nuk ka qenë e nevojshme nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., prandaj është konsideruar si dokument i paqenë, sikur nuk ka ekzistuar.

8.3.3 Subjekti ka referuar dhe materialin *audio* të datës 9.12.2010 të transkriptuar, ku në bisedë, ndër të tjera, i ka thënë ortakut M.L. [...] *unë i kam hua atij zotërisë, ndërsa ti nuk i ke kujt hua. ...para një jave kur mi more unë i kisha të botës dhe t'i dhashë [...]*. Subjekti sqaron se ky regjistrim *audio* provon faktin se huaja e marrë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ekziston që në vitin 2010 dhe nuk është sajuar nga subjekti për efekt të procesit *Vetting* dhe paratë e marra nga llogaria e vjehrrës në vitin 2014 nuk ia ka dhënë M.L., por ka shlyer, pikërisht, huan ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

8.3.4 Faktin e marrjes së shumës prej 140,000 euro shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti e provon edhe me vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 20.11.2010, ku pasqyrohet.

8.3.5 Subjekti i rivlerësimit është pyetur, gjithashtu, në seancën dëgjimore të datës 5.5.2022 nga vëzhguesi ndërkombëtar, nëse kishte njohje të mëparshme me shtetasin Sh. F. dhe se çfarë do t'i jepte atij në këmbim.

8.3.5.1 Subjekti është përgjigjur në seancë se nuk ka pasur njohje të mëparshme me shtetasin Sh. F., por u njoh me të gjatë bisedimeve për të ndërtuar në tokën arë me sip. 1000 m<sup>2</sup>. Në këmbim të shumën prej 140,000 euro, subjekti do t'i jepte pronën nga ku do të përfitonte apartamente pas ndërtimit.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

8.4 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me huan e marrë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se kjo hua nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti. Marrëdhënia e huas nuk u provua asnjëherë gjatë hetimit administrativ dhe mbetet në kuadër deklarativ, si nga subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe nga ortaku/administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Po kështu, nuk u provua me dokument të kohës kthimi i një pjese të huas në shumën 90,000 euro, sikurse nuk u provua edhe kthimi i pjesës tjetër prej 50,000 euro pas 4 vjetësh në vitin 2014.

8.4.1. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, bashkë me prapësimet depozitoi një kontratë huaje (jo noteriale) e datës 22.3.2010 e lidhur me z. Sh. F.(administrator i \*\*\* sh.p.k), për dhënie e huas në shumën 140,000 euro subjektit për periudhën 22.3.2010 – 22.3.2015. Në faqen 1 të kësaj kontrate ka shënimin “gabim muaji, nuk mund të përdoret”. Ekzistenca e këtij dokumenti nuk është përmendur më parë nga subjekti.

8.4.2. Në lidhje me datën e lidhjes së kontratës (meqenëse ishte dhe shkak që sipas subjektit kontrata e huas nuk u paraqit asnjëherë, pasi data 23.3.2010 ishte gabim dhe se data e saktë do ishte shtator-tetori 2010), subjekti bie në kontradiktë me deklaramet e tij dhe me deklarin e z. Sh. F. në deklaratën noteriale, datë 26.11.2021, ku deklaroi se në fillim të vitit 2010 kishte krijuar marrëveshje paraprake verbale me z. Emror Kasaj për bashkëpunim dhe i ka dhënë *cash* shumën 140,000 euro.

8.4.3. Tjetër deklarin kontradiktor i subjektit për shumën 140,000 euro është se në pyetësin nr. 2 subjekti ka deklaruar që për pasurinë truall me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe ndërtesën mbi të u

dorëzuan (subjekti bashkë me ortakun M.L.) shitësve edhe pjesën tjetër të çmimit me paratë e dhëna nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., ndërkohë në një paragraf tjetër të këtij pyetësoni subjekti deklaroi se kjo shumë që ishte marrë nga kjo shoqëri nuk u përdor, pasi nuk u lidh marrëveshja me shitësit<sup>53</sup>.

**Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provon ekzistencën formale të marrëdhënies së huas me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., si dhe as burimin e krijimit të këtyre të ardhurave.**

**Pavarësisht nëse marrëdhënia e huas me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. ka ekzistuar apo jo, Komisioni krijon bindjen se subjekti e ka përdorur këtë marrëdhënie për të justifikuar burimin e shumës prej 50,000 euro dhënë hua M.L. në vitin 2010, por nisur nga fakti se subjekti nuk e ka deklaruar as në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2015 dhe as në deklaratën *Vetting*, huan e dhënë nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., si burim për huan e dhënë nga subjekti shtetasit M.L., në shumën 50,000 euro, e çon subjektin në kushtet e një deklarimi të rremë në lidhje me burimin e kësaj huaje, parashikuar në pikën “ç”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, Komisioni e ka pasqyruar shumën prej 50,000 euro, si pasuri të subjektit të rivlerësimit në analizën financiare për vitin 2010.**

**Për sa më sipër, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të subjektit shumën 140,000 euro të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.**

**Deklarimet kontradiktore të subjektit, përbëjnë sjellje jo të përshtatshme të një prokurori, që vlerësuar në një këndvështrim etik dhe tërësor të sjelljes së tij, kanë cenuar në nivel të mjaftueshëm besimin e publikut të drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

**9. Në lidhje me burimin e të ardhurave të vjehrrës L.P., për krijimin e shumës 73,000 euro, kaluar në llogari të bashkëshortes së subjektit E.K. , shërbyer si burim për huan në shumën prej 50,000 euro dhënë shtetasit M.L.**

9.1 Subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard ka deklaruar si burim për llogarinë bankare të vjehrrës L.P. aktivitetet financiare në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit, K.P.dhe L.P.

9.1.1 Në lidhje me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së subjektit L. dhe K. P., subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e tyre nga punësimi dhe aktiviteti tregtar.

9.1.2 Për vjehrrin K.P., subjekti ka shpjeguar se për periudhën 1991 – 1995 ka qenë emigrant në Greqi. Në vitet 1995 – 2002 ka ushtruar aktivitetin si shitës fruta-perime me automjet. Nga viti 2002 dhe në vazhdim ka ushtruar aktivitetin tregtar në fushën e shitjes së materialeve të ndërtimit.

9.1.3 Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e tij nga punësimi dhe aktiviteti privat tregtar. Gjithashtu, subjekti ka depozituar disa *statemente* bankare të derdhjes së shumave monetare nga shoqëria minerare e bitumit \*\*\*, Vlorë, për blerje materiale ndërtimi (këtë aktivitet e ushtron ende dhe kjo vërtetohet nga pagesat në DRT-në Vlorë).

---

<sup>53</sup>Për detaje shihni pyetësonin nr. 2.



9.2 Komisioni ka administruar përgjigjen e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë<sup>54</sup>, e cila konfirmon personin fizik “\*\*\*\*”, më \*\*\*, me NIPT \*\*\*, me aktivitet tregti me pakicë e artikujve të ndryshëm vegla pune dhe materiale ndërtimi. Subjekti është regjistruar në DRT-në Vlorë, më 25.3.2003. Në këtë përgjigje pasqyrohen të dhënat tatimore, si vijon:

Viti	Qarkullimi	Fitimi
2005	2,600,000	ska info
2006	2,000,000	ska info
2009	2,100,000	480,000
2010	1,500,000	225,000
2011	1,680,000	480,000

9.2.1 DRT-ja Vlorë konfirmon se shtetasja L.P. nuk figuron e regjistruar si tatimpaguese apo si punëmarrëse në regjistrat e administratës tatimore.

9.2.2 Komisioni konstaton se fitimi i konfirmuar nga DRT-ja Vlorë, për subjektin K.P., në periudhën 2003 – 2011, është në shumën 1,185,000 lekë, shumë kjo e pamjaftueshme për të krijuar shumën 73,000 euro. Edhe nëse Komisioni për vitet 2003 – 2006 dhe 2007 – 2008, për të cilat mungojnë të dhënat tatimore në lidhje me fitimin e realizuar, do të përlllogariste fitimin e mundshëm bazuar në normën mesatare të fitimit për vitet 2009 – 2011, subjekti tregtar do të rezultonte me një fitim total hipotetik, për periudhën prill 2003 – mars 2011, në shumën 3,102,000 lekë, shumë kjo përsëri e pamjaftueshme për të krijuar vlerën 73,000 euro.

Viti	Qarkullimi	Fitimi
2003	750,000	165,000
2004	1,000,000	220,000
2005	2,600,000	572,000
2006	2,000,000	440,000
2007	2,000,000	440,000
2008	2,000,000	440,000
2009	2,100,000	480,000
2010	1,500,000	225,000
2011	420,000	120,000
Totali	14,370,000	3,102,000

9.3 Komisioni ka hetuar dhe në lidhje me pasuritë e tjera të shtetasve K. dhe L.P., duke administruar përgjigjet e ASHK-së<sup>55</sup>, e cila konfirmon se kanë në pronësi një apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Vlorës, të përfituar nga privatizimi në vitin 1997, blerë me vlerën 9,550 lekë.

<sup>54</sup>Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2021.

<sup>55</sup>ASHK-ja Vlorë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2020.

9.3.1 Po kështu, ASHK-ja<sup>56</sup> konfirmon se shtetasja L.P. ka blerë me kontratë porosie<sup>57</sup> apartament me sip. 110 m<sup>2</sup>, me çmimin 4,700,000 lekë, paguar në vitet 2004-2005.

9.3.2 Komisioni ka administruar, gjithashtu, përgjigjen e DPSHTRR-së<sup>58</sup> për verifikimin e mjeteve të blera apo të shitura nga shtetasit K. dhe L.P.. Nga dokumentacioni rezulton se shtetasi K.P. ka blerë: (a) në vitin 2003<sup>59</sup> automjetin, me targa \*\*\*, me vlerën 60,000 lekë, i cili është çregjistruar në vitin 2011; (b) në vitin 2004<sup>60</sup> automjetin, me targa \*\*\*, me vlerën 250,000 lekë, të cilin e disponon ende; (c) në vitin 2008<sup>61</sup> automjetin, me targa \*\*\*, me vlerën 300,000 lekë, i cili është çregjistruar në vitin 2011.

9.3.3 Komisioni ka kryer verifikimet në lidhje me likuiditetet e disponuara nga prindërit e bashkëshortes në bankat e nivelit të dytë nga ku ka rezultuar se deri në datën 5.4.2011 (data e depozitimit të shumës 73,000 euro nga znj. L.P.) kanë disponuar depozita bankare me vlerën totale 1,975,713 lekë<sup>62</sup>.

9.4 Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes L. dhe K. P. për krijimin e shumës 73,000 euro ose 10,282,050 lekë konvertuar me kursin e këmbimit të euro së datës 5.4.2011, prej 140.85 lekë/euro.

Nga analiza e fakteve të sipërcituara, të ardhurat nga aktivitetet tregtare të prindërve të bashkëshortes, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si burim për krijimin e shumës 73,000 euro, edhe nëse do të merreshin në analizë në vlerën e fitimit hipotetik, jo vetëm që nuk janë të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume, por duket se ato janë konsumuar për krijimin e pasurive të tjera të paluajtshme (blerja e shtëpisë në shumën 4,700,000 lekë, në vitet 2004-2005) dhe të luajtshme (blerja e automjetit në shumën 300,000 lekë, në vitin 2008 dhe krijimi i depozitave në shumën 1,975,000 lekë) të krijuara para datës 5.4.2011 të depozitimit të shumës 73,000 euro.

Komisioni, gjatë fazës së hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, nga administrimi i dokumentacionit bankar dhe çdo dokumentacioni tjetër për burimin e ligjshëm të shumës 73,000 euro, konstaton se:

- a) Znj. L.P. dhe bashkëshorti i saj, rezultojnë me pamundësi financiare për krijimin e shumës 73,000 euro të depozituar në “Raiffeisen Bank”.
- b) Shuma 73,000 euro është tërhequr nga llogaria e znj. L.P., nga E.K. si person i autorizuar dhe, më pas, e ka investuar në bono thesari për llogari të saj. Autorizimi nga L.P. ka qenë vetëm për të kryer veprime në emër dhe për llogari të saj vetëm në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”.

<sup>56</sup>ASHK-ja Vlorë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2020.

<sup>57</sup>Kontratë porosie me nr. \*\*\* rep., datë 14.12.2004, me palë investitore N.L. dhe B.H. dhe porositës L.P.

<sup>58</sup>DPSHTRR-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020.

<sup>59</sup>Kontratë me nr. \*\*\*, datë 18.2.2003.

<sup>60</sup>Kontratë me nr. \*\*\*, datë 1.11.2004.

<sup>61</sup>Kontratë me nr. \*\*\*, datë 14.11.2008.

<sup>62</sup>Depozitë në “Alpha Bank”, në emër të L.P. me gjendje 359,210 lekë, në datën 5.4.2011, konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020; depozitë në BKT në emër të L. dhe K. P. me gjendje 790,543 lekë, në datën 5.4.2011, konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020; depozitat në OTP në emër të L.P. me gjendje 400,000 lekë, 225,960 lekë dhe 200,000 lekë, në datën 5.4.2011, konfirmuar me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020.

- c) Shuma prej 73,000 euro e depozituar njëherazi në *cash*, në llogari bankare nga znj. L. P. është dukshëm shumë më e madhe se shumet e tjera të depozituara më herët në llogari bankare, po nga L. P. të cilat nuk e kalojnë shumën 1,000,000 lekë secila.
- d) Znj. E.K. rezulton person i autorizuar vetëm në këtë llogari të nënës së saj duke kryer të gjitha veprimet në emër e për llogari të saj edhe pse përgjatë viteve prindërit e saj kanë pasur disa llogari/depozita të tjera bankare në emrin e tyre.
- e) Në lidhje me burimin e huas dhënë shtetasit M.L., në shumën 50,000 euro, ka deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, ku në deklaratën *Vetting* deklaroi tërheqjen e datës 23.4.2014 (burim i së cilës është shuma 73,000 euro), ndërsa në pyetësin standard deklaroi huan e marrë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.
- f) Depozitimi në datën 24.4.2014 i shumës 7,000,000 lekë nga M.E. (nuk ka të dhëna si është transferuar kjo shumë në Shqipëri) në llogarinë e noterës për blerjen e një pjese të tokës arë me sip. 1000 m<sup>2</sup> dhe godinës mbi të në \*\*\*, korrespondon me shumën 7,000,000 lekë të tërhequr nga bashkëshortja e subjektit një ditë më parë, pikërisht më 23.4.2014.
- g) Lëshimi i prokurës së posaçme në vitin 2016 nga M.E. për subjektin, sipas të cilës ai mund të disponojë sipas dëshirës, pa pasur asnjë lloj kufizimi prej saj, të shumës 7,000,000 lekë derdhur në llogari të noterës.
- h) Znj. M.E., në datën 21.8.2021 të hapjes së llogarisë dy emërore në BKT, ku i është kthyer shuma 7,000,000 lekë nga noterja, nuk ka rezultuar të ketë qenë prezent në Shqipëri, sipas sistemit *TIMS*, edhe pse nga dokumentacioni bankar rezulton se ka nënshkruar hapjen e llogarisë dyemërore.
- i) Nuk është deklaruar kthim huaje për llogari të znj. L.P. në deklaratat periodike vjetore.

9.5 Komisioni, për sa më sipër konstatuar, ngre dyshime se llogaria bankare e znj. L.P., në shumën 73,000 euro, deklaruar si burim për huan 50,000 euro, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

9.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se paratë e vjehrrës i ka marrë nëpërmjet bankës dhe kjo provon në mënyrë të padyshimtë ekzistencën e tyre. Fakti që në atë kohë subjekti ka qenë me hua në vlera të mëdha dhe në pamundësi pagueuse, e vërtetuar në shpjegimet e mësipërme, e bën të pamundur faktin që këto para të jenë të subjektit.

9.6.1 Subjekti ka shpjeguar se për dyshimet e Komisionit që shuma 7,000,000 lekë, marrë hua nga paratë e vjehrrës së tij, ngjan në kohë dhe sasi edhe me shumën 7,000,000 lekë të derdhur në llogarinë e noterës D. K., nga motra M.K., shpjegon se në këtë ngjashmëri nuk ka asgjë që shkon në kundërshtim me logjikën dhe rrjedhën e ngjarjeve, pasi këto dy shuma nuk ngjajnë në kohë dhe në sasi vetëm me njëra-tjetrën, por edhe me një shumë tjetër të njëjtë në kohë dhe vlerë, por në valutë pound britanik të lëna nga burri i tezes Nj. Xh., shumë të cilën subjekti e ka mbajtur rreth një muaj në kasafortën e një kolegu në zyrën e tij në vitin 2014 në pritje të nënshkrimit të kontratës nga ortaku M.L.. Pra, të dy shumet nga 7,000,000 lekë dhe shuma e parave në pound britanik, të konvertuara në euro janë në fakt tri shuma. ku të tria bëjnë 150,000 euro. Pra, përputhja e tri shumave të tilla në sasi dhe kohë është pikërisht se kontrata për shitjen e të tri pjesë të pronës së M.L., do të ndodhte në të njëjtën kohë dhe te i njëjti noter ku ishin përgatitur dhe draft kontratat.

9.6.2 Për aftësitë pagueuse të prindërve të bashkëshortes, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si më lart.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

9.7 Komisioni vëren se në lidhje me barrën e provës që shuma 73,000 euro është pasuri e fshehur e tij dhe personit të lidhur bashkëshortes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se fakti që paratë e vjehrrës i ka marrë nëpërmjet bankës kjo provon, padyshim, ekzistencën e tyre, si dhe fakti që ka qenë me hua dhe në pamundësi financiare e bën të pamundur faktin që këto para të jenë të tijat, janë jo bindëse.

9.7.1 Komisioni, në mënyrë kronologjike gjatë hetimit administrativ, ka trajtuar me hollësi historikun e shumës 73,000 euro, ku L.P. në datën 5.4.2011 ka depozituar *cash* në llogari të saj në “Raiffeisen Bank” shumën 73,000 euro, me përshkrim “të ardhura, kursime familjare”, në depozitë pa afat. Të gjitha veprimet e kësaj llogarie kryhen nga E.K. (bashkëshortja e subjektit), e cila është e autorizuar nga nëna e saj për kryerjen e veprimeve vetëm për këtë llogari, ndërkohë që L.P. dispononte llogari të tjera bankare veprimet e të cilave i kryente vetë. I pyetur gjatë hetimit administrativ se përse L.P. autorizonte vajzën e saj për të vepruar vetëm në këtë llogari, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim.

9.7.2 Nga veprimet bankare duket qartë se këto para nuk kanë kaluar nga vjehrra L.P. te subjekti, por nga bashkëshortja e subjektit janë tërhequr *cash* nga llogaria e nënës dhe janë depozituar në llogari në emrin e saj dhe, më pas, janë tërhequr në vitin 2014. Pra, burimi i supozuar i shumës 7,000,000 lekë nuk janë paratë e marra hua nga vjehrra, por janë para të tërhequra nga llogaria në emër të bashkëshortes së subjektit.

9.7.3 Element tjetër që kundërshton deklarinimin e subjektit se paratë janë të vjehrrës është se nga subjekti nuk u arrit të provohej mundësia financiare e prindërve të bashkëshortes së subjektit për të krijuar shumën 73,000 euro të supozuara nga subjekti si burim për dhënien e huas shtetasit M.L.. Komisioni hetoi, nën cilësinë e personave të tjerë të lidhur, burimin e krijimit të shumës 73,000 euro të pretenduar nga subjekti si pasuri e prindërve të bashkëshortes dhe nga hetimi rezultoi se ata ishin dukshëm në pamundësi financiare për kursimin dhe depozitim në bankë të shumës 73,000 euro.

9.7.4 Gjithashtu, shuma 7,000,000 lekë tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datën 23.4.2014, korrespondon me veprimin e një dite më pas, pikërisht, më 24.4.2014, ku motra e subjektit M.E. depoziton po të njëjtën shumë 7,000,000 lekë në llogari të noteres D. K., në “Raiffeisen Bank”, për blerje pasurie tokë arë me sip. 1000 m<sup>2</sup>, në një kohë kur nuk ishte përpiluar ende një dokument ligjor noterial përfundimtar.

9.7.4.1 Në vijim të këtyre veprimeve, në mënyrë të pashpjegueshme shuma 7,000,000 lekë mbeti në llogari të noteres D. K., për 7 vjet pa u tërhequr nga M.E. deri më 16.8.2021, datë kur noterja D. K., kaloi këtë shumë në BKT në llogarinë dyemërore në emër të M.K. dhe A.K. (vëllai i subjekti) të hapur në datën 16.8.2021.

9.7.4.2 Në lidhje me hyrje-daljet në sistemin *TIMS* të M.E. në datën 16.8.2021, subjekti në prapësime depozitoi si provë testin COVID të datës 21.8.2021, si dhe rezervimin e biletës së avionit në emër të M. E. dhe familjarëve të saj me datë dalje nga Shqipëria me 22.8.2021, prova të cilat Komisioni i mori në konsideratë.

9.7.5 Edhe në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma 7,000,000 lekë e depozituar nga motra M.E. në llogari të noteres janë lekët e motrës dhe jo të subjektit dhe bashkëshortes, gjatë hetimit administrativ subjekti nuk u investua të bindë Komisionin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 7,000,000 lekë të pretenduar si pasuri e motrës së tij. Subjekti nuk shpjegoi se si u soll kjo shumë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, si dhe ku u mbajt kjo shumë gjatë kësaj periudhe meqenëse gjatë gjithë kohës është pranuar nga subjekti se ishin para të motrës.

**Komisioni, bazuar në analizën si më sipër, arrin në përfundimin se shuma 73,000 euro, e pretenduar si shumë në pronësi të vjehrrës së subjektit, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortes, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e gremës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm të parashikuar nga pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

**Subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij, deklaratimet kontradiktore, përfshirjen e personave të tretë për fshehjen e kësaj pasurie, shfaq elementë të një sjellje jo etike dhe jo të përshtatshme të një magjistrati duke cenuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

## **10. Analiza financiare**

10.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës *Vetting*, për periudhën e hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në shumën 31,003,373 lekë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

10.2 Subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe provat e depozituara në prapësime, si dhe në seancë dëgjimore, të cilat janë trajtuar gjerësisht në pikat 2.15.6 – 2.15.14 të vendimit, kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se për periudhën 1.2.2000 – 31.10.2015, analiza e kryer, fillimisht prej ekspertës dhe më pas prej tij, rezulton me balancë pozitive në vlerën prej 1,717,477 lekësh.

10.3 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në konsideratë një pjesë të pretendimeve të subjektit, sipas konkludimeve të analizuara në pikën 2.16.7 të vendimit, i pasqyroi ato në analizën financiare të rishikuar, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të janë në pamundësi financiare në vlerën prej 12,405,424 lekësh, që me burime të ligjshme të përballojnë shpenzimet dhe krijojnë pasuritë, nga të cilat 12,347,866 lekë para fillimit të detyrës dhe 57,558 lekë gjatë ushtrimit të detyrës.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të burimit të huas në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

**Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Komisionit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe deklarim të rremë dhe fshehje të pasurisë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, germave “c” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Pamjaftueshmëria e burimeve financiare në shumën prej 12,347,866 lekësh, pavarësisht se është krijuar para emërimit të subjektit në detyrë si prokuror, çka në vetvete përbën një rrethanë lehtësuese, marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, konsiderohet nga Komisioni si më se e mjaftueshme për të vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, në një vlerësim tërësor të deklarimeve të subjektit nëpër deklaratat e pasurisë, përgjatë hetimit, si dhe provave të administruara, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, duke u ndodhur në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, ndaj subjektit duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

Përshkrimi	1.2.2000- 31.10.2015	1.11.2015- 31.12.2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>11,110,574</b>	<b>238,549</b>	<b>1,127,070</b>
Të ardhurat nga paga e subjektit	9,492,609	238,549	1,127,070
Të ardhurat nga paga e b/sh	1,143,830	2,250	19,890
Të ardhura nga interesat ****	24,135		-
Të ardhura nga interesat BTH	-		-
Dhuratë nga vjehri	200,000		-
Të ardhura nga shitja e mejtit	250,000		
<b>Detyrime</b>	<b>- 7,037,383</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Huadhënie 4,300 euro A. Sh 10/2010	- 596,883		
Huamarrje 50,000 euro L. P	-		
Huadhënie 50,000 euro M.L	- 6,940,500		
Kredi **** 500,000 dt. 2.10.2008	500,000		
Huamarrje 2,000 dollarë nga tezja	-		
<b>Shpenzime</b>	<b>10,786,525</b>	<b>180,276</b>	<b>1,333,720</b>
Shpenzime jetike	7,128,122	149,517	940,368
Shpenzime mobilimi	217,380		41,122
Shpenzime udhëtimi	463,160	8,259	172,230
Shpenzime për legalizim	30,047		-
Shpenzime qiraje	696,202	22,500	180,000
Shpenzime këst kredi	783,363	-	
Shpenzime tatimi për interesat BTH	66,151		-
Shpenzime gjyqësore	1,402,100		-
Kthimi I huasë	-		
<b>Pasuri</b>	<b>5,634,531</b>	<b>- 57,249</b>	<b>- 129,201</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	188,618	- 57,249	- 129,201
Pentore sip 115 m2, nr.pas.***, vol.*** fq.***, Përmet	-		
Truall i banesës 300m2, nr.pas *** vol.***, fq ***, Përmet	-		
Arë sip 116 m2, nr.pas ***, vol.***, fq ***, Përmet	-		
Arë sip 3,212 m2, nr.pas ***, vol.***, fq ***Përmet	-		
Arë sip 1,000 m2, nr.pas ***, vol.***, fq ***Tiranë, 50%	-		-
Objekti mbi sip. arë 1000 m2 në proces legalizimi	2,500,000		
Banesë 2KT me sip 185.8m2 për kat, me sip tualli 500 m2, nr.***,	1,605,914		-
Motocikletë me targa ***	300,000		-
Autoveturë Mercedes Benz, v.p 2002 me targa ****	340,000		-
Autoveturë ****	500,000		
Autoveturë Opel Vectra	200,000		-
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-12,347,866</b>	<b>117,772</b>	<b>-57,558</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2022, ka përcjellë pranë Komisionit raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2022, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj, i deklasifikuar pjesërisht (me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.4.2022, të KDZh-së) dhe Grupi i Punës, informon se:

11.1 Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, është përcjellë pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj me konstatimin *për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.*

11.2 Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit në kohështirje gjatë periudhës së rivlerësimit, për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, rezulton se:

- a) gjatë periudhës në të cilën z. Emror Kasaj ushtronte detyrën si prokuror, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive \*\*\*\*\*;
- b) për subjektin Emror Kasaj në cilësinë e prokurorit, ngrihen dyshime se ka ushtruar ndikim të paligjshëm në një proces penal;
- c) institucionet verifikuese kanë informuar PP-në dhe PKR-në \*\*\*\*\*.

11.3 Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj, Grupi i Punës arsyeton të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive dhe në veprimtari të kundërligjshme, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit. Sa më sipër:

i) Situata pasqyron korrupsionin sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë përfshihet në veprime korruptive një prokuror. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “krim i organizuar, trafikim dhe korrupsion”.

ii) Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin tonë të një prokurori, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.

iii) Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyrokastër, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.

iv) Mbështetur në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese merret në konsideratë fakti se është informuar PP dhe PKR.

Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit *nga përshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës në *papërshtatshmëri* në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj.

11.4 Komisioni, pavarësisht nga konkluzioni i mësipërm i DSIK-së, nisur nga informacione të tjera të ardhura nga autoritetet verifikuese, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga informacioni i autoriteteve verifikuese dhe i analizoi ato në kriterin profesional.

Për konstatimet e mësipërme të DSIK-së, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.



## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

11.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se konkluzioni i DSIK-së, i cili ka ndryshuar qëndrimin nga *i përshtatshëm në i papërshtatshëm*, nuk qëndron dhe se përfundimi i arritur më sipër nuk është aspak i bazuar. Që nga marrja e detyrës së OPGJ-së dhe deri më sot kur subjekti ushtron detyrën e prokurorit, deklaroi se e ka kryer detyrën e tij me përgjegjësi të lartë, përkushtim, ndershmëri dhe guxim. Subjekti shpjegoi se ka bindjen se ky raport është ndryshuar për shkak të medias që e ka nxjerrë disa herë në TV (bëhet fjalë për udhëtimin që subjekti bashkë me një gjyqtare të asaj gjykate kanë udhëtuar së bashku duke ndarë shpenzimet e rrugës) dhe nuk mendon se ky është ndikim i paligjshëm dhe, aq më tepër, për rastin konkret, që flet media, ka kërkuar arrest me burg për personin që gjykata ka dhënë “detyrim për paraqitje”.

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

11.6 Bazuar në pikat 4 dhe 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit.

11.7 Nga ana e Komisionit janë kryer hetime të thelluara dhe nuk ka rezultuar që nga organet ligjzbatuese të jenë referuar të dhëna në Prokurorinë e Përgjithshme për përfshirje të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, në veprimtari të paligjshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, për të cilin kjo prokurori do të kishte filluar një hetim ndaj subjektit, gjithashtu, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të jetë i dënuar nga gjykatat shqiptare.

11.8 Gjithashtu, nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave në këtë deklaratë nga ana e subjektit.

11.9 Komisioni, nisur nga informacioni i marrë nga organet ligjzbatuese se subjekti është përfshirë në veprime korruptive, ka kryer hetime në drejtim të një rasti, i cili është pasqyruar dhe analizuar në rubrikën e aftësive profesionale.

11.10 Nga analiza e dokumentacionit në fashikull ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurori që ka hetuar rastin në fjalë, por ka qenë prokuror i autorizuar vetëm për seancën gjyqësore në fjalë, ku ka mbajtur qëndrimin e njëjtë me prokurorin e çështjes. Komisioni ka vlerësuar faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur rol aktiv në hetimin e çështjes, por vetëm atë të përfaqësimit të organit të prokurorisë në gjyq për atë seancë, duke vijuar qëndrimin e prokurorit të çështjes.

11.11 Komisioni, bazuar në hetimin administrativ dhe shpjegimet e subjektit, arriti në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo edhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).

11.12 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar kështu *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj*.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

12. Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional në procesin e rivlerësimit kalimtar, ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019 për subjektin e rivlerësimit Emror Kasaj. Në këtë raport janë evidentuar aftësitë profesionale<sup>63</sup>, organizative<sup>64</sup>, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale<sup>65</sup> dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional<sup>66</sup> i subjektit të rivlerësimit.

12.1 Subjekti i rivlerësimit, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, është vlerësuar për punën e kryer prej tij, aftësitë e tij profesionale dhe etike, “shumë mirë” për vitin 2016.

### C/1. Tri dokumentet e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit

12.2 Në dokumentin “akt për njoftimin e akuzës datë 20.11.2016 për procedimin penal nr.\*\*\*<sup>67</sup>” dhe dokumentin “ankim kundër vendimit penal nr. \*\*\*, datë 11.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë<sup>68</sup> nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika.

12.3 Në dokumentin “kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*<sup>69</sup>” konstatohet se është referuar gabim dispozita ligjore. Nga subjekti është referuar neni 1751 i Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë që dispozita ligjore korrekte është neni 331 i këtij kodi.

12.4 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se kemi të bëjmë me një gabim material pasi Kodi i Procedurës Penale ka 524 nene dhe nuk ekziston neni 1751.

12.5 Komisioni e vlerëson të mjaftueshëm shpjegimin e subjektit me argumentin se kemi të bëjmë me një gabim material të paqëllimshëm me një peshë të papërfillshme në lidhje me rivlerësimin e kriterit profesional.

### C/2. Pesë dosjet e përzgjedhura me short

---

<sup>63</sup>Ku përfshihen:

a) *Njohuritë ligjore*, subjekti paraqet aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

b) *Arsyetimi ligjor* ku subjekti ka aftësi në arsyetim ligjor.

<sup>64</sup>a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* ku rezulton se subjekti është eficient dhe efektiv në drejtim të kohës së hetimit.

b) *Aftësia për të kryer procedurat hetimore* ku konstatohet se subjekti kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë produktive.

c) *Aftësia për të administruar dosjet*. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk paraqiten mungesa në përmbajtjen e akteve.

<sup>65</sup>a) *Etika në punë*. Nga prokurori është përmbushur disiplina dhe angazhimet profesionale, personale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij.

b) *Integriteti*. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me cenimin e integritetit të tij.

c) *Paanësia*. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

<sup>66</sup>a) *Aftësitë e komunikimit*. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit me palët e tjera në proces dhe me gjykatën.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar*. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk dalin të dhëna të plota për mënyrën e bashkëpunimit të subjektit Emror Kasaj që të tregojë për aftësitë e tij për të punuar në grup.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*. Subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

<sup>67</sup>Për personin nën hetim M. L., akuzuar për veprën penale “drejtim mjete në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

<sup>68</sup>Ndaj të pandehurit D. M. datë 19.7.2016.

<sup>69</sup>Në ngarkim të të pandehurit E. I., përpiluar në datën 11.10.2016, për veprën penale “vjedhje me armë” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140-25 të Kodit Penal.

**Dosja 1** – vendimi datë 29.10.2016 “Për mosfillim procedimi penal” për kallëzimin nr. \*\*\* për veprën penale “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal<sup>70</sup>.

12.6 Pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni është konstatuar se:

- a) vendimi i mosfillimit të procedimit penal nuk i është njoftuar kallëzueses M. S. në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale;
- b) vendimi i mosfillimit të procedimit është marrë nga subjekti pas 29 ditësh në një kohë që meqenëse ai nuk ka kryer asnjë veprim tjetër hetimor, ky vendim duhet të ishte marrë menjëherë në përputhje me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

12.7 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se njoftimi i vendimit të pushimit është detyrë administrative e sekretarisë. Në rastin konkret, sekretaria (pasi prokurori ka dorëzuar fashikullin e përfunduar në sekretari) ka ngatërruar emrin e personit të cilin duhet të njoftonte dhe ka njoftuar palën e gabuar.

12.8 Për marrjen e vendimit pas 29 ditësh dhe jo brenda 15 ditëve sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti shpjegon se kjo vendimmarrje është vonuar disa ditë për shkak të ngarkesës në punë. Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit vendimi i mosfillimit të procedimit penal duhet të merret brenda 15 ditëve, është ndryshuar me ligjin nr. 35/2017. Në kohën e vendimmarrjes, afati 15-ditor nuk ka qenë i përcaktuar detyrimisht në ligj dhe prokurorët e merrnin vendimin e tyre brenda një kohe sa më të arsyeshme.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

12.9 Komisioni vëren se pretendimi i subjektit se është detyrë e sekretarisë të njoftojë palët për vendimin e mosfillimit nuk qëndron pasi neni 291 i Kodit të Procedurës Penale në paragrafin e parë pasqyron marrjen e vendimit nga prokurori dhe në paragrafin e dytë njoftimin e palëve. Në këtë nen nuk përcaktohet roli i sekretarisë në lidhje me njoftimin e vendimit.

12.10 Komisioni, në barrën e provës dërguar subjektit nuk ka përcaktuar afat 15-ditor për marrjen e vendimit të mosfillimit. Sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit në një kohë që nuk kishte kryer asnjë veprim tjetër hetimor nga momenti i referimit të çështjes nga Komisariati i Policisë Gjyrokastër, duhet të kishte marrë menjëherë vendimin e mosfillimit dhe jo pas 29 ditësh.

---

<sup>70</sup>Ka rezultuar se në datën 28.9.2016 ka bërë kallëzim në Komisaratin e Policisë Gjyrokastër shtetasja M. S. me profesion arsimtare pasi i është vjedhur portofoli. Nga punonjësi i policisë është zbuluar se portofoli i është marrë nga një nxënëse e klasës M. T., ku ajo jepte mësim. Pas disa ditësh, në klasën ku M. S. jepte mësim ka shkuar gjyshja e nxënëses, shtetasja M. M., dhe i ka thënë se për shkak të presionit që mësuesja ushtronte mbi mbesën e saj (për shkak të vjedhjes së portofolit) ajo ndihej e frikësuar dhe nuk donte të shkonte në shkollë. Gjyshja M. M. e nxënëses i ka thënë kallëzueses “*po u more me mbesën time ke punë me mua*”, kjo lloj shprehje është konsideruar nga kallëzuesja e cila ka paraqitur kallëzim për këtë fakt. Janë bërë veprimet e para procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore duke u pyetur e kallëzuara dhe kallëzuesja. Materialet procedurale janë përcjellë nga Komisarati i Policisë Gjyrokastër në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër në datën 30.9.2016. Pas marrjes së materialeve procedurale, nga subjekti Emror Kasaj nuk është bërë asnjë veprim tjetër hetimor dhe në datën 29.10.2016 nga subjekti është marrë vendimi i mosfillimit, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Vendimi i mosfillimit të procedimit i është njoftuar të kallëzuarës M. M., por nuk rezulton që t’i jetë njoftuar kallëzueses M. S., në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

12.11 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale.

**Dosja nr. 2** – vendim pushimi datë 4.5.2016 i procedimit penal nr. \*\*\* për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal<sup>71</sup>.

12.12 Pas analizimit të dokumentacionit të fashikullit penal nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisioni është konstatuar se:

a) Urdhri për regjistrimin e procedimit penal nga subjekti për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe “prodhim dhe mbajtje e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278 dhe 283 të Kodit Penal, nuk është i mbështetur në provat e administruara në fashikullin e ardhur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Vepra penale për të cilën duhet të kryheshin hetime ishte “trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal siç është arsyetuar edhe nga subjekti në vendimin e pezullimit të datës 30.1.2016.

b) Në vendimin e pushimit të procedimit penal datë 4.5.2016 nuk është disponuar në lidhje me provën materiale automjet fuoristradë tip “\*\*\*\*”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 190/1 të Kodit Penal.

c) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2016, “Në lidhje me disponimin e provës materiale” është jo procedurale dhe nuk përlligj qëndrimin e prokurorit për mosdisponimin në lidhje me provën materiale në vendimin e pushimit.

d) Nuk rezulton që vendimi i pushimit të procedimit penal datë 4.5.2016 t’u jetë njoftuar personave të interesuar sipas disponimit nga subjekti në pikën 2 të vendimit.

e) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2016 është e firmosur nga prokurori Emror Kasaj duke nënshkruar për Drejtuesin e Prokurorisë A. P. pa pasur një autorizim nga ky i fundit.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

12.13 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se ka urdhëruar regjistrimin e saktë të figurës së veprës penale në momentin e marrjes në dorëzim të materialit hetimor nga Prokuroria e Krimeve të Rënda (në

---

<sup>71</sup>Në datën 9.9.2013, në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (në vijim PSHKPKR) janë depozituar aktet hetimore të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit lidhur me ekzistencën e një organizate kriminale në drejtim të kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike me qëndër në fshatin \*\*\*. Mbi këtë bazë, në datën 11.9.2013 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprat penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal dhe “organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, parashikuar nga neni 284/a i Kodit Penal. Në datën 28.10.2015 është bërë ndarja e procedimit penal nr.\*\*\*, në procedimin penal nr. \*\*\*, i vitit 2015 dhe dërgimi për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjykoastër. Në datën 18.11.2015 nga subjekti Emror Kasaj është bërë regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal dhe veprës “prodhim dhe mbajtje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, pa autorë. Në datën 30.1.2016 nga subjekti është marrë vendimi për pezullimin e hetimeve për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal pa autorë. Ndërsa në datën 27.4.2016, nga subjekti është marrë vendimi për rifillimin e procedimit penal pasi erdhi informacioni nga INTERPOL-i me argumentin se procedimi duhet të rifillojë që të pushohet. Në datën 4.5.2016 nga subjekti Emror Kasaj është marrë vendimi i pushimit të procedimit penal se nuk ndodhemi përpara elementëve të figurës së veprës penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal pasi automjeti nuk rezulton të jetë i trafikuar dhe nuk rezulton që të jetë paraqitur kallëzim për vjedhje. Pushohet procedimi penal pasi fakti nuk ekziston.

vijim PKR), por për shkak të një gabimi material në përpilimin e aktit në kompjuter nuk ka shënuar dispozitën e saktë në pjesën urdhëruese të urdhrit të regjistrimit të procedimit penal, por e ka lënë atë sipas formularit model. Nga dosja që u dërgua për kompetencë nga PKR-ja në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nga hetimi rezultoi se bëhet fjalë për veprën penale “trafikim të mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal për të cilën janë kryer hetime. Subjekti ka depozituar kopje të regjistrimit të veprave penale ku rezultoi procedimi nr. \*\*\*, i PKR-së, prokurori Emror Kasaj, lloji i veprës “trafikim i mjeteve motorike”.

12.14 Për mosdisponimin në vendim të provës materiale dhe për shkresën administrative për disponim të provës materiale, subjekti ka shpjeguar se sendi “automjeti” nuk gëzon cilësitë e provës materiale dhe, për këtë shkak, disponimi në lidhje me këtë send është bërë në rrugë administrative. Organi i akuzës nuk ishte në kushtet ku mund të dispononte me vendim kthimi, konfiskimi apo asgjësimi i provës materiale.

12.15 Për mosnjohimin e vendimit, subjekti ka shpjeguar se çështja është regjistruar pa autorë dhe nuk është identifikuar ndonjë person si viktimë apo autor i veprës penale të cilëve duhet t’u ishte njoftuar kjo vendimmarrje.

12.16 Për aktet, kompetencë e drejtuesit, por të nënshkruar prej tij, subjekti ka shpjeguar se kjo ishte praktika që ka gjetur në këtë Prokurori e autorizuar nga Prokurori i Rrethit, praktikë e cila vazhdon ende.

12.16.1 Subjekti ka depozituar një autorizim me datë 2.2.2015 pa numër protokolli dhe vulë me emrin e Drejtuesit të Prokurorisë A. P., i cili autorizon prokurorët që përveç shkresave drejtuar të tretëve që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me procedimet ose kallëzimet penale, të firmosin vetë shkresat përcjellëse të çështjeve që kanë në hetim në emër të prokurorit të rrethit.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

12.17 Subjekti i rivlerësimit kishte të gjithë informacionin e duhur nga dokumentacioni i referuar nga PKR-ja për regjistrimin e saktë të veprës penale në urdhrin e regjistrimit të veprave. Po kështu dhe vetë fleta e regjistrimit të veprave penale e depozituar nga subjekti në prapësime, pasqyrojnë saktë veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”.

12.18 Subjekti i rivlerësimit në vendimin e pushimit duhet të kishte disponuar në lidhje me provën materiale “automjeti” meqenëse ai ishte një send, që u gjet afër vendngjarjes, për të cilin u kryen hetime dhe që merr vlerën e provës materiale. Shkresa administrative për kthimin e këtij automjeti në Drejtorinë Vendore të Policisë është bërë nga subjekti me qëllim për të përligjur vendimin e pushimit ku ai duhet kishte disponuar për provën materiale. Subjekti i rivlerësimit, në shkresën drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë, e ka emërtuar shkresën “në lidhje me disponimin e provës materiale”, pra duke e konsideruar automjetin si provë materiale. Nga subjekti i rivlerësimit nuk janë respektuar kërkesat e nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale.

12.19 Në lidhje me shpjegimin se vendimi i pushimit nuk iu njoftua palëve për shkak se vepra penale ishte pa autor, Komisioni vlerëson se ky shpjegim nuk qëndron pasi subjekti duhej t’ia kishte njoftuar këtë vendim Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë, e cila kishte referuar

materialet procedurale të kësaj çështjeje në Prokurori sipas përcaktimit në pikën 2 të vendimit të pushimit të subjektit.

12.20 Në lidhje me praktikën e gjetur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila nuk është e rregullt nga ana ligjore, autorizimi i lëshuar nga titullari nuk është i rregullt nga pikëpamja formale pasi nuk ka numër protokollit dhe vulë. Në bazë të këtij autorizimi shkresat e drejtuara subjekteve të tretë nën emrin e drejtuesit duhet të ishte emri i personit të autorizuar dhe jo emri i drejtuesit dhe firma e prokurorit.

12.21 Subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me pikën 5.1 të urdhrin nr. \*\*\*, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktimin e shkallës së hierarkisë në prokurori”<sup>72</sup> (kjo procedurë është ndjekur edhe për raste të tjera nga subjekti).

**Dosja 3 – vendim datë 17.5.2016** “Për pushimin e hetimeve” të procedimit penal nr. \*\*\*, regjistruar për veprën penale “vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal<sup>73</sup>.

12.22 Pas analizimit të dokumentacionit të fashikullit penal nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni është konstatuar se:

- a) Urdhri për regjistrimin e procedimit penal mban datën 16.3.2015, ku viti 2015 është vendosur gabim pasi i përket vitit 2016.
- b) Vendimi i pushimit të hetimeve i datës 17.5.2016 u është njoftuar palëve të interesuara, OSHEE-së dhe personit nën hetim A. Gj., datë 6.9.2016, pas 3 muajsh e 19 ditësh në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale që përcakton afatin 5-ditor të njoftimit nga shpallja e tij.
- c) Në aktet procedurale, subjekti i rivlerësimit nuk e citon të plotë dispozitën që parashikon neni 137 i Kodit Penal që është “vjedhja e energjisë elektrike ose e impulsive telefonike”, por citon “vjedhja e energjisë elektrike”.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

---

<sup>72</sup>5.1 Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë dhe të prokurorive të apelit janë personat përgjegjës që komunikojnë zyrtarisht dhe përgjigjen për marrëdhëniet e prokurorisë që drejtojnë me prokuroritë e tjera ose me institucionet vendore në juridiksionin e tyre.

<sup>73</sup>Në Komisarriatin e Policisë Gjirokastrë është referuar materiali kallëzues, pasi nga kontrolli i Njësisë Operacionale të OSHEE-së në kompleksin “\*\*\*\*” në \*\*\* në pronësi të shtetasit A. Gj. është konstatuar ndërhyrje në aparatit matës të energjisë elektrike, ku është evidentuar një vrimë në anën e sipërme të matësit. Janë kryer veprimet e para hetimore, mbajtja e procesverbalit të sekustrimit, verifikimi i matësit dhe është bërë shpallja në kërkim e shtetasit A. Gj. Në datën 16.3.2016 janë dërguar materialet procedurale për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal. Në datën 16.3.2015 (viti është gabim, duhet 2016) subjekti Emror Kasaj ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike” (dispozita nuk është cituar e plotë pasi është vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike), parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit A. Gj. Subjekti, në datën 30.3.2016, ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore nga OPGJ-ja deri më 15.4.2016. Janë kryer veprimet hetimore nga OPGJ-ja, si dhe është kryer dhe një akteksperimenti, i cili ka konkluduar se edhe pse ka një ndërhyrje (një vrimë në trupin e matësit) nuk ka pasur ndërhyrje në matje dhe matësi është i rregullt dhe i mbrojtur me vulat përkatëse të pacenuara. Subjekti i rivlerësimit, në datën 17.5.2016, ka vendosur pushimin e hetimeve pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

12.23 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se për ngatërresën e vitit 2015 nga 2016 që duhej të ishte, ka shpjeguar se viti i regjistrimit duhet të ishte 2016 dhe është gabim material.

12.23.1 Për vendimin e pushimit i cili u është njoftuar palëve pas 3 muajsh, subjekti shpjegon se njoftimi i vendimit është detyrim i sekretarisë.

12.23.2 Në lidhje me citimin jo të plotë të dispozitës ligjore të parashikuar në nenin 137 të Kodit Penal, subjekti e ka konsideruar gabim material.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

12.24 Në lidhje me njoftimin me vonesë të vendimit të pushimit, pretendimi i subjektit se është detyrë e sekretarisë që të njoftojë palët për vendimin e mosfillimit nuk qëndron pasi neni 291 i Kodit të Procedurës Penale në paragrafin e parë pasqyron marrjen e vendimit nga prokurori dhe në paragrafin e dytë njoftimin e palëve, ndërkohë që nuk përcaktohet roli i sekretarisë për njoftimin.

12.24.1. Në lidhje me moscitimin e plotë të dispozitës ligjore të parashikuar në nenin 137 të Kodit Penal, Komisioni i konsideron të mjaftueshme shpjegimet e subjektit.

**Dosja 4 – kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\* për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonikë”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal<sup>74</sup>.**

12.25 Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni, u konstatua se:

- i. Urdhri për regjistrimin e procedimit penal mban datën 11.3.2015, ku viti 2015 është vendosur gabim pasi i përket vitit 2016.
- ii. Në të gjitha aktet procedurale në lidhje me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit nuk e citon të plotë dispozitën që parashikon neni 137 i Kodit Penal që është “vjedhje e energjisë elektrike ose e impulsive telefonike”, por citon “vjedhje e energjisë elektrike”.

---

<sup>74</sup>Në Komisarjatin e Policisë Gjyrokastër është referuar materiali kallëzues pasi nga kontrolli i Njësisë Operacionale të OSHEE-së është ushtruar kontroll në biznesin bar-kafe të shtetasit A. K. dhe është konstatuar se vulat e boksit dhe plumbëja ishin cenuar. Është bërë kontrolli i saktësisë në matje dhe ka rezultuar diferencë në matje. Është bërë shpallja në kërkim të shtetasit A. K. dhe më pas ndalimi i tij. Komisarjati i Policisë Gjyrokastër, në datën 10.3.2016, ka përcjellë materialet procedurale te Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër. Në datën 16.3.2016 subjekti ka bërë kërkesë për vlerësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Gjykata, me vendimin e datës 16.3.2016, ka miratuar kërkesën e prokurorisë. Në datën 25.3.2016, subjekti i ka njoftuar akuzën të pandehurit A. K. për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/2. Në datën 25.3.2016, subjekti ka lëshuar urdher për kryerje të veprimeve hetimore nga OPGJ-ja deri më 30.4.2016 (t’i njoftohet akuza, të merren dëshmitë e penaltetit, të administrohet tabela fotografike, të kryhen veprime të tjera dhe të njoftohet prokurori). Subjekti, në datën 11.3.2015 (viti 2015 është shënuar gabim, duhet viti 2016) ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit A. K. Në datën 11.6.2016 subjekti ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal deri në datën 11.9.2016. Në datën 6.7.2016 subjekti ka dërguar çështjen për gjykim për të pandehurin A. K. për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonikë”. Subjekti, në diskutimet përfundimtare të datës 2.11.2016, përpara gjykatës ka kërkuar “deklarimin fajtor të të pandehurit A. K. për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burg. Bazuar në nenin 63 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin e të pandehurit të kryejë një punë në interes publik pa shpërblim për një afat 200 orë.

- iii. Vendimi i datës 11.6.2016 “për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit” i marrë nga subjekti me arsyen se duhet të kryhen veprime hetimore të tjera të domosdoshme<sup>75</sup> vjen në kundërshtim me:
  - aktin e njoftimit të akuzës datë 25.3.2016, ku citohet se ka prova që krijojnë bazë ligjore me të dhëna të mjaftueshme se A. K. ka kryer veprën penale “vjedhje”;
  - urdhrin e datës 25.3.2016 për kryerjen e veprimeve hetimore ku ngarkohet opgj për kryerjen e veprimeve gjatë hetimit.
- iv. Vendimi i datës 11.6.2016 për zgjatjen e afatit të hetimeve, nuk rezulton t’u jetë njoftuar palëve sipas përcaktimeve të nenit 324/3 të Kodit të Procedurës Penale.
- v. Vendimi i datës 11.3.2016 për vleftësimin e sekuestros nuk rezulton t’u jetë njoftuar palëve sipas përcaktimeve të nenit 301 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

12.26 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se shënimi i vitit 2015 në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal, në vend të vitit 2016 është një gabim material.

12.26.1. Për dispozitën ligjore që parashikon neni 137 i Kodit të Procedurës Penale, që nuk është cituar e plotë, subjekti shpjegon se është gabim material.

12.26.2. Në lidhje me vendimin e datës 11.6.2016 për zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti shpjegon se njoftimi i akuzës nuk presupozon përfundimin e hetimeve pasi mund të jetë e nevojshme, si në rastin konkret, për të kryer detyra shtesë në përfundim të të cilave situata juridike mund të ndryshojë. Akuza mund të njoftohet edhe në një kohë më të hershme se përfundimi i hetimeve mjafton të ekzistojnë prova të mjaftueshme që krijojnë bindjen për provueshmërinë e saj.

12.26.3 Në lidhje me mosnjoftimin e vendimit palëve për zgjatje të afateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se ky akt rezulton i nënshkruar nga i pandehuri.

12.26.4 Për mosnjoftimin e vendimit të vlerësimit të sekuestros palëve, subjekti ka shpjeguar se ky vendim nuk është bërë pasi personi i dyshuar ishte shpallur në kërkim policor dhe ishte e pamundur gjetja dhe njoftimi i tij. Shtetasit i është njoftuar akti dhe e gjithë dosja në momentin kur është ndaluar dhe i është caktuar masa e sigurimit.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

12.27 Zgjatja e afateve të hetimit nga subjekti nuk ka qenë e nevojshme për sa kohë që në dosjen e referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë ka pasur veprime hetimore të kryera nga OPGJ-ja, ku kishte prova të mjaftueshme për dërgimin në gjyq të të pandehurit. Po kështu, veprimet hetimore të urdhëruara nga subjekti duhet të ishin kryer nga OPGJ-ja që me urdhrin e datës 25.3.2016.

12.27.1. Vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve është nënshkruar nga i pandehuri A. K., çka nënkupton se ai ka marrë dijenë, por ky akt nuk i është njoftuar të dëmtuarit OSHEE ashtu siç përcakton dhe paragrafi i tretë i nenit 324, ku citohet se “vendimi për zgjatjen e afatit të njoftimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”.

---

<sup>75</sup>Marrja e dokumentit të kontrollit të OSHEE-së dhe librezat e pagesave të abonentit e njehsuar me origjinalin.



12.27.2. Komisioni vëren se vendimi i vleftësimit të sekuestros duhej t'i ishte njoftuar personit nën hetim në përputhje me përcaktimet e nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale<sup>76</sup>.

**Komisioni konstaton se mangësitë procedurale të lartpërmendura, nuk konsiderohen deri në atë masë sa që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, në lidhje me kriterin profesional.**

**Dosja 5 – procedimi penal nr. \*\*\*** për veprat penale “kalimi i paligjshëm i kufirit” dhe “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga nenet 297 dhe 89 të Kodit Penal, dërguar për gjykim me vendimin datë 25.7.2016<sup>77</sup>.

12.28 Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisionit u konstatua se:

- i. Subjekti, me cilësinë e prokurorit të çështjes, ka hequr dorë nga akuza në gjykim, pa paraqitur akt të shkruar prej tij, gjë që vjen në kundërshtim me urdhrin nr.\*\*\*, datë 5.9.2003, “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”.
- ii. Në lidhje me personin nën hetim, shtetasin nigerian O. S., është vepruar në kundërshtim me ligjin për emigrantët e luftës. Nga subjekti nuk është marrë në konsideratë ligji nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”<sup>78</sup>.
- iii. Vendimi i datës 20.4.2016 për vleftësimin e sekuestros nuk rezulton t'u jetë njoftuar palëve sipas përcaktimeve të nenit 301 të Kodit të Procedurës Penale.

---

<sup>76</sup>Neni 140 “Njoftimi i të pandehurit të lirë” 1. Njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke ia dorëzuar atij kopjen e aktit. Kur nuk mund t'i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të.

<sup>77</sup> Nga materiali kallëzues i referuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër është referuar se është kapur shtetasi nigerian O. S. Është konstatuar se ai ka pasur një dëmtim me armë zjarri në këmbën e djathtë dhe, për këtë arsye, është dërguar në Spitalin Rajonal Gjirokastër. I pyetur për rrethanat e plagosjes së tij, shtetasi nigerian O. S. ka deklaruar se prej shumë vitesh jeton në Greqi. Ndër të tjera, ka deklaruar se ka shkruar afër kufirit greko-shqiptar në zonën e Janinës dhe ka humbur në pyll. Gjatë lëvizjes së tij, është thirrur nga persona me automjet që kishte mbishkrimin “Police” dhe i është thirrur të ndalojë, por ai nuk ka ndalur. Këta persona e kanë qëlluar me armë zjarri dhe e kanë plagosur në këmbë. Ky shtetas, më pas, është larguar në pyll dhe ka kaluar kufirin greko-shqiptar dhe ka ecur deri sa është kapur nga policia. U bë këqyrja e mjeteve të policisë dhe rezultuan me mbishkrimin “Policia”. U kontrollua vendi dhe rruga e përshkruar nga shtetasi nigerian deri në momentin e ndalimit nga policia dhe nuk u konstatuan njolla gjaku. Po kështu, u verifikua se nga punonjësit e policisë që patrollojnë zonën nuk kanë dëgjuar dhe as nuk kanë përdorur armët e zjarrit nga momenti që kanë marrë shërbimin dhe deri kur e kanë dorëzuar atë. Kur ky shtetas është ndaluar nga policia, ky e kishte plagën e armës së zjarrit. Në datën 19.4.2016 i kalohen materialet Prokurorisë së Rrethit Gjirokastër për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”. Po në datën 19.4.2016, nga subjekti është regjistruar procedimi penal për veprën penale “kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit O. S. Në datën 20.4.2016, nga subjekti është marrë vendimi për caktimin e mbrojtësit kryesisht av. J. K. Në datën 10.5.2016, subjekti ka njoftuar aktakuzën duke marrë si të pandehur shtetasin O. S. për veprën penale “kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal. Nga subjekti, më 25.7.2016, është përpiluar kërkesa për gjykimin e procedimit penal drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjirokastër për veprën penale “kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit O. S. + vendim për dërgimin e çështjes në gjyq. Në datën 24.11.2016, gjatë seancës gjyqësore, subjekti ka kërkuar tërheqjen e akuzës dhe kalimin e akteve prokurorit. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\* , ka vendosur pushimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit O. S.

<sup>78</sup>Në vështrim të këtij ligji për personin e hetuar në situatën që kanë zhvilluar hetime në ngarkim të tij duhej të vepronte ky ligj duke bërë që ky shtetas të trajtohej në institucione të përkujdesjes shoqërore në mbështetje të neneve 59 dhe 60 të këtij ligji, ku në nenin 59 citohet: “1. Refugjati që përmbush kriteret e legjislacionit në fushën e përkujdesjes shoqërore mund të vendoset në institucionet publike të përkujdesjes. Dokumentacioni i pranimit në këto institucione miratohet nga Komisioni Qendror pranë Shërbimit Social Shtetëror me propozimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në bazë të të dhënave të mbajtura në regjistra të posaçëm. 2. Ministri përgjegjës mund të lidhë kontrata me institucione jopublike të përkujdesjes shoqërore për trajtimin e refugjatëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Neni 60: E drejta për strehim-Refugjati në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë të gëzojë mundësitë ligjore për përfitimin e strehimit si shtetasi shqiptar”.

- iv. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka njoftuar aktakuzën e datës 10.5.2016 të pandehurit O. S. apo mbrojtësit të tij në kundërshtim me pikën 1, të nenit 34<sup>79</sup>, të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

12.29 Subjekti në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se heqja dorë nga akuza është atribut i prokurorit kur konstaton se nuk është përpara ekzistencës së elementëve të figurës penale. Urdhri nr. \*\*\* i vitit 2003 për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore prej shumë vitesh nuk ka gjetur zbatim në praktikën gjyqësore.

12.29.1 Në lidhje me konstatimin se ndaj shtetasit nën hetim O. S. është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” subjekti ka shpjeguar se sipas këtij ligji, shtetasi O. S. nuk ishte përfitues i azilit. Për këtë arsye edhe është deportuar përsëri nga autoritetet vendore të Kufirit Gjirokastër pas katër ditësh, në Greqi prej edhe nga kishte hyrë ilegalisht. Po kështu, sipas ligjit, vendi prej nga kishte hyrë (Greqia) konsiderohet “vend i sigurt” dhe kalimi i paligjshëm i kufirit prej këtij vendi nuk është i lejueshëm sipas procedurave ligjore të ligjit “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

12.29.2. Për mosnjoftimin e vendimit për vleftësim sekuestro dhe njoftimit të aktakuzës palëve, subjekti ka shpjeguar se këto akte i janë njoftuar avokatit të caktuar kryesisht (i pandehuri vetë ishte deportuar në Greqi). Ky i fundit (mbrojtësi), gabimisht, duhet të ketë marrë kopjet e firmosura të këtyre akteve dhe ka lënë kopjet e tij. Ky fakt nuk është vënë re nga OPGJ-ja që ka bërë njohjen me aktet po kështu dhe nga subjekti.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

12.30 Komisioni vëren se në lidhje me konstatimet mbi heqjen dorë nga akuza pa një akt të shkruar, si dhe mosaplikimin e ligjit për azilin, subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse.

12.31 Në lidhje me mosnjoftimin e vendimit të vleftësimit të sekuestros dhe njoftimit të aktakuzës të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, subjekti nuk ka dhënë shpjegime të sakta. Nga dokumentacioni në fashikullin penal nuk rezulton që këto dy akte, si dhe deklarimi i subjektit se nga ana e mbrojtësit janë marrë gabimisht kopjet e akteve me firmë duke lënë kopjet e tij pa firmë mbeten në kuadër deklarativ dhe nuk rezultojnë t’u jenë njoftuar palëve në kuptim të neneve 301 (për vleftësimin e sekuestros) dhe 34 (njoftimi i aktakuzës) të Kodit të Procedurës Penale.

## **D. ANKESAT/MASAT DISIPLINORE DHE KALLËZIMET**

**13** Prokuroria e Përgjithshme<sup>80</sup> ka përcjellë informacionin përkatës për subjektin.

<sup>79</sup>Neni 34 “Marrja e cilësisë së të pandehurit” 1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

<sup>80</sup>Prokuroria e Përgjithshme nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2020.

13.1 Drejtoria e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativ<sup>81</sup> konfirmojnë se nuk ka ardhur asnjë informacion apo *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për implikim të subjektit në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës së tij.

13.2 Në Regjistrat e Ankesave në Sektorin e Protokoll-Arkivit<sup>82</sup> nga verifikimi për vitet 2006 – 2018 rezultojnë vetëm dy ankesa, ndërsa nga Drejtoria e Koordinimit Institucional<sup>83</sup> referohet një ankesë<sup>84</sup>, të cilat janë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>85</sup>.

13.3 Nga arkivi i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme<sup>86</sup> nuk rezultojnë që subjekti Emror Kasaj të ketë masa disiplinore gjatë punës së tij.

13.4 Nga përgjigjet e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore<sup>87</sup> nuk rezultojnë të ketë pasur ndaj subjektit procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara.

13.5 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>88</sup> konfirmon se për subjektin Emror Kasaj janë regjistruar 4 kallëzime penale<sup>89</sup> gjatë periudhës kur ka qenë me detyrën e oficerit të policisë gjyqësore pranë kësaj prokurorie për të cilat është vendosur mosfillimi i tyre.

13.6 Nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë (në vijim PPKKKO)<sup>90</sup> rezultojnë se janë depozituar dy kallëzime penale ndaj subjektit, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal<sup>91</sup>.

---

<sup>81</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2018, e ndodhur në dosjen profesionale dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020, drejtuar Komisionit.

<sup>82</sup>Shkresa e Sektorit të Protokollit dhe Arkivit pranë Prokurorisë pa datë dhe pa numër protokollit.

<sup>83</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020.

<sup>84</sup>Ankesa nr. \*\*\*\*, viti 2018, e shtetasit S. N. Nga Prokuroria e Përgjithshme, ankesa e S. N. është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nuk ka informacion se çfarë ka ndodhur me këtë ankesë. Shtetasi S. N. ka depozituar edhe një denoncim pranë Komisionit, i cili është trajtuar në rubrikën e denoncimeve.

<sup>85</sup>a) Ankesa nr. \*\*\*, e vitit 2016 e vëllezërve A. të cilët pretendojnë se në kohën kur subjekti ka qenë me detyrë Opgj u ka përvetësuar pasurinë e tyre me anë të mashtrimit. Prokuroria e Përgjithshme, pas shqyrtimit të kësaj ankesë ka njoftuar vëllezërit A. se marrëdhëniet e tyre me subjektin Emror Kasaj janë krijuar në bazë të një kontrate civile dhe konflikti zgjidhet gjyqësisht nëpër gjykata. Kjo marrëdhënie nuk bie ndesh me ushtrimin e detyrave të prokurorit; b) Ankesa nr. \*\*\* e vitit 2016 e shtetasit P.Ç i cili ankimon vendimin e mosfillimit të procedimit penal të marrë nga subjekti Emror Kasaj për një kallëzim të bërë prej tij dhe kërkon shfuqizimin e tij nga Prokuroria e Përgjithshme. Nga kjo e fundit është njoftuar ankuesi se vendimi i mosfillimit, mund të ankimohet në Gjykatë.

<sup>86</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot, datë 28.9.2018 e Prokurorisë së Përgjithshme

<sup>87</sup>Prokuroria e Rrethit Kukës nr. \*\*\* prot, datë 20.2.2020; Lezhë me nr. \*\*\* prot, datë 17.2.2020; Dibër nr. \*\*\* prot, datë 17.2.2020; Kavajë nr. \*\*\* prot, datë 11.2.2020; Korçë me nr. \*\*\* prot, datë 25.2.2020; Vlorë me nr. \*\*\* prot, datë 12.2.2020; Pogradec me nr. \*\*\* prot, datë 21.2.2020; Sarandë nr. \*\*\* prot, datë 20.2.2020; Shkodër nr. \*\*\* prot, datë 4.3.2020; Tropojë nr. \*\*\* prot, datë 11.2.2020; Përmet nr. \*\*\* prot, datë 11.2.2020; Mat nr. \*\*\* prot, datë 18.2.2020; Gjyrokastër nr. \*\*\* prot, datë 18.2.2020; Lushnje nr. \*\*\* prot, datë 13.2.2020; Pukë nr. \*\*\* prot, 14.2.2020; Fier nr. \*\*\* prot, datë 12.2.2020; Berat nr. \*\*\* prot, datë 11.2.2020; Elbasan nr. \*\*\* prot, datë 25.2.2020; Krutë nr. \*\*\* prot, datë 20.2.2020; Kurbin nr. \*\*\* prot, datë 11.2.2020; Durrës nr. \*\*\* prot, datë 2.2.2020;

<sup>88</sup>Prokuroria e Rrethit Tiranë me nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2018, shkresë e ndodhur në dosjen e vlerësimit profesional dhe nr. \*\*\* prot., datë 19.6.2020, dërguar Komisionit.

<sup>89</sup>Kallëzimi penal nr. \*\*\* i shtetasit T. Sh. ndaj shtetasit Emror Kasaj me pretendimin se është goditur nga ky i fundit; kallëzim penal nr. \*\*\* i vëllezërve A. me pretendimin se subjekti ka shpërdoruar detyrën; kallëzim penal nr. \*\*\*, i cili nga verifikimi rezultojnë se shtetasi D. A. ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit A. Sh. dhe jo ndaj subjektit Emror Kasaj. Emri i subjektit përmendet në kallëzim si shok i të kallëzuarit A. Sh.; kallëzim penal nr. \*\*\* i shtetasit D. A. ndaj subjektit Emror Kasaj për veprën penale “mashtrim” etj.; kallëzim penal nr. \*\*\* i shtetasit H.A. etj., kundër Emror Kasaj dhe M. L., si dhe kallëzimin e këtyre dy të fundit ndaj shtetasit H.A. për veprën penale “mashtrim”.

<sup>90</sup>Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2020, e PPKKKO-së, dërguar në Komision.

<sup>91</sup>a) Kallëzimi penal nr. \*\*\* i shtetasit S. Q., i dënuar me 25 vjet për veprat penale “vrasje me paramendim” dhe “vrasje me dashje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës”, i cili pretendon se nuk janë bërë hetime të plota nga subjekti Emror Kasaj, i cili ka vijuar me një vendim mosfillimi për një kallëzim të bërë prej shtetasit S. Q. për hetimin e çështjes kur ai është dënuar me vendimin e datës 14.12.2000 kur ka kryer veprën penale. Në përfundim të hetimit është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga PPKKKO-ja; b) kallëzim penal nr. \*\*\* i shtetasit V. Ç., i bërë ndaj subjektit Emror Kasaj për veprën penale “veprime

## DENONCIME/ANKESA NGA PUBLIKU

**14** Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 11 denoncime/ankesa nga publiku.

**14.1 Gjashtë denoncime të familjes A.** (nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017; nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2018; nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2019; nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2019), ku pretendojnë se subjekti Emror Kasaj, me anë të mashtrimit, bashkë me një person tjetër u kanë rrëmbyer pronën.

14.1.1 Komisioni vëren se pas analizimit të denoncimeve të bëra nga familja A. pretendimet e tyre i referohen veprimeve të subjektit që nuk kanë lidhje me kriterin profesional, por ato i referohen një konflikti civil të hershëm ndërmjet subjektit dhe familjes A., i cili është pjesë e hetimit administrativ në lidhje me kriterin pasuror.

**14.2 Dy denoncime të shtetasit M. L.** (nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2021), i cili akuzon subjektin Emror Kasaj për korrupsion për grabitje pronash.

14.2.1 Komisioni vëren se pas analizës së këtyre denoncimeve pretendimet e denoncuesit lidhen me një çështje huaje, që është pjesë e materialit hetimor të Komisionit për kriterin pasuror.

**14.3 Denoncim i shtetasit R. K.**<sup>92</sup>, i cili pretendon se subjekti ka pushuar hetimin për kallëzimin e bërë prej tij, pa marrë parasysh dokumentacionin objekt kallëzimi, për arsye përfitimi ndërkohë që ankohet edhe ndaj subjektit R. L., gjyqtar që ka gjykuar çështjen e tij në Gjykatën Administrative.

14.3.1 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë<sup>93</sup> fashikullin penal të kallëzimit nr. \*\*\*. Nga dokumentacioni në fashikull rezulton se shtetasi R. K. ka bërë kallëzim për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, pasi pretendon se nga punonjësit e ZVRPP-së Tepelenë është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie në favor të shtetasit I. K., në kundërshtim me ligjin.

14.3.2 Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore për këtë çështje dhe, në përfundim, në datën 18.5.2016 ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal.

14.3.3 Komisioni, pas analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, vëren se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë pasi kanë të bëjnë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 73 të ligjit nr. 96/2016<sup>94</sup>. Nuk konstatohen *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.

**14.4 Denoncim i shtetasit S. N.**<sup>95</sup>, i cili pretendon se me veprimet dhe mosveprimet e tij subjekti ka shkelur ligjin duke treguar njëanshmëri<sup>96</sup>.

---

korruptive të funksionarëve të drejtësisë”, pasi prej tij nuk janë kryer veprime hetimore të plota për një kallëzim të bërë prej tij që subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

<sup>92</sup>Nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2017.

<sup>93</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.4. 2020, e Prokurorisë Gjrokastrë.

<sup>94</sup>Neni 73, aftësitë profesionale të prokurorit. 4. Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

<sup>95</sup>Nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2019.

<sup>96</sup>(a) në momentin e parë nuk ka bërë shoqërimin dhe kërkimin e masës së arrestit me burg për shtetasin E. Gj. duke e lënë të lirë edhe pse akt ekspertimi i parë nga eksperti S. K. e ka nxjerrë fajtor me pasojë vdekjen e djalit të tij K. N.; (b) prokurori nuk i ka dhënë kopje të dokumenteve të dosjes penale, si dhe nuk ka vënë në dijeni për çdo moment procedural avokatët e tij; (c)

14.4.1 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër<sup>97</sup> fashikullin e procedimit penal nr.\*\*\*, që i referohet aksidentit automobilistik, ku si pasojë e përplasjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, i drejtuar nga shtetasi E. Gj., me mjetin zetar me drejtues shtetasin S. N., ka humbur jetën djali i këtij të fundit, shtetasi K. N., si dhe kanë pasur dëmtime shëndetësore shtetasit S. N., bashkëshortja e tij H. N. dhe shtetasja M. Gj.

14.4.2 Subjekti, në datën 27.3.2018, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, pa autorë.

14.4.3 Në datën 23.3.2018 është marrë vendim për kryerjen e një aktekspertimi autoteknik për të përcaktuar shkaktarin e aksidentit. Aktekspertimi i datës 22.4.2018, i kryer nga një ekspert, ka përcaktuar se drejtuesi i automjetit tip “\*\*\*\*”, E. Gj., me veprime të gabuara ka shkelur nenet 144/1 dhe 139/2/2 të Kodit Rrugor.

14.4.4 Në datën 8.5.2018, nga subjekti Emror Kasaj është bërë këqyrja e pamjeve filmike të një subjekti privat aty afër, i cili ka regjistruar momentet e aksidentit. Nga subjekti është konstatuar se: *“Mjeti zetar ka qenë i pozicionuar plotësisht në korsinë e tij, ka qenë me shpejtësi të ulët dhe në këtë moment ai goditet nga një mjet “\*\*\*\*” ndërmjet gomave të pasme të tij. Goditja ka qenë e fortë, pasi përveçse dëmton rëndë pjesën e përparme të automjetit, i jep shpejtësi përpara për inerci zetarit dhe e përmbys atë disa metra pas përplasjes”.*

14.4.5 Në datën 8.5.2018 subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit E. Gj. si person që i atribuohet vepra penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal.

14.4.6 Nga subjekti është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin E. Gj., pasi vlerësohet se ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal. Kërkesa e subjektit është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me vendimin e datës 10.5.2018.

14.4.7 Mbi kërkesën e prokurorit Emror Kasaj për zbatimin e masës së sigurimit, ku prokurori kërkoi vazhdimin e masës “arrest në burg” ndërsa personi nën hetim kërkoi një masë më të butë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me vendimin e datës 17.5.2018 vendosi zëvendësimin e masës me detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore pasi janë zbutur kushtet. Nga subjekti Emror Kasaj nuk është ushtruar ankim ndaj këtij vendimi gjykate.

14.4.8 Me përfundimin e aktekspertimit datë 22.4.2018 nuk ka qenë dakord personi nën hetim E. Gj. i cili ka kërkuar riekspertim me grup ekspertësh, pasi ekspertimi nuk është i plotë. Prokurori Emror Kasaj ka qenë dakord me një riekspertim autoteknik dhe ka urdhëruar kryerjen e një akti tjetër ekspertimi me 3 ekspertë.

---

prokurori Emror Kasaj ka vendosur apriori kryerjen e një aktekspertimi duke ndryshuar emrat e ekspertëve haptazi në mënyrë të njëanshme, megjithatë ky aktekspertimi doli njësoj si akti i parë; (d) si familjarët apo dhe avokatët nuk janë njoftuar për aktekspertimin edhe pse ka dalë fajtor sërish shtetasi E. Gj., pra në të dy aktekspertimet ka dalë fajtor shtetasi E. Gj.; (e) prokurori vendosi të pranojë kërkesën e shtetasit E. Gj. duke bërë aktekspertimi të tretë, jashtë afatit ligjor duke e zgjatur hetimin pa fund, pa lajmëruar në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale edhe pas dy akteve të mëparshme.

<sup>97</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.4. 2020, e Prokurorisë Gjirokastër.

14.4.9 Aktekspertimi i datës 10.8.2018 me 3 ekspertë ka konkluduar se shkak i determinant i aksidentit është shkelja e bërë nga drejtuesi i automjetit tip “\*\*\*”, E. Gj., i cili ka lëvizur me shpejtësi më të madhe (nenet 139/3 dhe 140/1,2 të Kodit Rrugor).

14.4.10 Personi nën hetim E. Gj. nuk ka qenë dakord me përfundimin e këtij akti duke e konsideruar atë si jo të plotë dhe ka kërkuar riekspertim me pesë ekspertë. Prokuroria ka marrë parasysh kërkesën e shtetasit E. Gj. dhe është caktuar kryerja e një riekspertimit me 5 ekspertë.

14.4.11 Në aktekspertimin datë 8.10.2018 me 5 ekspertë është konkluduar se: *“Nëse drejtuesi i mjetit zëtor do të kishte respektuar normat e sjelljes, të përcaktuara në Kodin Rrugor dhe, konkretisht, nenin 152 (ndryshimi i drejtimit të korsisë ose manovra të tjera) ky aksident nuk do të kishte ndodhur. Drejtuesi i mjetit nuk ka pasur mundësi teknike të shmangte aksidentin edhe nëse ai do të lëvizte me shpejtësinë e lejuar 40 km/h.*

14.4.12 Nisur nga përfundimi i këtij akti, në datën 8.10.2018, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetasit S. N. si personi të cilit i atribuohet vepra penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal dhe në datën 1.11.2018, subjekti ka përpiluar akt për njoftimin e akuzës, duke marrë të pandehur shtetasin S. N. për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal dhe në po këtë datë u ka njoftuar palëve të interesuara përfundimin e hetimeve.

14.4.13 Në datën 10.11.2018, subjekti ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyrokastër kërkesën për gjykim për të pandehurin S. N., akuzuar për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 299/3 i Kodit Penal, pushimin e pjesshëm të hetimeve për shtetasin E. Gj. për veprën penale të parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal, shuarjen e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për shtetasin E. Gj.

14.4.14 Më pas, çështja i është caktuar për ndjekje një prokurori tjetër. Në dosjen penale nuk ka vendim të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit Emror Kasaj me prokurorin S. B. Prokurori S. B ka dërguar në gjykatë kërkesën për gjykim në ngarkim të shtetasit S. N., me të njëjtën përmbajtje.

14.4.15 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, me vendimin e datës 22.6.2020, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit S. N. për kryerjen e veprës penale ‘shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor’ dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit me burgim duke e vendosur në provë të pandehurin për një periudhë 3-vjeçare”*. Pas ankimit të këtij vendimi nga i pandehuri S. N., ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2021.

14.4.16 Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, bazuar në pretendimet e denoncuesit S. N. ka konstatuar se:

a) Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal të datës 8.8.2018 nuk rezulton t’u jetë njoftuar palëve (S. N. dhe E. Gj.) në përputhje me nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penal (në vendim, përveç nënshkrimit të subjektit Emror Kasaj, ka një firmë që nuk identifikohet).

b) Subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për gjykim të datës 10.11.2018 për të pandehurin S. N., akuzuar për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, ka referuar dispozitën

299/3 të Kodit Penal, që parashikon një veprë tjetër penale “shkelja e rregullave mbi fluturimet” që nuk ka lidhje me këtë procedim penal.

c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës datë 17.5.2018 për zëvendësimin e masës së sigurimit (nga “arrest në burg” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për të pandehurin E. Gj.) në përputhje me pikën 1/1, të nenit 249 të Kodit të Procedurës Penale, në një kohë kur qëndrimi i tij në seancë ishte për vazhdimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

d) Është i paqartë vendimi i subjektit të rivlerësimit për kryerjen e një akti të tretë ekspertimi autoteknik, i cili konkludoi në pafajësinë e të pandehurit E. Gj., duke zgjatuar hetimet në mënyrë të panevojshme, në një kohë që të dyja aktet e para të ekspertimit kanë përcaktuar si shkak determinant të aksidentit veprimet e drejtuesit të automjetit tip “\*\*\*” E. Gj., duke përcaktuar lidhjen shkak-pasojë, e përforcuar dhe me mendimin e subjektit të shprehur pas këqyrjes së pamjeve filmike sipas procesverbalit të datës 8.5.2018.

e) Subjekti i rivlerësimit nuk i ka njoftuar përfundimin e hetimeve të pandehurit S. N., të dëmtuarës dhe trashëgimtares së viktimës H. N. dhe E. Gj., me cilësinë e personit të regjistruar në procedim penal, në kundërshtim me nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale.

f) Subjekti i rivlerësimit nuk i ka njoftuar aktakuzën e datës 1.11.2018 të pandehurit S. N. apo mbrojtësit të tij në kundërshtim me pikën 1, të nenit 34<sup>98</sup>, të Kodit të Procedurës Penale.

g) Subjekti i rivlerësimit nuk ka vënë në dispozicion të mbrojtësit të të pandehurit S. N. kopje të dokumentacionit të ndodhur në dosjen penale (sipas kërkesës së tij të datës 18.5.2018) në kundërshtim me nenet 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

14.4.17 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve për shtetasin e dyshuar E. Gj. është nënshkruar nga mbrojtësi i caktuar me prokurë B. A. Për shtetasin e dyshuar S. N. njoftimi i këtij akti nuk është bërë pasi në këtë datë emri i tij nuk ishte regjistruar si i dyshuar për veprën penale.

14.4.18 Subjekti ka shpjeguar se referimi i dispozitës 299/3 në vend të 290/3 është gabim material.

14.4.19 Subjekti ka shpjeguar se vendimi i gjykatës për ndryshimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” nuk është akimuar prej tij pasi nga momenti i ekzekutimit të masës deri në përfundim të afatit të ankimit janë verifikuar shumë fakte të rëndësishme në drejtim të fajësisë (p. sh.: fakti që drejtuesi i automjetit kishte bërë ndërprerje të menjëhershme të rrugës kryesore duke hyrë në një rrugë dytësore pa ndaluar në tabelën \*\*\*, riverifikimi i pamjeve filmike me hollësi). Këto fakte e zbehnin shumë dyshimin për fajësinë e shtetasit E. Gj. dhe jo vetëm vendimi i gjykatës u konsiderua i arsyeshëm, por pas kërkesave të palëve është urdhëruar edhe një aktekspertim i ri me grup ekspertësh.

---

<sup>98</sup>Neni 34 “Marrja e cilësisë së të pandehurit”: “1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij”.

14.4.20 Për vendimin e kryerjes së një akti të tretë ekspertimi, subjekti ka shpjeguar se ky vendim ka qenë jo vetëm i justifikuar, por edhe i domosdoshëm. Nuk është eksperti ai që përcakton fajësinë në një procedim penal, por prokurori dhe gjykata i vlerësojnë këto rezultate. Nëse rezultatet nuk janë bindëse për prokurorin nuk ka se si ky i fundit të bindte gjykatën. Ekspertët kanë marrë atributin e prokurorit dhe gjykatës duke përcaktuar shkakun determinant,, i cili është një proces i mbështetur mbi fakte juridike të ligjit dhe fakte teknike të sqaruara nga ekspertët të cilin e vlerëson prokurori dhe vendimin përfundimtar e merr vetëm gjykata. Ka qenë pikërisht ekspertimi me 5 ekspertë që ka qenë bindës, jo vetëm për prokurorët, por edhe për gjykatën në të dyja shkallët e gjykimit. Kështu që edhe hetimet nuk janë zgjatur në mënyrë të panevojshme, por për të kryer veprime hetimore të domosdoshme.

14.4.21 Në lidhje me mosnjoftimin e përfundimit të hetimeve palëve, si dhe mosnjoftimin e aktakuzës, duke qenë se i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk paraqiteshin për t'u njoftuar, oficeri i policisë gjyqësore, në prani të një avokati të caktuar kryesisht, kanë shkuar në banesën e të pandehurit, por ky i fundit nuk ka pranuar të njihet me aktet duke e fyer oficerin dhe avokatin, fakt ky i pasqyruar në f. 396 të fashikullit.

14.4.22 Për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit në dosje, mbrojtësit e të pandehurit S. Nj. subjekti ka shpjeguar se gjatë hetimeve paraprake për shkak të sekretit të hetimeve palëve iu njoftohen vetëm ato akte që ligji i parashikon si p. sh. vendimi për ekspertim, aktekspertimet, njoftimet ndërsa pjesa tjetër e dosjes njoftohet në kohën e përfundimit të hetimeve.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

14.4.23 Komisioni vëren se në lidhje me mosnjoftimin e shtetasit S. N. me pretendimin se në këtë datë emri i tij nuk ishte regjistruar si i dyshuar për veprën penale, nuk qëndron pasi shtetasi S. N. edhe pse nuk kishte statusin e të pandehurit kishte statusin e viktimës (pasi në këtë aksident kishte humbur jetën djali i tij, si dhe vetë ai kishte pësuar dëmtime të rënda shëndetësore). Subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale që përcakton se vendimi duhej t'i njoftohej të pandehurit dhe viktimës.

14.4.24 Për referimin gabim të dispozitës së referuar si gabim material, Komisioni e vlerëson të mjaftueshëm shpjegimin e subjektit.

14.4.25 Për mosankimimin e vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurisë për shtetasin E. Gj., Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Ai ka vepruar në kundërshtim me pikën 1/1, të nenit 249, të Kodit Penal në mosankimin e vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit për të pandehurin E. Gj. në një kohë kur qëndrimi i tij bazuar në provat e administruara gjatë hetimit ishte që për të pandehurin të vijonte masa e sigurimit "arrest në burg" (aktekspertimi i datës 22.4.2018 që përcaktoi fajtor E. Gj., këqyrja e pamjeve filmike nga subjekti bazuar në procesverbalin e datës 8.5.2018, ku subjekti deklaroi se nga pamjet filmike konstatohet se zetori ka qenë pozicionuar plotësisht në korsinë e tij). Pra, shpjegimi i tij se brenda afatit 5-ditor që duhej bërë ankimi, dolën fakte të reja që lehtësonin pozitën e të pandehurit E. Gj. nuk qëndron pasi këto pretendime kundërshtojnë vetë qëndrimin e mëparshëm të subjektit.

14.4.26 Për mosnjoftimin e përfundimit të hetimeve dhe aktakuzës të pandehurit S. N., subjekti ka dhënë shpjegime të karakterit deklarativ dhe të paprovuara. Subjekti nuk ka vepruar në përputhje me dispozitën 140 të Kodit të Procedurës Penale në njoftimin e të pandehurit S. N.



14.4.27 Për dhënien e akteve procedurale të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, përveç akteve të mosnjoftuara të përmendura më lart, rezulton se palëve u janë komunikuar aktet e tjera procedurale.

14.4.28 Për vendimin e kryerjes së një akti të tretë ekspertimi, Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me këtë konstatim. Shpjegimi i dhënë prej tij është kontradiktor me faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit nuk kishte përse të urdhëronte kryerjen e një akti të tretë ekspertimi, pasi kjo ka qenë vetëm kërkesa e të pandehurit. Subjekti mund të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi të tretë kur dy aktet e para kundërshtonin njëri-tjetrin. Në rastin konkret, dy aktet e para nxirrnin fajtor të pandehurin E. Gj., po kështu edhe subjekti në procesverbalin e mbajtur pasi kishte këqyrrur pamjet filmike deklaronte se zetori ishte plotësisht i pozicionuar në rrugën e tij, që nuk kishte ndërprerje të rrugës së automjetit të shtetasit E. Gj., pra, subjekti e kishte bindjen e tij që provohej fajësia e shtetasit E. Gj.

Ndryshe nga sa subjekti deklaroi në seancën dëgjimore ku pranoi se aktekspertimet janë kryer se subjekti nuk kishte krijuar bindjen e tij për fajësinë e shkaktarit të aksidentit, nga aktet e fashikullit penal rezulton se kryerja e aktekspertimeve është bërë pasi i pandehuri E. Gj. nuk ka qenë dakord me rezultatet e dy akteve të para.

Në asnjë rast përfundimet e dy akteve të para të ekspertimit nuk janë kundërshtuar nga prokuroria, madje kryerja e aktekspertimeve është një nga provat kryesore të hetimit në përcaktimin e fajësisë dhe dënimin e personit që ka shkaktuar veprën penale, ndryshe nga shpjegimi i subjektit në seancë se aktekspertimi nuk është determinant dhe sipas tij ekspertët kanë marrë atributet e prokurorit dhe gjykatës. Gjithashtu, avokati i shtetasit S. N., me kërkesën e datës 7.12.2018, ka kërkuar nxjerrjen e pavlefshme të aktekspertimit të tretë dhe kryerja e një aktekspertimi të katërt me 7 ekspertë meqë subjekti ka hetuar me dy standarde, kërkesë së cilës subjekti nuk i është përgjigjur.

I pyetur në seancë dëgjimore nga relatori i çështjes se përse u krye një ekspertim i tretë kur dy aktet e para dhe pamjet filmike përcaktonin qartë fajësinë e shtetasit E. Gj., subjekti ka shpjeguar se nuk ishte krijuar ende bindja prej tij se fajësia ishte e shtetasit E. Gj. Gjithashtu, i pyetur se përse nuk mori parasysh kërkesën e mbrojtësit të shtetasit E. Gj. për kryerjen e një aktekspertimi të 4-ërt me 7 ekspertë, subjekti u përgjigj se me aktin e tretë ishte krijuar bindja për fajësinë e shtetasit S. N. dhe akti i katërt nuk ishte i nevojshëm.

14.4.29 Komisioni arrin në përfundimin se në veprimet e subjektit të rivlerësimit janë vërejtur mangësi në drejtim të ndërmarrjes së hapave të duhur, plotësues proceduralë hetimorë duke sjellë si pasojë favorizimin e shtetasit E. Gj. në drejtim të pafajësisë së tij. Pavarësisht këtyre mangësive, Komisioni i vlerëson ato si të pamjaftueshme për aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për largimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, por në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje Komisioni konkludon se veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje konsiderohen në një masë të konsiderueshme duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

14.5 **Denoncim i shtetasit V. Ç.**<sup>99</sup> pretendon se nga prokurori Emror Kasaj, që ka vendosur pushimin e çështjes, ku denoncuesi është kallëzues nuk ka marrë pjesë në seancat që zhvilloheshin në gjykatë, kur ishte kërkuar shfuqizimi i vendimit të prokurorisë.

14.5.1 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë<sup>100</sup> fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*, nga ku rezulton se shtetasi V. Ç. në datën 28.4.2018 ka bërë kallëzim penal për veprën penale “vrasje me paramendim”, e mbetur në tentativë. Në datën 15.2.2019, për këtë çështje, nga Drejtuesi i Prokurorisë është bërë zëvendësimi i prokurorit S. Ç. me prokurorin Emror Kasaj. Subjekti, në datën 15.3.2019 ka regjistruar procedimin penal të kallëzimit të shtetasit V. Ç. për veprën penale “vrasje me paramendim”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 78/1-22 i Kodit Penal pa autorë.

14.5.2 Nga subjekti janë kryer veprime hetimore të lëna detyrë nga gjykata<sup>101</sup> dhe në përfundim të hetimit në datën 8.7.2019 subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesën për “pushimin e çështjes penale”, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

14.5.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e datës 15.1.2020<sup>102</sup>, ka vendosur “*kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor për vazhdimin e hetimeve duke caktuar si datë të përfundimit të hetimeve datën 31.3.2020*”.

14.5.4 Prokurori (në fashikull nuk ka ankim) ka bërë ankim ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Kjo çështje nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit, konfirmuar kjo edhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2022, drejtuar subjektit Emror Kasaj.

14.5.5 Gjatë kësaj kohe, pa u shqyrtuar ende çështja në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, nga subjekti janë kryer veprime hetimore (të lënë si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin e datës 15.1.2020). Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti, në datën 15.12.2020 i është drejtuar përsëri gjykatës me kërkesë për “pushimin e çështjes”, ende pa u shprehur Gjykata e Apelit për kërkesën e parë.

14.5.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e datës 19.7.2021<sup>103</sup>, bazuar në kërkesën e prokurorit Emror Kasaj, i cili ka kërkuar kthimin e dosjes së ardhur në gjykim, ka vendosur “mosshqyrtimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin e akteve”. Gjykata ka arsyetuar se kjo çështje nuk duhej dorëzuar nga prokurori në gjykatë për sa kohë nuk ka një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit, pasi bëhet fjalë për të njëjtën kërkesë dhe procedim penal që është duke u gjykuar.

14.5.7 Komisioni, pas analizimit të dosjes, ka konstatuar se:

a) Subjekti, në kundërshtim me nenet 329/3/b dhe 329/8/III të Kodit të Procedurës Penale, ka vijuar:

- të kryejë veprime hetimore në lidhje me çështjen, pa u shprehur ende Gjykata e Apelit për ankimin e bërë nga vetë ai ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë,

<sup>99</sup>Nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2019.

<sup>100</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2020, e Prokurorisë Gjirokastrë.

<sup>101</sup>Në datën 10.5.2019 u pyet znj. E.S., punonjëse policie; më 25.4.2019 u pyetën shtetasit S.S. dhe S.K., punonjës të policisë bashkiake; më 24.5.2019 u pyet shtetasi V. Ç.; më 29.5.2019 u pyet shtetasi S.M., punonjës policie, më 10.6.2020 OPGJ marrje të dhënash nga personi që ka dajeni P.R. ; më 17.6.2019 sekuestrim sendesh të shtetasit V. Ç.; më 24.6.2019 u pyet shtetasi I.I..

<sup>102</sup>Vendimi nr.\*\*\*, datë 15.1.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

<sup>103</sup>Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2021.

e cila vendosi kthimin e akteve prokurorit për kërkesën e pushimit të çështjes së dërguar në gjykatë nga subjekti;

- ka dërguar përsëri në gjykatë më 15.12.2020 kërkesë për pushimin e çështjes në një kohë që Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk ishte shprehur ende lidhur me ankimin e bërë nga subjekti ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila vendosi kthimin e akteve prokurorit për kërkesën e pushimit të çështjes së dërguar në gjykatë nga subjekti po për të njëjtën çështje.

b) Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 15.12.2020 nuk rezulton t'u jetë komunikuar palëve në përputhje me nenin 328/2<sup>104</sup> të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

14.5.8 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se rreth gjysma e fashikullit ka të bëjë me dosjen e invaliditetit të kallëzuesit ku ai që prej vitit 2007 rezultoi si invalid i plotë për shkak të gjendjes mendore. Në këtë fashikull ndodhet edhe kërkesa drejtuar gjykatës për heqjen/kufizimin e zotësisë për të vepruar për këtë shtetas.

Pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka rrëzuar kërkesën e subjektit për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, ankues i kësaj ka qenë kallëzuesi V. Ç. dhe jo subjekti edhe pse vendimi i gjykatës ishte në favor të tij. Subjekti shpjegon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor nuk e ka njoftuar për një kopje të ankimit ndaj vendimit të gjykatës që rrëzoi kërkesën e tij dhe ai nuk ka pasur mundësi të dinte se vendimi nuk kishte marrë formë të prerë, pasi çështja ishte dërguar në Gjykatën e Apelit dhe nuk ishte gjykuar ende.

14.5.9 Vendimi i pushimit nuk i është njoftuar palës/kallëzuesit, i cili paraqitet çdo javë në ambientet e prokurorisë dhe gjykatës, pasi me gjithë kërkesat e prokurorisë që ky i fundit të nënshkruante marrjen dijeni, ai nuk ka pranuar të kryejë këto procedura.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

14.5.10 Komisioni vëren se në fashikullin penal është depozituar ankimi i shtetasit V. Ç.

ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë datë 15.1.2020, që vendosi kthimin e akteve të prokurorit për vijimin e hetimeve të mëtejshme, ky ankim është bërë ndaj një vendimi të ndërmjetëm të gjykatës që ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar.

Fakti që subjekti, pa marrë dijeni nëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar apo ka marrë formë të prerë, ka vijuar me kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore duke konkluduar me një vendim pushimi, veprim ky që vjen në kundërshtim me nenet 414 dhe 415 të Kodit të Procedurës Penale.

14.5.11 Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte njoftuar vendimin e pushimit të çështjes, kallëzuesit V. Ç. në përputhje me pikën 2, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në bazë të kërkesave të parashikuara në nenin 140 të Kodit të Procedurës Penale<sup>105</sup>.

---

<sup>104</sup>Neni 328 "Pushimi i akuzës ose çështjes": "2. Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë".

<sup>105</sup>Neni 140 "Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë": "1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij kodi. Kur nuk

## KONSTATIME TË TJERA

15 Komisioni, nisur nga *indicie* për të cilat u vu në dijeni nga mjete të informimit publik, ka kryer hetime për disa çështje penale ku ngrihen pretendime që kanë të bëjnë me kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj si vijon:

15.1 **Procedimi penal nr. \*\*\*** për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, si dhe “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/2 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve L. K., M. Z., M. B., E. S., S. D. dhe R. J.

15.2 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë<sup>106</sup> fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*. Nga prokurori i çështjes Emror Kasaj është bërë kërkesa e datës 10.7.2020 për dërgimin e çështjes në gjyq në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në ngarkim të të pandehurve S. D., R. J., L. K., E. S. dhe shtetasit M. B., akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, gjithashtu për shtetasin M. B., akuzuar edhe për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

15.3 Gjatë hetimit, nga subjekti, në datën 22.1.2020 është dërguar kërkesa për vleftësimin e ligjshëm të arrestit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të të arrestuarve në flagrancë E. S. dhe M. B. për veprën penale të parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/2 të Kodit Penal për shtetasin M. B., ndërsa për të ndaluarit në flagrancë M. Z., S. D., R. J. dhe L. K., për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” për të gjashtë personat nën hetim.

15.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e datës 23.1.2020, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë për të gjashtë personat nën hetim dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

15.5 Gjatë hetimit, nga i pandehuri L. K., është kërkuar në gjykatë zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie” me pretendimin se *është i sëmurë dhe ka nevojë për kurim, ka shfaqur luhatje të forta të diabetit dhe është dërguar me urgjencë në Spitalin Rajonal ‘\*\*\*, për arsye të situatës së pandemisë COVID-19, kurimi në ambientet e paraburgimit është e pamundur*. Në seancë ka qenë prezent prokurori J. Ç., i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës pasi nuk janë kushtet për të zbutur masën e sigurimit. Gjykata, me vendimin e datës 2.4.2020, ka rrëzuar kërkesën e të pandehurit L. K., vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin e datës 22.4.2020.

15.6 Nga të pandehurit E. S., R. J., M. B. është kërkuar në gjykatë zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie” me pretendimin se shtetasi E. S. – *për shkak të situatës pandemisë COVID-19, gjendje fatkeqësie natyrore, ka dy prindër të moshuar dhe të sëmurë që për shkak të covidit kërkojnë përkujdesje*; shtetasi R. J. – *për shkak të situatës covid, gjendje fatkeqësie natyrore, ka bashkëshorten në shtëpi me dy fëmijë*. M. B. – *për shkak të*

---

*mund t'i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të. Në aktin e njoftimit tregohen gjeneralitetet e personit që merr përsipër njoftimin dhe lidhja e tij me të pandehurin”.*

<sup>106</sup>Përgjigja nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

*situatës covid, gjendje fatkeqësie natyrore, për shkak të familjarëve dhe shmangies nga prekja e kësaj sëmundje”.*

15.7 Në seancë gjyqësore ka qenë prezent prokurori Emror Kasaj, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës pasi nuk janë kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit. Gjykata, me vendimin e datës 13.4.2020, ka rrëzuar kërkesën e të pandehurve dhe pas ankimit të bërë nga të pandehurit, ky vendim është lënë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin e datës 22.4.2020.

15.8 Nga i pandehuri R. J. është kërkuar përsëri në gjykatë zëvendësimi i masës së sigurimit, nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie” me pretendimin se *ka bashkëshorten në shtëpi me dy fëmijë të mitur, bashkëshortja e papunë dhe e sëmurë dhe për shkak të situatës së covid nuk ka kush të përkujdeset.* Në seancën gjyqësore ka qenë prezent prokurori Emror Kasaj, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit pasi nuk janë kushtet për zëvendësim.

15.9 Gjykata e Rrethit Gjirokastër me vendimin e datës 8.6.2020<sup>107</sup> ka pranuar kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me masën e sigurimit “arrest në shtëpi” e kërkesës duke argumentuar se janë plotësuar kushtet.

Nuk rezulton që nga subjekti të jetë ankimuar ky vendim i gjykatës edhe pse në seancë kërkoi rrëzimin e kërkesës.

15.10 Nga i pandehuri tjetër L. K. është kërkuar përsëri në gjykatë zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi” me të njëjtin pretendim si në kërkesën e parë, por në këtë kërkesë ka shtuar edhe faktin se *bashkëshortja e tij vuan nga sëmundje kronike kardiake dhe ka nevojë të vazhdueshme për bashkëshortin.*

Prezent në seancë ka qenë prokurori Emror Kasaj, i cili u shpreh se është dakord me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të personit nën hetim, si dhe gjendjen shëndetësore të bashkëshortes së tij.

15.11 Gjykata, me vendimin e datës 25.6.2020, ka pranuar kërkesën e të pandehurit L. K., duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” me atë “arrest në shtëpi”, duke argumentuar se janë plotësuar kushtet. Vendimi mori formë të prerë pasi nuk u ankimua.

15.12 Në fashikullin penal ndodhet i depozituar vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020, i shtetasit L. K. nga ku rezulton:

*1. Me vendimin nr.\*\*\*, datë 25.4.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka deklaruar fajtor për veprën penale “vjedhje” duke i të pandehurit një dënim përfundimtar prej 5 muaj e 7 ditë burgim.*

*2. Me vendimin nr.\*\*\*, datë 18.12.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka deklaruar fajtor për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe e dënon me 100,000 lekë gjobë.*

*3. Me vendimin nr.\*\*\*, datë 26.1.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka deklaruar fajtor për veprën penale “vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, e kryer në bashkëpunim duke e*

---

<sup>107</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 8.6.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në fashikullin penal të përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Gjirokastër nuk është i plotë, pasi është shkurtim vendimi dhe në të nuk pasqyrohet qëndrimi i prokurorit dhe argumentimi i gjykatës në pranimin e kërkesës për zëvendësim mase. Komisioni ka administruar këtë vendim nga faqja zyrtare [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) ku pasqyrohet qëndrimi i prokurorit dhe argumentimi i gjykatës.

*dënuar me 5 vjet burgim. Me vendimin nr.\*\*\*, datë 16.9.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.\*\*\*, datë 26.1.2011, për sa i përket fajësisë dhe cilësimit ligjor të veprës, ndryshim vendim për sa i përket masës së dënimit duke e dënuar me 7 vjet burgim.*

15.13 Prokurori Emror Kasaj, në datën 10.7.2020, ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq në ngarkim të të pandehurve S. D., R. J., L. K., M. Z., E. S. dhe M. B., akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, ndërsa për shtetasin M. B., akuzuar edhe për veprat penale “mbajtje pa leje” dhe “prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”. Gjatë seancës, nga subjekti Emror Kasaj është parashtruar se edhe sipas gjykatës nëse provat nuk mund të përdoren për të akuzuar të pandehurit R. J. dhe S. D., meqë kanë qenë në fazën përgatitore të veprës penale, përsëri duhet të procedohen për veprën penale “moskallëzim të krimit”. Në përfundim të seancës paraprake, subjekti Emror Kasaj ka kërkuar pranimin e kërkesës, ndërsa të pandehurit rrëzimin e saj.

15.14 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e datës 5.10.2020, ka vendosur: *1. Dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve L. K., M. Z., E. S. dhe E. B. për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”; 2. Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve S. D. dhe R. J. për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” për S. D. dhe lirin e menjëhershëm të tij nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër edhe shuarjen e masës së sigurimit për shtetasin R. J.*

Nuk rezulton që nga subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj të jetë bërë ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes.

15.15 Në fashikullin penal është edhe dokumenti diskutim përfundimtar për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 9.2.2021, të subjektit Emror Kasaj ku i kërkon gjykatës deklarin fajtor të të pandehurve L. K., M. Z., E. S., M. B. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e të pandehurve me 4 vjet e 8 muaj burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit M. B. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit M. B. për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe dënimin e tij me 1 vit burg. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve duke e dënuar të pandehurin M. B. me 7 vjet 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e të pandehurit M. B. me 5 vjet burgim.

15.16 Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosjen penale, ka konstatuar se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës sipas nenit 249<sup>108</sup> të Kodit të Procedurës Penale, e cila pranoi kërkesën e të pandehurit R. J. për zëvendësim e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”, në një kohë që subjekti në proces ka kërkuar nga gjykata rrëzimin e kërkesës së të pandehurit.

---

<sup>108</sup>Neni 249 “Ankimi ndaj masave të sigurimit” 1/1. Kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit sipas nenit 248 të këtij kodi prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda 5 ditëve.



b) Subjekti ka mbajtur qëndrime të ndryshme për të pandehurit L. K. dhe R. J.<sup>109</sup>, të cilët i kanë kërkuar gjykatës zëvendësim e masës së sigurisë (të dy nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”) në një kohë që të dy të pandehurit ndodheshin në të njëjtat rrethana (për të pandehurin L. K. subjekti në gjykatë ishte dakord me kërkesën e tij për zëvendësimin e masës, ndërsa për të pandehurin R. J. subjekti i kërkoi gjykatës rrëzimin e kërkesës).

c) Subjekti nuk ka marrë në konsideratë gjendjen gjyqësore<sup>110</sup> të të pandehurit L. K., i cili sipas vërtetimit të datës 29.4.2020 rezultonte i dënuar për tri vepra penale, vepra penale e fundit e vitit 2011 (vrasje me dashje e mbetur në tentative në bashkëpunim), ku ishte dënuar me 7 vjet burg, ndërkohë që subjekti miratoi kërkesën e të pandehuri L. K. për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me “arrest shtëpie”, pa vlerësuar rrezikshmërinë e tij dhe pa marrë parasysh nenin 229<sup>111</sup> të Kodit të Procedurës Penale.

d) Subjekti nuk ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes sipas nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale për dy 2 nga 6 të pandehurit, në një kohë që subjekti në kërkesën e tij dhe gjatë seancës ka kërkuar dërgimin në gjyq për të gjashtë të pandehurit, duke vepruar në kundërshtim edhe me vetë qëndrimin e tij.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

15.17 Subjekti në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se për mosankimin e vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës së shtetasit R. J. për zëvendësim mase sigurimi, nuk e ka ankimuar vendimin pasi gjendja e bashkëshortes së shtetasit R. J. ka qenë e vështirë, saqë nuk mund të kujdesej dot askush përveç tij dhe se gjykata ka rrëzuar kërkesën e të arrestuarit për të caktuar si masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, por ka caktuar masën “arrest në shtëpi”.

15.18 Për mbajtjen e dy qëndrimeve të ndryshme për dy të pandehurit kur ishin në kushte të njëjta, subjekti ka shpjeguar se dy rastet nuk janë aspak të njëjta pasi, së pari, i arrestuari L. K. kishte vetë probleme të shëndetit të evidentuara nga institucioni i IEVP-së dhe, së dyti, i arrestuari i ka kërkuar gjykatës “arrest në shtëpi” dhe jo masë më të lehtë si ajo e detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore në ndryshim nga kërkesa e shtetasit R. J. Pra, rastet janë krejt të ndryshme dhe qëndrimi i prokurorit ka qenë i ndryshëm.

15.19 Për mosmarrjen në konsideratë të gjendjes gjyqësore të të pandehurit L. K., i dënuar me parë për krime të rënda, subjekti ka shpjeguar se dënimet e mëparshme të të arrestuarit nuk janë aspak vendimtare në caktimin e masave të sigurimit, të cilat caktohen nga gjykata sipas nevojave të sigurimit për veprën penale në hetim apo gjykim dhe nuk shërbejnë si paragjykim për caktimin e masave të papërshtatshme të sigurimit. Neni 229/2 i Kodit Penal, kur citon vazhdimësinë dhe përsëritjen si rrethanë që duhet të vlerësohet nga gjykata ka parasysh vazhdimësinë dhe përsëritjen e veprës penale në proces për të cilën caktohet masa e sigurimit dhe jo dënime për raste të mëparshme. Fakti i të qenit i dënuar merret parasysh nga gjykata

---

<sup>109</sup>R. J. ka ngritur si pretendim se “ka bashkëshorten në shtëpi me dy fëmijë të mitur, bashkëshortja e papunë dhe e sëmurë dhe për shkak të situatës së covid nuk ka kush të përkujdeset”, ndërsa shtetasi L. K. ka ngritur si pretendim se “ai është i sëmurë dhe ka nevojë për kurim ... ai ka shfaqur luhatje të forta të diabetit dhe është dërguar me urgjencë në Spitalin Rajonal \*\*\*për arsye të situatës së covidit, kurimi në ambientet e paraburgimit është e pamundur, por në këtë kërkesë ka shtuar edhe faktin se bashkëshortja e tij vuan nga sëmundje kronike kardiake dhe ka nevojë të vazhdueshme për bashkëshortin”.

<sup>110</sup>Vërtetim i gjendjes gjyqësore e datës 29.4.2020 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë.

<sup>111</sup>Neni 229 i Kodit të Procedurës Penale “Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal”.

vetëm në llojin dhe masën e dënimit dhe, konkretisht, për këtë shtetas nuk është aplikuar neni 59 i Kodit Penal me gjithë faktin që ai vuan nga diabeti dhe kishte probleme.

15.20 Për mosankimimin e vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes për dy nga gjashtë të pandehurit subjekti ka shpjeguar se të dy të arrestuarit nuk kanë dhënë shpjegime të hollësishme për rolin e tyre në këtë çështje, duke pretenduar se do të jepnin shpjegime përpara gjykatës. Kur çështja kaloi për shqyrtim në seancë paraprake, të arrestuarit dhe mbrojtësit e tyre dhanë sqarime të plota mbi faktin dhe interpretime juridike, të cilat kanë bindur gjykatën dhe prokurorin.

Pretendimi i subjektit si prokuror në debatin gjyqësor se së paku këta shtetas duhet të dërgohen për gjykim për veprën penale “moskallëzim i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal (referuar dijenisë së plotë të tyre të provuar nga përgjimi ambiantal) është rrëzuar nga pala mbrojtëse, e cila argumentoi se askush nuk ka detyrim të kallëzojë një krim që përgatitet ta kryejë vetë (aq me tepër që neni 37 i Kodit të Procedurës Penale garanton për të drejtën për të mos kallëzuar dhe dëshmuar edhe familjarë të afërt të autorëve të veprave penale). Duke qenë se ky argumentim juridik subjektit i është dukur i drejtë dhe nuk ka gjetur arsye ligjore me anë të të cilave të mund të argumentonte përpara Gjykatës së Apelit kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila gjithashtu i gjeti të drejta pretendimet e dy të arrestuarve të sipërcituar.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

15.21 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse kur përpiket që me arsyen e sëmundjes së bashkëshortes së të pandehurit R. J. të justifikojë mosankimimin e vendimit të gjykatës, në një kohë kur kjo situatë ishte e parashtruar nga vetë i pandehuri në kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurisë në gjykatë. Vetë subjekti në seancën gjyqësore kërkoi rrëzimin e kësaj kërkesë nga gjykata pasi (sëmundja e bashkëshortes së të pandehurit R. J.) nuk ishte një rrethanë e re që ndryshonte situatën e të pandehurit, që subjekti të ndryshonte qëndrimin e tij. Subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 249 të Kodit të Procedurës Penale.

15.22 Për qëndrimet e ndryshme të mbajtura për të pandehurit R. J. dhe L. K. subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Subjekti e bazon qëndrimin e tij sipas kërkesave të të pandehurve duke e lidhur arrestin në burg, kërkuar nga L. K., si masë më të rëndë se detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, i kërkuar nga R. J., dhe jo sipas vlerësimit të rrethanave të konstatuara gjatë gjykimit. Duket se nga subjekti i rivlerësimit është mbajtur një qëndrim favorizues ndaj të pandehurit L. K., duke mosrespektuar kështu kërkesat e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

15.23 Në lidhje me pretendimin se gjendja gjyqësore e mëparshme e të pandehurit (i dënuar për vepra të rënda) nuk ndikon në caktimin e masave të përshtatshme, subjekti nuk është aspak bindës me këtë deklaram. Ai duhet të kishte mbajtur në konsideratë faktin e dënimit të këtij subjekti për tri vepra penale të ndryshme ku për veprën e fundit penale është dënuar me 7 vjet burgim dhe, si i tillë, paraqiste rrezikshmëri shoqërore të lartë, pavarësisht faktit se ai vuante nga një sëmundje e diabetit apo dhe kardiake, të cilat kanë qenë prezente edhe më parë dhe jo në momentin e kërkesës për zëvendësim. Në kushtet kur shtetasi L. K. ishte person me precedentë të mëparshëm penalë, nga subjekti i rivlerësimit duhej t'u ishte kushtuar vëmendje



këtyre rrethanave, si edhe personalitetit të tij (pasi ishte dënuar me 7 vjet burg në vitin 2011 dhe sapo ka dalë nga burgu është përfshirë përsëri në veprimtari kriminale). Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me germën “c”, të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale<sup>112</sup>.

15.24 Për mosankimimin e vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes për dy nga të pandehurit subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës në mënyrë të vazhdueshme, ka mbajtur qëndrimin për dërgimin në gjyq të dy të pandehurve për veprën penale “kultivim të bimëve narkotike” ose të paktën për moskallëzimin e krimit, këtë qëndrim ai e ka pasur dhe krijuar nga provat e grumbulluara gjatë hetimit. Qëndrimi i tij është kontradiktor kur shpjegon se nuk u bë ankimi ndaj vendimit të gjykatës për shkak të argumenteve bindëse që dhanë mbrojtësit e të pandehurve, të cilët bindën prokurorin se kishin të drejtë. Komisioni vëren se qëndrimi i subjektit në këtë çështje nuk varet nga argumentimi që bën pala mbrojtëse e të pandehurit, qëndrimi i tij është i bazuar në prova dhe fakte. Komisioni vëren në përfundim se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 332/gj të Kodit të Procedurës Penale.

15.25 Komisioni, në vlerësimin e kësaj çështjeje, arrin në përfundimin se rezultojnë mangësi në ndërmarrjen e hapave të duhur proceduralë dhe mbajtje qëndrimesh kontradiktore nga subjekti i rivlerësimit, problematika këto që nuk vlerësohen deri në atë masë sa që ndaj subjektit të aplikohet pika 4, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 për largimin nga detyra, por në një vlerësim tërësor të kësaj praktike, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

15.26 Dosja gjyqësore “Kallëzim penal nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2019” kërkesë për vleftësim dhe caktim mase sigurimi.

15.27 Komisioni ka administruar dosjet përkatëse nga prokuroria<sup>113</sup> dhe gjykata<sup>114</sup>.

15.28 Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër në datën 2.10.2019 ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër materialet procedurale për veprat penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” dhe “shkatërrim prone”, parashikuar nga nenet 283 dhe 150 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit D. G. Ky shtetas është kapur në flagrancë duke dëmtuar gomat e një mjeti të parkuar në rrugë, ku i janë gjetur dy thika, si dhe nga kontrolli i ushtruar i janë gjetur copa lënde e ndarë në tri pjesë, e dyshuar si lëndë narkotike *cannabis sativa*, që rezultoi në masën 3.4 gram.

15.29 Veprimet hetimore janë kryer nga prokurori J. Ç., i cili ka përpiluar kërkesën drejtuar gjykatës për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për personin e dyshuar D. G., i cili është nën hetim për veprat penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” dhe “shkatërrim prone”. Në kërkesën e bërë, prokurori i referohet vetëm veprës penale “shkatërrim prone”, ku nga personi që është dëmtuar nga personi i arrestuar D. G. ka paraqitur një deklaratë noteriale, ku deklaron se është pajtuar me të dyshuarin dhe e ka falur. Nga

---

<sup>112</sup>Neni 228 “Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal”: c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

<sup>113</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2022, e Prokurorisë Gjirokastër.

<sup>114</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

prokurori J. Ç. kërkohet vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”. Nga prokurori është argumentuar se në caktimin e masës së sigurisë mbahet parasysh rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe autorit të kryerjes së saj. Vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi D. G. nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe po ashtu rrezikshmëria e të dyshuarit nuk vlerësohet e tillë.

15.30 Në seancën gjyqësore për vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, Prokuroria është përfaqësuar nga prokurori Emror Kasaj, i cili, gjithashtu, ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, kërkesë kjo e pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin nr. \*\*\* , datë 5.10.2019.

15.31 Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të fashikullit penal, ka konstatuar se:

Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore për të pandehurin D. G. (i cili hetohet për dy vepra penale – “shkatërrim prone”, që parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet dhe “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, që parashikon dënim me burgim nga 5 vjet deri në 10 vjet), nuk pajtohet me kërkesat e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale pasi vepra penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal është një vepër e përhapur dhe që paraqet rrezikshmëri shoqërore, e shprehur kjo edhe në marzhin e dënimit që parashikon duke e dënuar të pandehurin vetëm me burgim nga 5 vjet deri në 10 vjet.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

15.32 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se kjo çështje nuk është hetuar nga subjekti por nga prokurori J. Ç., i cili është deleguar prej tij për të marrë pjesë në seancë. Pasi e ka shqyrtuar këtë procedim për nevoja të procesit ka konstatuar se edhe qëndrimi i prokurorit J. Ç. ka qenë shumë i drejtë dhe ligjor pasi:

*Së pari*, megjithëse figura e veprës penale parashikon një dënim të lartë nga 5 deri në 10 vjet burgim, i arrestuari ka pasur me vete një sasi krejt minimale të lëndës narkotike (për përdorim vetjak) dhe ka pasur dyshime të forta se ishte vetë përdorues i saj. Nga materiali referues nuk kishte asnjë dyshim se ky shtetas mund të ishte edhe shitës i lëndëve narkotike. Referuar sasisë së vogël të lëndës narkotike dhe në rastet kur dozat janë në sasi të vogla, si në rastin konkret, praktika gjyqësore ka shkuar edhe drejt pushimit të çështjes për këto raste (përdorimi i lëndëve narkotike është fakt i padënueshëm penalisht). Pikërisht për shkak të dozës krejt minimale dhe faktit që i arrestuari ka rezultuar përdorues, gjykata ka aplikuar minimumin e dënimit dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Pikërisht, për shkak të kësaj praktike prokurori i çështjes i ka kërkuar me shkrim gjykatës caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale, mendim të cilin subjekti e ka mbrojtur edhe vetë në seancë.

*Së dyti*: Në lidhje me veprën tjetër “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, kjo çështje është pushuar pasi praktika gjyqësore është e konsoliduar se për këtë lloj figure të veprës penale që kërkon nga ana objektive “... kur pasojat nuk janë të lehta” kërkohet që dëmi të jetë jo më i vogël se 30,000 lekë. Ndërkohë, vlera e gomës së automjetit të dyshuar se është çarë nga autori, është shumë më e vogël dhe rasti në fjalë nuk përbën vepër penale, por

marrëdhënie juridiko-civile, që rrjedh nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor, e cila mund të zgjidhet vetëm në gjykatën civile.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

15.33 Komisioni vëren se në përcaktimin e sasisë së lëndës narkotike të kapur nëse është për përdorim vetjak apo shitje, nga prokurori i çështjes duhet të ishte urdhëruar kryerja e një aktekspertimi, i cili e bën këtë përcaktim në mënyrë që të bëhet një vlerësim i situatës nëse duhet aplikuar neni 59 ose jo nga prokurori i çështjes.

15.34 Komisioni vlerëson se pavarësisht mangësive të konstatuara në hetimin e kësaj çështjeje, pesha e tyre nuk konsiderohet se arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e largimit nga detyra për kriterin profesional.

15.35 **Procedimi penal nr. \*\*\* prot., i vitit 2016** për veprat penale: “vjedhje me armë” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140-25 të Kodit Penal; “plagosja e rëndë me dashje”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 88-25 të Kodit Penal; si dhe “mbajtje pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit E. M.

15.36 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë<sup>115</sup> fashikujt e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015 dhe nr. \*\*\* të vitit 2016.

15.37 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në datën 31.3.2015, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* për veprën penale “vjedhje me armë” të banesës së shtetasve N. Ç. dhe A. Ç. Nga veprimet hetimore rezultoi se 3 persona me maska dhe armë në duar kanë grabitur shtetasin N. Ç. dhe bashkëshorten e tij duke i shkaktuar edhe plagosje të rëndë. Nga veprimet hetimore është konstatuar edhe një mjet i braktisur në afërsi të shtëpisë së grabitur, ku në të janë gjendur karta identiteti, kartëvizita, disa fishekë, një armë automatike, krehër me fishekë, dy paketa cigare etj. Nga kryerja e aktekspertimeve në vendngjarje dhe në mjetin e gjetur, nga shenjat e gjurmëve të gishtërinjve (që janë etiketuar me gerrat A, B, C, D, E janë verifikuar që i përkasin shtetasit R. R. (i cili është vrarë dy javë pas ngjarjes), gjurma “F” u identifikua që i përkiste shtetasit J. D., ku u verifikua se nuk kishte lidhje me ngjarjen, ndërsa gjurma “H” mbeti e paidentifikuar), si dhe nga hetimi rezultoi i implikuar në këtë ngjarje shtetasi E. I. dhe 3 persona të paidentifikuar.

15.38 Në përfundim të hetimeve nga Prokuroria, në datën 11.10.2016 është bërë ndarja e këtij procedimi me nr. \*\*\* në ngarkim të shtetasit E. I. (i cili ka ndihmuar autorët të largohen nga vendngjarja) për veprën penale “vjedhje me armë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të Kodit Penal. Për të pandehurin E. I. prokurori Emror Kasaj i kërkoi gjykatës dënimin e tij me 18 vjet burg dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e tij me 12 vjet burg.

15.39 Për 2 autorët e tjerë të paidentifikuar (pasi i treti u identifikua që ishte R. R.) prokuroria, këtë procedim e emërtoi me nr. \*\*\* të vitit 2016 për veprat penale “vjedhje me armë” e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 140-25 të Kodit Penal, “plagosje e rëndë me dashje, e

---

<sup>115</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 88-25 të Kodit Penal dhe “mbajtje pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal.

15.40 Në datën 11.10.2018, nga subjekti Emror Kasaj është marrë vendimi mbi rifillimin e procedimit penal nr. \*\*\* për veprat penale “vjedhje me armë” e kryer në bashkëpunim, “plagosje e rëndë me dashje” e kryer në bashkëpunim dhe “mbajtje pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municioneve”.

15.41 Në datën 11.10.2018 u depozitua aktekspertimi daktiloskopik nr. \*\*\* , datë 11.10.2018, i cili arrin në konkluzionin se gjurma papilare me germën H, e fiksuar në vendngjarje në datën 30.3.2015, është formuar nga gishtit i madh i dorës së majtë të shtetasit E. M.

15.42 Në datën 4.10.2018, në Tiranë, në vendin e quajtur ish-blok, ka ndodhur një konflikt me armë zjarri ku ka mbetur i vrarë shtetasi F. G. Në vijim të kësaj ngjarjeje janë marrë deklaramë dhe gjurmët daktiloskopike të shokut të këtij të fundit E. M. Sipas aktit daktiloskopik krahasues datë 11.10.2018 ka rezultuar se gjurma e gjetur në vendin e ngjarjes në Tepelenë, e shënuar me germën H, i përket pikërisht shtetasit E. M.

15.43 Subjekti, në datën 11.10.2018 ka nxjerrë urdhrin e regjistrimit të emrit të shtetasit E. M., që i atribuohet vepra penale e parashikuar nga nenet 140-25, 278 dhe 88-25 të Kodit Penal me argumentin se ka prova që krijojnë dyshime të arsyeshme se shtetasi E. M. dhe një autor tjetër i pidentifikuar kanë kryer veprat penale të lartpërmendura.

15.44 Subjekti, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, në datën 15.7.2019 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit për të dyshuarin E. M. nga “arrest në burg” në “detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe nga subjekti është argumentuar se rezulton e provuar, ndër të tjera, se sipas subjektit nga rrethanat e mësipërme rezulton se nuk ka dyshime të arsyeshme se autor i veprës penale është shtetasi E. M., por nga hetimi ka dyshime se autor i ngjarjes mund të ketë qenë shtetasi F. G., i vrarë në ngjarjen e ish-blokut. Për këtë arsye duke qenë se çështja është ende në hetim dhe nevojat e sigurimit janë zbutur, deri në përfundimin e hetimeve masa e sigurimit “arrest në burg”, e caktuar me vendimin e datës 24.1.2019 për të arrestuarin E. M. të zëvendësohet me masën “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”.

15.45 Kërkesa e subjektit për zëvendësimin e masës së sigurimit është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe me vendimin e datës 17.7.2019<sup>116</sup> urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij.

15.46 Në datën 18.12.2019 nga subjekti është përpiluar kërkesa për pushimin e pjesshëm të çështjes penale në ngarkim të shtetasit E. M., drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, pasi, sipas prokurorit, nga hetimi rezulton se nuk ka dyshime të arsyeshme se autor i veprës penale mund të ketë qenë shtetasi E. M., pasi nga hetimi ka dyshime se autor i ngjarjes mund të ketë qenë shtetasi F. G. i vrarë .... Në këto kushte, hetimet për të pandehurin E. M. duhet të pushohen për arsye se nuk ka prova që të ketë kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai. Procedimi penal duhet të pezullohet deri në zbulimin e autorëve.

---

<sup>116</sup>Vendimi nr. \*\*\*.

15.47 Në datën 19.12.2019, nga subjekti Emror Kasaj është marrë vendimi i pezullimit të hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* viti 2016 pasi (në datën 18.12.2019 çështja është dërguar për pushim të pjesshëm të hetimeve në ngarkim të shtetasit E. M.) nuk është zbuluar ende autori i veprës penale.

15.48 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e datës 14.1.2020<sup>117</sup>, ka vendosur: *“Pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016 në ngarkim të të dyshuarit E. M., i dyshuar për veprat penale ‘vjedhje me armë’ e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140-25 të Kodit Penal, ‘plagosje e rëndë me dashje’, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 88-25 të Kodit Penal dhe ‘mbajtje pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municioneve’, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal”*.

15.49 Ky vendim është ankimuar nga të dëmtuarit e kësaj vepre penale në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin e datës 5.10.2020<sup>118</sup> ka vendosur *“prishjen e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 14.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues”*, duke arsyetuar se gjykata e rrethit gjyqësor nuk ka arsyetuar se përse duhet të pushohet procedimi penal në përjasje me aktet e procedimit dhe kërkimit të prokurorit, çmohet se ka lejuar kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të vendimit.

15.50 Pasi çështja u kthye për rigjykim me trup tjetër gjykues, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.3.2021, për shqyrtimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale ka vendosur *“kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve”* duke argumentuar se ka nevojë të kryhen hetime të tjera shtesë, veprime hetimore të kryhen brenda 3 muajve nga zbardhja e këtij vendimi.

15.51 Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë dakord me këtë vendimin të gjykatës dhe në datën 15.4.2021 ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2021, ka vendosur *“Lënien në fuqi të vendimit penal nr. \*\*\*, datë 25.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”*.

15.52 Në datën 16.2.2022 nga subjekti është përpiluar akti “pushimi i çështjes në ngarkim të shtetasit E. M.”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor pasi në datën 13.11.2021 rezultoi se shtetasi E. M. është vrarë me armë zjarri në qytetin e Tiranës.

15.53 Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosjen penale, ka konstatuar:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota në lidhje me çështjen penale, në kundërshtim me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale<sup>119</sup>, mangësi të evidentuara nga gjykatat e dy shkallëve<sup>120</sup>.

---

<sup>117</sup>Vendim nr. \*\*\* , i printuar nga faqja zyrtare [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) pasi nuk ndodhej në fashikullin penal nr. \*\*\*.

<sup>118</sup>Vendimi nr. \*\*\*.

<sup>119</sup>Neni 24 i Kodit të Procedurës Penale “Funkcionet e prokurorit”.

<sup>120</sup>Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin nr. \*\*\* , datë 14.1.2020, ka vendosur: *“Pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* , të vitit 2016, në ngarkim të të dyshuarit E. M., i dyshuar për veprat penale ‘vjedhje me armë’ e kryer në bashkëpunim, ‘plagosja e rëndë me dashje’ e kryer në bashkëpunim dhe ‘mbajtje pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municioneve’*. Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. \*\*\* , datë 5.10.2020, ka vendosur *prishjen e vendimit penal nr. \*\*\* , datë 14.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë*

- b) Subjekti ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të lehtë për të dyshuarin E. M., në kundërshtim me nenin 260<sup>121</sup> të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ishin kushtet për aplikimin e kësaj dispozite:
- Subjekti ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të lehtë në një kohë kur shtetasi E. M. vijonte të ishte i dyshuar deri në përfundim të hetimeve për tri vepra penale tepër të rrezikshme, për të cilat parashikohej dënim mbi 20 vjet.
  - Subjekti nuk ka administruar vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasit E. M. për të vërtetuar nëse ka qenë apo jo i dënuar më parë për ndonjë vepër penale.
  - Subjekti nuk ka marrë në konsideratë informacionin e pasqyruar nga sistemi *TIMS*, i ndodhur në fashikullin penal ku rezultoi se në vitin 2015 i dyshuari E. M. është arrestuar në flagrancë, pasi akuzohet për veprat penale “kanosje”, “plagosje e lehtë me dashje” dhe “mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 84, 89 dhe 278/2 të Kodit Penal, materiale që i kaluan prokurorisë. Po kështu, edhe njoftimi i Drejtorisë Vendore të Policisë Gjyrokastër, e cila kërkon njoftim në kufi për këtë shtetas pasi dyshohet se ka falsifikuar pasaportën e tij dhe lind e nevojshme pyetje e tij dhe të njoftohet oficeri i policisë gjyqësore në rast konstatimi hyrje/dalje në territorin shqiptar.
- c) Vendimi për zgjatje të afatit të hetimit të procedimit të datës 11.1.2019, i përpiluar nga subjekti Emror Kasaj nuk i është njoftuar palëve të interesuara, në kundërshtim me nenin 324/3 të Kodit të Procedurës Penale.
- d) Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë prej 8 muaj e gjysmë nga data e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër (i cili la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për kthimin e akteve prokurorit për hetime të tjera brenda një afati 3-mujor) deri në datën 16.2.2022, kur ka kërkuar pushimin e çështjes për personin e dyshuar E. M., duke mos respektuar afatet e vendimit të gjykatës dhe të dispozitës së nenit 329<sup>122</sup> të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

15.54 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, gjatë seancës dëgjimore kërkoi që të mos jepte shpjegime për këtë çështje në prani të pranishmëve në sallë pasi ishte çështje sensitive. Nga Komisioni u vendos që të pranohet kërkesa e subjektit, duke marrë kështu në konsideratë shpjegimet e dhëna për këtë çështje në prapësimet dërguar Komisionit.

---

*me tjetër trup gjyqësor* duke arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor nuk ka arsyetuar se përse duhet të pushohet procedimi penal në përjashtë me aktet e procedimit dhe kërkimit të prokurorit, çmohet se ka lejuar kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të vendimit. Pasi çështja u kthye për rigjykim me trup tjetër gjyqësor, Gjykata Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër me vendimin nr. \*\*\* , të datës 25.3.2021, për shqyrtimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale ka vendosur “kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve” duke argumentuar se ka nevojë të kryhen hetime të tjera shtesë, veprime hetimore të kryhen brenda 3 muajve nga zbardhja e këtij vendimi. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, e cila me vendimin nr. \*\*\* , datë 28.5.2021, ka vendosur: “Lënia në fuqi të vendimit penal nr. \*\*\* , datë 25.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër”.

<sup>121</sup>Revokimi, zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit.

<sup>122</sup>Neni 329 i Kodit të Procedurës Penale “Ankimi kundër vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes” 3. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve. Gjykata vendos sipas rastit: (b) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë.

15.55 Për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të lehtë për shtetasin E. M. subjekti ka shpjeguar se ky fakt nuk qëndron pasi nevojat e sigurimit tashmë ishin zbutur së tepërmi dhe çështja ishte duke shkuar drejt pushimit. Pra, nuk kanë qenë kushtet e paragrafit të tretë të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, por në rastet e paragrafit të dytë të këtij neni. Konkretisht, nga hetimi rezultoi se me shumë gjasa autori i dyshuar i veprës penale, i prezantuar me emrin S. ishte shtetasi F. G. i vrarë ..., shok lagje dhe mik i shtetasit E. M. Në lidhje me faktin se vepra penale dënohet deri në 20 vjet burg, subjekti sqaron si më sipër se ky nuk është kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm në caktimin e masave të sigurimit.

15.56 Në lidhje me mosadministrimin e dëshmisë se penaltetit të shtetasit të dyshuar, ky veprim nuk është bërë pasi për personat që rezultojnë të papërfshirë në veprën penale në hetim nuk është akt i nevojshëm. Ky dokument shërben vetëm që nga gjykata të merret parasysh personaliteti i të pandehurit kur vendos deklarinimin fajtor dhe caktimin dhe llojin e masës së dënimit.

15.57 Në lidhje me të dhënat e sistemit *TIMS* sipas të cilit shtetasi E. M. ka qenë i arrestuar në flagrancë për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89 dhe 278/2 të Kodit Penal, subjekti sqaron se përveçse ky fakt nuk ndikon në zëvendësimin e masës së sigurimit në rrethanat e sipërcituara, por të tria këto figura të veprës penale (kanosje, plagosje e lehtë me dashje dhe mbajtje pa leje e fishekëve) parashikohen nga Kodi Penal jo si krime, por si kundërvajtje penale.

15.58 Në lidhje me mosnjoftimin e vendimit për zgjatje të afatit të njoftimit palëve, subjekti ka shpjeguar se ky veprim nuk mund të bëhet pasi në kohën e vendimmarrjes për zgjatjen e afatit ishin duke u kryer hetime me metoda speciale të hetimit (përgjime dhe vëzhgime) dhe për të dyshuarin çështja në ngarkim të tij duhet të mbahej sekret deri në momentin e ndalimit. Kodi i Procedurës Penale parashikon shtyrjen e njoftimeve në raste të tilla. Në kohën e ndalimit të tij, e gjithë kopja e dosjes që i është vënë në dispozicion gjykatës është vënë në dispozicion edhe të të ndaluarit dhe mbrojtësit të tij.

15.59 Për moskryerjen e asnjë veprimi hetimor për një periudhë 8-mujore, subjekti (pavarësisht se këto detyra ishin kryer në mënyrë të detajuar në kohën e duhur dhe pavarësisht se dosja e plotë përbëhet nga gjashtë fashikuj dhe jo vetëm nga një fashikull, i cili i ishte vënë në dispozicion gjykatës) ka risqaruar si më sipër që vendimi i gjykatës së apelit i është njoftuar me vonesë në Prokurori. Sipas shënimit në kapakun e dosjes së përcjellë në formën e fotokopjes nga gjykata e shkallës së parë, data e paraqitjes së dosjes së Apelit në Prokurori është 21.2.2022.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

15.60 Komisioni, në konstatimin e tij në lidhje me mungesën e hetimeve të plota nga subjekti, duke mos plotësuar kërkesat e nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale<sup>123</sup>, i është referuar vendimeve të gjykatave, të cilat kanë evidentuar këto mangësi.

15.61 Në lidhje me zëvendësimin e masës së sigurimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, pasi subjekti i referohet gjasave/mundësisë që autor i ngjarjes të ketë qenë shtetasi F. G. i vrarë..., por që nga hetimi nuk rezultoi asnjë provë apo rrethanë që ta lidhte këtë shtetas me ngjarjen, ndërkohë në vendngjarje u gjet gjurma e gishtit e shtetasit E. M., për të

---

<sup>123</sup>Neni 24 “Funksionet e prokurorit”.

cilin rezultoi (nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave) se subjekti nuk kishte kryer hetime të plota në respektim të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale.

15.62 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së të pandehurit me masë më të butë në një kohë që i pandehuri ishte ende i dyshuar për vepra penale të rënda.

15.63 Për mosnjoftimin e vendimit për zgjatje afati hetimesh, Komisioni vëren se në dispozitën 324 të Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet mosnjoftimi i vendimit për zgjatje të afatit të njoftimit për shkak të përdorimit të metodave speciale (përgjimi/vëzhgimi) ashtu siç ka pretenduar subjekti.

15.64 Në lidhje me moskryerjen e veprimeve hetimore për rreth 8 muaj, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme që kanë të bëjnë me momentin e marrjes së vendimit për vendimin e Gjykatës së Apelit.

15.65 Komisioni, në vlerësimin e kësaj çështjeje, arrin në përfundimin se rezultojnë mangësi në ndërmarrjen e hapave të duhur proceduralë, si dhe vlerësim i gabuar dhe kontradiktor i tyre, nga subjekti i rivlerësimit, problematika këto që nuk vlerësohen deri në atë masë sa që ndaj subjektit të aplikohet pika 4, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për largimin nga detyra, por në një vlerësim tërësor të kësaj praktike, Komisioni arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

15.66 **Procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2021** për veprat penale “trafikim i mjeteve motorike” dhe “falsifikim”, parashikuar nga nenet 141/a/1 dhe 186/1 të Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit M. S.

15.67 Komisioni administroi<sup>124</sup> fashikullin e dosjes penale nr. \*\*\*, nga ku rezultoi se në datën 15.9.2021 subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, bazuar në nenin 141/a të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. S.

15.68 Nga të dhënat e administruara rezulton se shtetasi M. S. ka hyrë në territorin shqiptar me një mjet tip “furgon”, të cilin e ka marrë me qira dhe nuk e ka kthyer dhe nga pronari i mjetit është kallëzuar si i vjedhur në shtetin spanjoll ku shtetasi M. S. është shpallur në kërkim kombëtar në Spanjë. Shtetasi M. S. dyshohet se ka tentuar të shesë në Shqipëri mjetin e rezultuar të vjedhur në Spanjë.

15.69 Subjekti, në datën 15.9.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me kërkesën për vlerësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit M. S. për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike” dhe caktimin e masës “arrest në burg” për një afat 30-ditor. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.9.2021, ka pranuar kërkesën e prokurorit.

15.70 Subjekti, në datën 28.9.2021, ka përpiluar urdhrin për plotësimin e cilësimit juridik të veprës penale duke shtuar edhe “falsifikim dokumentesh”(neni 186/1 i Kodit Penal).

15.71 Shtetasi M. S. ka paraqitur kërkesë në gjykatë ku ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me “arrest në shtëpi”. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.9.2021,

---

<sup>124</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.



ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” me masën “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike dhe urdhërohet shtetasi M. S. të qëndrojë dhe të mos largohet nga banesa që ndodhet në lagjen “\*\*\*\*”, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit S. B.

15.72 Me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka korrigjuar pikën 2, të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.9.2021, të saj, duke urdhëruar që *shtetasi M. S. të qëndrojë dhe të mos largohet nga banesa që do ta deklarojë në organin e ndjekjes penale për efekt të ekzekutimit të vendimit.*

15.73 Me deklaratën datë 30.9.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, shtetasi M. S. deklaroi se do të qëndrojë në banesën që ka marrë në përdorim bashkëshortja e tij në lagjen “\*\*\*\*” pranë shkollës 9-vjeçare Gjirokastrë, por nuk evidenton banesën që ka zgjedhur.

15.74 Me urdhrin datë 30.9.2021 “Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.9.2021” subjekti urdhëron shoqërimin e shtetasit M. S. në konviktin e djemve në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë dhe mbikëqyrjen e tij me afat 24 orë nga policë të DPV-së Gjirokastrë. Në arsyetimin e këtij vendimi, subjekti citon se: “... me vendimin nr. \*\*\* është zëvendësuar adresa e caktuar prej shtetasit M. S. me një adresë që do të caktohet nga organi i prokurorisë”, pra, subjekti citon ndryshe nga sa citohet në vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, të gjykatës dhe urdhëron ndryshe nga sa urdhëron vendimi gjyqësor.

15.75 Me procesverbalin datë 30.9.2021 ekzekutohet urdhri i mësipërm datë 30.9.2021. Pikat 1 dhe 2, të nenit 237, të Kodit të Procedurës Penale ia ka lënë gjykatës dhe jo prokurorit, kompetencën për të caktuar mënyrën e ekzekutimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” (*1. Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë. 2. Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj).*

15.76 Në datën 1.10.2021, shtetasi M. S. i kërkon gjykatës: (i) refuzimin e urdhrin datë 30.9.2021 të prokurorit/subjektit “Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.9.2021”; dhe (ii) zbatimin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, në adresën e re: lagjja “\*\*\*\*” pranë shkollës 9-vjeçare “\*\*\*\*”, kati \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ndërtesa \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\* ose në çdolloj adrese tjetër që mund të ndryshohet duke njoftuar organin e akuzës.

15.77 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me urdhrin nr. \*\*\*, datë 1.10.2021, ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, në adresën e re që deklaroi në seancë shtetasi M. S.

15.78 Pasi u ekzekutua urdhri gjyqësor nr. \*\*\*, datë 1.10.2021, me procesverbalin datë 1.10.2021, shtetasi M. S. i drejton kërkesë, datë 4.10.2021, Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë dhe datë 5.10.2021 Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, duke deklaruar një adresë tjetër banimi: Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, apartament në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kati \*\*\*, Sarandë. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë e refuzon kërkesën me motivin se Policia e Sarandës nuk e ekzekuton dot dhe adresat e paraqitura janë ndryshuar shpesh nga shtetasi M. S.

15.79 Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2021, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur: (i) rrëzimin e kërkesës së shtetasit M. S. për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”

me masën “arrest në shtëpi”, të caktuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; (ii) dërgimin e shtetasit M. S. në dhomat e paraburgimit Tepelenë.

15.80 Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin në dosjen penale, ka konstatuar se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për masën e arrestit në shtëpi të shtetasit M. S., duke mos e lënë këtë shtetas në banesën e deklaruar prej tij, por në adresë të caktuar nga subjekti<sup>125</sup>, veprim ky në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, të nenit 237, të Kodit të Procedurës Penale.
- b) Subjekti ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve për një afat 3-mujor, pa qenë e nevojshme dhe pa argumente, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale.
- c) Konstatohet se akti “njoftim akuze” mban datën 15.12.2022 (nuk është data e saktë?) kur ndërkohë subjekti i rivlerësimit i ka drejtuar gjykatës në datën 2.2.2022, kërkesën për gjykimin e çështjes, si dhe akti “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, pa datë, vetëm viti 2022, i subjektit janë veprime që vijnë në shkelje të nenit 100 të Kodit të Procedurës Penale.
- d) Vendimi datë 14.9.2021 “Për caktim përkthyesi” i nënshkruar nga opgj G. Xh. dhe vendimi datë 22.9.2021 “Për caktim përkthyesi” i nënshkruar nga subjekti, nuk kanë bashkëlidhur një deklaram të përkthyesve në lidhje me faktin nëse kanë apo jo shkaqe të përjashtimit të tyre nga detyra, veprim ky në kundërshtim me nenin 126 të Kodit të Procedurës Penale.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

15.81 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar, ndër të tjera<sup>126</sup>, se pasi gjykata është vënë në dijeni verbalisht nga prokurori për pamundësinë e ekzekutimit të vendimit, gjykata, kryesisht pa njoftim dhe pjesëmarrje të prokurorit në seancë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, ka bërë korrigjimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 29.9.2021, në lidhje me adresën e deklaruar nga avokati në seancë, të caktuar nga gjyqtari në vendimin e tij, duke caktuar si banesë një banesë tjetër të pidentifikuar që i arrestuari do të zgjidhte vetë. Subjekti ka shpjeguar se në mungesë të caktimit të banesës se re nga i arrestuari apo mbrojtësi i tij dhe në pritje të njoftimit të kësaj adrese prej tyre, duke qenë se i arrestuari ishte nxjerrë nga dhomat e paraburgimit të IEVP-së Tepelenë, një ditë më parë me urdhërekzekutimin datë 29.9.2021, dhe mbahej në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë në pritje të deklaramit të një adrese të re, përpara se gjyqtari të merrte vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021 (që me orët e para të mëngjesit) pas marrëveshjes verbale të bërë me telefon me autoritetin Bashkia Gjirokastrë për caktimin e një banese sociale me qëllim ekzekutimin e përkohshëm të masës së sigurimit, nga Bashkia është vënë në dispozicion një dhomë në konviktin e djemve Gjirokastrë, pronë e bashkisë. Policia gjyqësore ka bërë të mundur ekzekutimin e përkohshëm të vendimit duke e vendosur të arrestuarin në këtë banesë. Pasi është bërë ky ekzekutim, disa orë më vonë, nga policia gjyqësore dhe jo nga gjykata, subjekti është vënë në dijeni të vendimit nr. \*\*\* vendimi datë 30.9.2021.

15.82 Zgjatja e afatit tremujor, pa shkaqe të arsyeshme, si konstatim i Komisionit nuk qëndron pasi sipas shkaqeve të caktuara në këtë vendim ishte e domosdoshme të njoftohej akuza dhe përfundimi i hetimeve. Afati tremujor është maksimal dhe nuk presupozon se çështja do të rrinte

<sup>125</sup>Në adresën “\*\*\*\*” në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë.

<sup>126</sup>Shihni me detaje prapësimet e subjektit të rivlerësimit në dosje.

patjetër në hetim edhe tre muaj. Gjyqtari ka vendosur prishjen e këtij vendimi duke lënë një afat të shkurtër për përfundimin e hetimeve, pra duke mos ndryshuar në thelb asgjë.

15.83 Për aktin “njoftim akuze” data 15.12.2022 është gabim material, duhet të ishte viti 2021. Për vendimin për caktim përkthyesi, i nënshkruar nga OPGJ-ja, i cili nuk ka të bashkëngjitur deklarin e përkthyeses, subjekti ka shpjeguar, për sa i përket rastit të OPGJ-së, në kryerjen e veprimeve përpara se çështja të paraqitet në prokurori për regjistrim të procedimit penal, është se praktika gjyqësore ka ecur që deklarata e përkthyeses merret në rastet e përkthimit të dokumenteve dhe jo në rastet e përkthimit gjatë deklarin të shtetasit të huaj. Sidoqoftë, këto janë veprime të kryera nga organet e policisë gjyqësore në momentet e para të veprimeve të tyre, përpara se të paraqitet materiali në prokurori. Për sa i përket vendimit të datës 22.9.2021, të caktuar nga subjekti, ai shpjegon se kjo deklaratë tashmë nuk ishte e nevojshme pasi përkthyesja e kishte bërë më parë betimin në gjykatë, ku ishte verifikuar që nuk ishte në kushte papajtueshmërie, pasi kjo përkthyesja ka asistuar gjatë gjithë fazës së hetimit dhe gjykimit dhe ka qenë përkthyesja e të arrestuarit në seancën e masës së sigurimit datë 17.9.2021.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

15.84 Komisioni vëren se nga subjekti i rivlerësimit ka keqinterpretim të vendimit nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për sa i përket adresës ku do ekzekutohet masa e sigurimit “arrest në shtëpi” për të pandehurin M. S. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, ka specifikuar në pikën 2 të tij “*urdhërohet personi nën hetim M. S. të qëndrojë dhe të mos largohet nga banesa, të cilën do ta deklarojë në organin e ndjekjes penale për efekt të ekzekutimit të këtij vendimi*”, ndërkohë që subjekti, në urdhërekzekutimin e vendimit të masës së sigurimit të gjykatës datë 30.9.2021, është shprehur se: “*Me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 30.9.2021, bazuar në rrethanat e mësipërme, gjyqtari i seancës së masës së sigurimit ka bërë korrigjimin material të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.9.2021, duke zëvendësuar adresën e caktuar prej tij me një adresë që do caktohet nga organi i prokurorisë*”. Për këtë arsye, subjekti ka urdhëruar “shoqërimin e të dyshuarit M. S. për në banesë, e cila do të jetë konvikti i djemve në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë”.

15.85 Subjekti duhet të kishte ekzekutuar vendimin e gjykatës, por jo në një adresë të caktuar me iniciativën e tij, çka është në kundërshtim me nenin 237 të Kodit të Procedurës Penale, por ky veprim duhej të ishte bërë me vendim gjykate.

15.86 Në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimeve, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për zgjatje afati hetimesh, nuk ka parashtruar shkaqe ligjore se përse duhen zgjatur hetimet edhe për tre muaj të tjerë.

15.87 Për mungesën e deklaratës së përkthyeses, Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit janë deklarative dhe jo të mbështetura në prova sipas nenit 126 të Kodit të Procedurës Penale.

15.88 Komisioni arrin në përfundimin se pavarësisht shkeljeve të konstatuara në lidhje me këtë çështje, ato nuk konsiderohen të mjaftueshme deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet pika 4, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 për largimin nga detyra për sa i përket kriterit profesional.

## **Konkluzion për rubrikën e vlerësimit profesional**

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave, kushteve, fakteve dhe shpjegimeve të subjektit, si më sipër, bazuar në analizën e vlerësimit të aftësive profesionale të kërkuar nga germa “c”, e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, çmon se problematikat e konstatuara në veprimet apo mosveprimet procedurale të subjektit, në disa nga çështjet e analizuara për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, ngrenë pikëpyetje serioze për mënyrën se si subjekti ka performuar në raport me të drejtën dhe legjislacionin, në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror.

Trupi gjykues vlerëson se mangësitë profesionale të evidentuara në veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit, në të gjitha çështjet e analizuara në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pavarësisht se në bazë të parimit të proporcionalitetit ato çmohen si jo të mjaftueshme për aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për largimin nga detyra, kjo edhe për shkak të parashikimit të pikës 1/c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim tërësor të tyre, ato e zbehin dukshëm përmbushjen e detyrës së tij si prokuror duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia, në këndvështrim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

1. Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe neni 51 i ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj:

- a) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë;
- b) ka kryer deklaram të rremë të pasurisë dhe veprime fiktive;
- c) ka kryer fshehje pasurie.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i tij dhe i personave të lidhur me të, subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të deklaruara në shumën 12,405,424 lekë, nga e cila 12,347,866 lekë para fillimit të detyrës dhe 57,558 lekë gjatë ushtrimit të detyrës, por pavarësisht se kjo balancë negative është krijuar më së shumti përpara ushtrimit të detyrës, marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, konsiderohet nga Komisioni si më se e mjaftueshme për të vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreu V i ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

Por, Komisioni, në një vlerësim tërësor të procesit të rivlerësimit, si dhe të problematikave të konstatuara për secilin kriter rivlerësimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia në referim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia në referim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë ndaj tij duhet aplikuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikave 1/c dhe 3 të nenit 58 dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 9.5.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**

**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**

**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*